



DETAJE NGA JETA E IMAM HOMEINIT

Ruhulah El-Homeini

Ruhulah El-Homeini u lind në vitin 1902 , në qytetin Homein i cili gjendet ndërmjet Arakut dhe Kashanit. Pas disa muajsh i vdiq baba , Sejid Mustafa El-Musaviu. Në të vërtetë atë e varënë disa feudalë , nga se ai i akuzoi për eksploatimet dhe padrejtësitë që ai bënin popullit. Sejid Mustafa El-Musaviu ishte alim më prejardhje nga familija e hazreti Imam qzimit , do të thotë , Imamit të shtatë.

Në moshën 16 vjeçe i vdiq edhe nëna . kështu që ai qysh i ri mbeti bonjak (jetim).

Në moshën 25 vjeçe arriti shkalën më të lartë të arsimimit dhe i plotësoi të gjitha kushtet për të kryer detyrën e mualimit dhe të muxhtehidit. Dy vjet më vonë , në moshën 27 vjeçe , u martua me vajzën e Ajatullah Mirza Muhamed Es-sakif Et_Taharaniut. Ai deri ne masakrin e vitit 1963 vazhdoi të merret me hulumtime shkencore. Masakri i vitit 1963 , në shkollën “Fevzije” ku ranë më mijëra besimtarë shehidë , të cilët e festonin përvjetorin e vdekjes së Imam Sadikut (All – llahu qoftë i kënaqur me të), që kthesë vendimtare në jetën e mëpastajshme të Imam Homeinit. Ai me këtë rast iu drejtuar popullit me këto falë : “ Mos u pendohuni , mos u dorëzoni dhe mos u frikësohuni “.

Tre muaj pas kësaj ngjarjeje , me 5 qershor 1963 , regjimi i shahut e burgosi Imamin. Burgosja e tij shkaktoi revoltën e popullit i cili doli në demonstrata dhe kërkoi lirim e Imam Homeinit.

Shahu e urdhëroi policinë që të gjuajnë në turmën e demonstratuesve me armë të zgjarrta , me ç’rast ranë dëshmorë 15 mijë vetë. Mirëpo , përkundër kësaj Imam Homeini (Al – llahu qoftë i kënaqur me të) qëndroi në burg deri më 6 prill 1964 , kur shahu dhe qeveria e tij , të frikësuar nga pakënaqësitë gjithëpopullore e lëshuan në liri. Në nëntor të vitit 1964 Imamin e dëbuan në Turqi . sepse ai me njëfjalim të tijin i ishte kërcnuar shahut dhe qeverisë iraniane e cila vepronte nën influencën amerikane. Gjatë qëndrimit të tij në Turqi e shkruajti veprën Tarihul vesila (vepër fikhu , në dy vëllime). Pas dy vjetësh Turqia e prishi miqësinë me te dhe dëboi , kështu që ai u strehua në Irak. Përderisa ai ndodhej në Nexhef , SAVAK-u (policia secrete e shahut) ai vrau djalin , Sejjid Mustafanë. Kur dëgjoi për vrasjen e djalit , i qetë tha : Inna lil-lahi ve inna ilejhi raxhinë – “Ne jemi të all-llahut dhe te Ai do të kthehemi”

Itila , revistë e datës 9.1.1968 , botoi një artikull në të cilin ofendohej Imam Homeini dhe disa ulema tjerë. Ai , në shenjë protestoi , organizoi demonstrata të mëdha , me në krye me ulematë e Fakultetit të shkencave në Kom. Demonstrata u mbajtën nëpër të gjitha qytetet e mëdha të Iranit, kështu që intervenuan organet shtetërore dhe disa besimtarë ranë shehidë. Më 3 shtator 1968 . me miliona njerëz dolën të demostrojnë rrugëve të qyteteve dhe baskarisht falnin namaz duke i dhënë përkrahje politikës së Imam Homeinit. Shahu shpalli gjendje të jashtëzakonshme. Kurse Sadam Huseini , me urdhërin e superfuqive , ai ndaloi Homeinit qëndrimin në Irak. Të njejtën gjë e bëri edhe Kuvajti. Në vitin 1970 u detyrua të udhëtojë në Paris , në Francë. Më 1 shkurt 1979 Imami u kthye sërish në Teheran , ku iu bë pritje madhështore. Thuhet se e kanë pritur rreth 1 milionë besimtarë prej aeroportit e deri te varrezat Beheshti Zehra. Më 8 shkurt 1979 , Imam Homeini e emëroi qeverinë e përkoshme, ndërsa më 11 shkurt në mënyrë oficiale u shpall fitorja e revolucionit Islamik në Iran dhe përfundimisht u rrëzua qeveria e tmerrshme e shahut.

Më 9 prill 1979 Imam Homeini i ndërpreu të gjitha marrëdhëniet me Amerikën , duke e shpallur këtë ditë , ditë feste. Më 18 shtator , republikën Islamike e sulmoi Iraku , kështu që Imami u detyrua që të mobilizojë popullin vullnetarisht dhe të kërkojë prej tyre që t'i respektojë urdhërat e komandës së lartë Ushtarake dhe në të njëjtën kohë të angazhohen maksimalisht kundër regjimit të pafe të Sadam Huseinit.

Më 18 korrik 1985 . Imam Homeini u pajtua që të ndërpritet lufta me Irakun , sipas rezolutës së OKB , Nr.598.

Kah fundi i vitit 1989 , Imami (papaja qoftë mbi të) i dërgoi letër Mihail Gorbaçovit dhe i bëri thirrje që të pranojë Islamin , me çka do t'u mundësojë besimtarëve të atjeshëm që lirisht t'i shprehin dhe manifestojnë ndenjzat e tyre fetare.

Në shkurt të vitit 1989 dhe urdhën (fetva) që të likuidohet Salman Ruzhdiu . autor i librit “Vargjet satanike” , në të cilin e fyen Islamin dhe muslimanët e parë , e me të edhe mbarë botën islame.

Me 24 maj 1989 , për shkak të gjakderdhjes së brendshme që pati Imami iu bë intervenim kirurgjik , e më 4 qershor , ai në spital (rahimehullahu ilejhi) ndërroi jetë. Vdekja e tij pikëlloi zemrat e miliona muslimanëve.

Trupi i Imam Homeinit (mëshira e All-llahut qoftë mbi të) u varros në prani të dhjetë milionë xhematlinjëve , në mezarin Beheshti Zehra , më 6 qershor 1989 , në Teheran.

HYRJE

Tema e pushtetit të fakihut (velajati – fakih) na jep mundësi reale të shqyrtojmë disa çështje të të njejtës lëmi. Pushteti i fakihut është temë e cila menjëherë aprovohet si e tillë , por ndihet nevoja që të argumentohet , sepse çdonjeri që ka një vetëdije të përgjithshme mbi besimet në përgjithësi dhe parimet islame , pa hezituat do të pajtohet me parimin e psuhtetit e fakihut posa të takohet me të. Do ta pranojë atë si diç të domosdoshëm dhe tq qartë. Meqë këtij parimi sot i kushtohet kujdes fare pak , mu për atë ndihet nevoja për ta argumentuar , kjo është rezultat i rrethanave shoqërore që mbretërojnë ndërmjet muslimanëve në përgjithësi , po ashtu edhe nëpër shkollt fetare. Ato rrethana kanë rrënjë historike , të cilat do t'i paraqes shkurtimisht.

Lëvizja historike e islamit që nga fillimi u desht të luftojë me hebrenjtë , sepse ata ishin maqinaria propagandistike asntiislame që merrej me dinakëri të llojlojshme , dhe , siç shihin , ai aktivitet vazhdon edhe sot. Më vonë ata u bashkuan me grupet e tjera të cilat në kuptimin e mirëfilltë ishin më djallëzore se sa ata. Këto ishin grupe të reja që filluan penetrimin imperialist në vendet islamike para afro treqind vitesh , dhe konsideronin se është e domosdoshme çrrënjosja e islamit me qëllim që të arrinë qëllimet e tyre ekstreme. Nuk patën për qëllim që t'i largojnë njerëzit nga Feja islame dhe të përhapin krishterizmin , sepse imperialistët me të vërtetë nuk i përkasin as Fesë Islame as asaj krishtere. Megjithatë , gjatë kësaj periudhe të gjatë , që nga luftërat e kryqzatave , ata kishin diktuar se pengesë kryesore në realizimin e ambicjeve të tyre materialiste dhe se rrezik kryesor për forcën e tyre politike nuk paraqet askush tjetër pos Islamit të çiltër me dispozitat e veta dhe besimi i popullit në këtë fe.

Kurdisën gjithfarë inrigash dhe zhvilluan fushatë të ashpër kundër Islamit , duke mos zgjedhur mjetet.

Predikuesit të cilët ata i patën vënë nëpër shkollat fetare , agjentët e punësuar nëpër universitete , nëpër institucionet arsimore shtetore dhe në shtëpitë botuese , si dhe orientalistë që janë vënë në shërbim të shteteve imperialiste – të gjithë këta njerëz i bashkuan forcat e tyre në zvetnimin e parimeve islame. Si rezultat i gjithë kësaj qe se shumë vetë , sidomos njerëz të arsimuar , formuluan nocione të shtremëruara dhe jot ë sakta për Islamin. Islami është fe e luftëtarëve të cilët angazhohen për të vërtetën dhe drejtësinë. Islami është fe e atyre që duan liri dhe pavarësi. Ajo është shkollë e atyre që luftojnë kundër imperializmit. Por shërbëtorët e imperializmit e paraqesin Islamin në një dritë krejtësisht tjetër. Ata në vetëdijen e njerëzve krijuan një imazh të gabuar mbi Islamin. Verzioni i shtrembëruar mbi Islamin që e proklamoni nëpër shkollat fetare , kishte për qëllim që Islamin ta privojë nga aspekti vital dhe revolucionar i tij dhe të pengojë rebelimin e muslimanëve për të fituar lirinë , përmbushjen e dispozitave islame dhe krijimin e pushtetit që do t'iu siguronte lumturinë – që të mund të jetonin ashtu si u ka hije njerëzve.

Shërbëtorët e imperializmit , për shembull , deklaroni se Islami nuk është fe universale që kujdeset për të gjitha aspektet e jetës së njeriut dhe se nuk ka zakone dhe dispozita që u përkasin marrëdhënieve shoqërore , madje se nuk ka formë të veçantë të pushtetit. Islami merret me normat e pastrimit ritual pas menstruacionit dhe lindjes. Ai ndoshta ka disa parime etike , porse me siguri nuk ka kurrgjë të thotë për jetën e njeriut në përgjithësi , as për sistemin shoqëror.

Mjerisht , kjo lloj propaganda e poshtër pati efekte. Përpos masës , as shtresa e arsimuar – studentë të universiteteve . madje edhe shumë studentë të drejtimeve fetare-nuk arritën ta kuptojnë derjt Islamin , sepse kishin përfytyrim të gabueshëm. Si njerëzit që nuk janë mësuar me ndonjë të huaj , ashtu edhe ata sillleshin ndaj Islamit. Islami jetonte ndërmjet njerëzve të kësaj bote sit ë ishte i huaj. Po të gjendej dikush në ndonjë mjedis që të predikonte Islamin ashtu siç është në realitet , do t'i mbushej mendja se është shumë vështirë t'i udhëzosh ata në rrugën e drejtë.

Agjentët e imperializmit nëpër shkollat e fesë do të ngrinin kundër tij hallakamë të vërtetë. Që t'ju vë në dije sadopak dallimin ndërmjet Islamit dhe asaj që proklamohet si Islam . më duhet t'ju përkujtoj dallimin që ekziston ndërmjet Kur'anit dhe librave të hadithit 3) nga njëra anë , dhe shqyrtimeve praktike mbi shkencën e drejtësisë , në anën tjetër. Kur'ani dhe përmbledhjet e haditheve që paraqesin burimin kryesor të dispozitave islame, plotësisht ndryshojnë nga studimet që i shkruan muxhtehidët 4) e sotshëm sin ë aspektin e fushëveprimit po ashtu edhe në aspektin e efektit që mund të shkaktojë në jetën shoqërore. Numri i ajeteve kur'anore që trajtojnë çështje shoqërore në krahasim me ajetet që bëjnë fjalë për shërbimet liturgjike është më i madh dhe qëndrojnë në raport njëqind me një. Nga pesëdhjetë kaptinat e korpusit të haditheve që përmbajnë të gjitha dispozitat e Islamit , nja tri a katër kaptina u kushtohen çështjeve liturgjike dhe obligimeve të njeriut ndaj Krijuesit dhe Furnizuesit të tij. Diç më tepër prej tyre merren me çështjet e etikës , ndërsa të gjitha kaptinat e tjera iu kushtohen çështjeve shoqërore, ekonomike , ligjore dhe politike-shkurtimisht mbarë “barrës” së shoqërisë.

Ju që përfaqësoni gjeneratën e re dhe , dhëntë Zoti , të jeni në të ardhmen në shërbim të Islamit , duhet që gjatë tërë jetës me ngulm të ndiqni qëllimet që unë tash do t'i ekspozoj dhe t'i informoni të tjerët me ligjet dhe dispozitat islame në mënyrën që ju duket më e dobishme , me anë të shkrimeve ose të folurit , dhe t'i udhëzoni njerëzit në problemet e Islamit me të cilat do të ballafaqohen që nga fillimi , si pastaj të njoftohen me armiqtë e Islamit dhe me mynxyrat që i ndjekin. Mos lejoni që natyra e vërtetë e Islamit të mbetet e fshehur , sepse njerëzit mund të përfytyrojnë se Islami , si krishterizmi (jo ai i vërteti) është përmbledhje porosis që trajtojnë raportin e njeriut ndaj Zotit , kurs xhaminë ta identifikojnë me kishën.

Në kohën kur Perëndimi ishte mbertëri e territ dhe injorancës – me banorët e vet që jetonin në gjendje barbare dhe kur Amerika ende ishte e banuar me flokëkuq gjysëm të egër – dy mbretëri të mëdha , Irani dhe Bizanti , jetonin nën pushtetin e tiranisë , të klasës së privilegjuar dhe të diskriminimit , e mbi të gjitha sundonte një renegat pa fijen e pushtetit popullor. All-llahu i Lartësuar dhe i Gjithëfuqishëm ka dërguar nëpërmjet Pejgamberit të Tij (paqa dhe mëshira qoftë mbi të) ligje që të mahnisin me epërsinë e tyre.

Themeloi ligje dhe rregulla për të gjitha porret e jetës dhe përcaktoi urdhëra që shtrihen që nga koha kur ai formohet si embrion dhe deri në çastin kur vendohet në varr. Si ekzistojnë ligje që paraqesin obligimet e njeriut në pikpamje të ardhurimit , poashtu ekzistojnë edhe zakone , dispozita e norma për çështje e shoqërisë dhe të pushtetit. Ligji islam është përparimtar , i hapur dhe system ligjor gjithëpërfshirës. Të gjithë blejt i librave që janë ruajtur nga kohërat e hershme nga lëmi të ndryshme të drejtësisë , siç është akti gjyqësor , transakcionet shoqërore , ligji penal , hakmarrja , marrëdhëniet

ndërkombëtare , rregullat që i përkasin luftës dhe paqës , e drejta private dhe publike-që të gjitha së bashku përmbajnë shembullin më të mirë të ligjeve dhe udhëzimeve islame. Nuk egziston asnjë sferë e jetës së njeriut për të cilën Islami nuk ka paraparë norma të caktuara.

Më qëllim që muslimanët , posaçërisht intelektualët dhe gjeneratën e re , t'i largojnë nga rruga islame , agjentët e huaj vazhdimisht kanë shpifur se Islami s'ka çka të ofrojë , se Islami përbëhet nga disa dispozita që merren me menstruacionin dhe lindjen dhe se kjo qenka fushë e mirë studimi për ahundët 5.)

Në këtë ka diçka të vërtetë. Sepse , në rregull është të jenë të sulmuar edhe në këtë mënyrë ahundët e dënuar të cilët nuk kanë ndër mend të komentojnë teoritë , udhëzimet dhe botëkuptimet e Islamit . por është e vërtetë se ata humbin kohën me gjëra të tilla , duke i harruar të gjitha temat e tjera. Në disa vende , që edhe mund të pritej , të huajt sollën plane të sigurta për realizimin e e ambicjeve të tyre politike dhe ekonomike , ndërsa pakujdesia që i ka përfshirë shkollat fetare , u ka mundësuar sukses të plotë. Edhe ndërmjet ulemave 6) tanë pati individë , të cilët të pavetëdëshëm kontribuan në përmbushjen e qëllimeve të të huajve , përfundimin e të cilës e shohim sot.

Herë-herë shpifnin , se udhëzimet islame janë jot ë plota. Është thënë , për shembull , se nuk ekzistojnë ligje valide për procedurën gjyqësore. Në përputshmëri me këtë insinuatë dhe propagandë , agjentët britanikë të udhëzuar nga zotrinjtë e tyre lansuan idenë e një sistemi kushtetuar (të parlamentarizmit) që të mashtronin popullin dhe të fshehnin të vërtetën për krimet e tyre politike. Në fillimin e zhvillimit të sistemit kushtetutar , atëherë kur njerëzit deshtën të hartojnë ligje e kushtetuta , prej ambasadës belge është huazyar një kopje e kodeskit zakonor dhe një grusht njerëzish (emrat e të cilëve nuk dua t'i përmendi këtu) e përdorën si bazë për kushtetutën që e hartuan atëherë , duke e plotësuar mehuazime nga kanunet frënge dhe britanike 7) . Është e vërtetë se i shtuan disa dispozita islame se për të mashtruar popullin , por baza e atij zakoni që iu imponua popullit ishte huaj.

Çfar lidhje kanë me Islamin të gjitha ayo nene të Kushtetutës si dhe teksti i Zakonit Plotësues 8) që i referohet monarkisë , trashigimisë së monarkisë e kështu me rradhë ? Të gjitha këto ishin në kundërshtim me parimet islame dhe dëshmojnë se çfar zakonesh dhe system pushteti kishte.

Monarkinë dhe trashigiminë familjare të pushtetit islami i konsideron të pavlefshëm. Me paraqitjen e Islamit në Iran , në Mbretërinë Bizantine , në Egjipt dhe në Jemen ndërpritet tërë instuticioni i monarkisë. Në letrën e bekuar që ai dërgoi Pejgamberi më i Nderuar mbretit bizantin Herakliut dhe shahinshahut 9) Iranian i thirte që të heqin dorë nga forma e pushtetit monarkik dhe imperialist , që mos i detyrojnë shërbëtorët e Zotit që t'i nderojnë si hyjni , me dëgjueshmëri absolute , dhe t'i lejojnë njerëzit të adhurojnë All-llahun i cili nuk ka shok dhe është Sundues i vërtetë. Monarkia dhe trashëgimi i pushtetit paraqesin sistemin djallëzor , të gabueshëm , që e nxiti Martirin 10) (paqja qoftë mbi të) të rebelohet dhe të përjetojë torturat më të rënda duke u munduar që të pengojë institucionalizmin e atij sistemi. E kundërshtoi trashigimin e pushtetit bga Jezidi madje as që e njohu legjitimitetin e tij 11).

Islami , pra , nuk e përfill sistemin monarkik e as trashigimin familjar të pushtetit. Ato s'kanë vend në Islam. Po që se e gjithë kjo është i ashtuquajhuri Islam i mangët , atëherë

me të vërtetë Islami është i mangët , sepse islami s'ka paraparë ligje për marifetllëqet e fajdexhinjeve, për konsumimin e alkoolit , për shfryrjet seksuale , madje i ka ndaluar rreptësisht. Megjithatë , klikat sunduese , që janë marioneta të imperializmit dhe dëshirojnë që t'i zhvillojnë këto mbrapështri (vese) në botën islame , është e natyrshme që ta konsiderojnë Islamin të mangët. Ata patjetër duhet të inkorporojnë zakonë gjegjëse nga Britania, nga Franca , nga Belgjika dhe tash vonë nga Amerika. Fakti se Islami nuk jep të dhëna të mjaftueshme për ndekjen e aktiviteteve të palejueshme , është larg asaj që ta bëjë të mangët , përkundrazi është shenjë e përsosshmërisë dhe burim i krenarisë.

Imponimi i zakoneve të huaja shoqërisë sonë islame ka qenë burim i problemeve dhe vështirësive të panumërta. Njerëz të dijshtëm që kanë punuar në sistemin tonë legjislativ patën shumë vërejtje pëe zakonet aktuale dhe jetësimin e tyre. Po të thellohej dikush në sistemin gjyqësor të Iranit ose të vendeve të ngjashme , ka mundur të kalojë tërë jetën në përpjekje për të argumentuar realitetin. Kur isha i ri pata dëgjuar një avokat të dishëm duke thënë : “Mund të kalojë tërë jetën për të zgjidhur një process gjyqësor duke e endur lëndën nëpër maqinerinë gjyqësore , pasta t'ia lë të birit që ta përfundojë”. Një situatë e tillë mbretëron edhe sot , me përjashtim , natyrisht , kur ndonjëra palë është me ndikim dhe rasti zgjidhet shpejt , mbase jo drejtë.

Dispozitat tona të sotme legjislative nuk i sjellin popullit tonë kurgjë tjetër pos mjerimit , duke i shtyer njerëzit të mos kujdesen për angazhimet e tyre të përditshme dhe duke u mundësuar të gjitha llojet e keqpërdorimeve. Një numër tejet i vogël njerëzish është në gjendje t'i sigurojë të drejtat e veta legjitime. Në vendimet gjyqësore nuk mjafton që dikush të sigurojë të drejtën e tij , por duhet të zbatohet edhe procedurë korrekte. Patjetër të respektohet koha e njerëzve , mënyra e jetës dhe profesioni i të dy palëve , ashtu që lëndën duhet zgjidhur shpejt dhe thjesht.

Një rast që e ka zgjidhur gjyqi i sheriatit¹³) në khërat e hershme për një ditë– dy sot nuk mund të zgjidhet as për dhjetë vjet. Ndonjë jetim , qoftë i ri apo në moshë , duhet të kalojë tërë ditën në Ministrinë e Drejtësisë , që nga mëngjesi deri në mbrëmje , duke humbur kohën në rende ose duke qëndruar para ndonjë nënpunësi , dhe në fund nuk do të dijë dot se ç'ka ndodhur. Dikush që është më i gjindshëm si dhe ai që është në gjendje të jape ryshfet , shumë shpejt do ta zgjidhë rastin e vet , në saje “të drejtësisë”. Ndërsa ndonjë tjetër që s'është i shkatërruar do të presë tërë jetës.

Agjentët e imperializmit ndonjëherë në librat e tyre dhe nëpër gazeta shkruajnë se dispozita e Sheriatit janë tejet të ashpra. Një person ka shkuar aq larg saqë ka pohuar se ligjet islame janë “të ashpra” sepse orgjinën e kanë prej arabëve , ahstu që “ashpërsia” e arabëve reflektohet edhe në “ashpërsinë” e ligjit islam

I habitur jam me mënyrën se si këta njerëz mendojnë. Ata vrasin njerëz për shkak të posedimit të dhjetë gramëve heroinë dhe thonë :

“Kështu e ka ligji” (jam informuar se para disa kohësh janë ekzekutuar dhjetë vetë , kurse një person para pak kohësh për shkak të posedimit të dhjetë gramëve është ekzekutuar. 14)

Ligje johumane , si ky , shpifën në emër të një fushatë kundër çoroditjes, dhe ato ligje nuk mund konsiderohen të ashpra. (Nuk thashë se është e lejuar të shitet heroina , por kjo nuk është dënimi përkatës. Shitja e heroinës patjetër duhet ndaluar , kurse denoncimi duhet të jetë në proporcion me krimin). Megjithatë kur Islami parasheh tetëdhjetë shkopinje për konsumuesin e alkoolit këtë e konsiderojnë “të ashpër”.

Ata mund të vrasin dikend për shkak të dhjetë gramëve heroinë , kurse ashpërsia e këtij ligji as që përmendet.

Shumë forma të korrupsionit që u paraqiten në shoqëri rrejdhin nga alkooli. Ndeshjet që ndodhin nëpër rrugët tona , vrasjet dhe vërvrasjet shpeshherë janë pasojë e përdorimit të alkoolit. Mandej edhe konsumimi i heroinës thuhet se është rezultat i prirjes ndaj alkoolit. Por ende ka të atilë që mendojnë se ai që pin alkool është krejtësisht I patëmetë (i pamëkatë) – sipas të gjitha gjasave , ata të Perëndimit ashtu edhe veprojnë : dhe hajde të lejojmë pirjen dhe shitjen e alkoolit lirisht.

Por kur Islami dëshiron të pengojë konsumimin e alkoolit – njëherë nga të këqijat më të mëdha – duke përcaktuar për konsumuesin tetëdhjetë shkopin , ose për afrim seksual – njëqind shkopin (i martuari dhe martuara parashihet të mbulohen me gurë) , atëherë ata zënë të kukasin dhe thërasin për ndihmë : “sa i ashpër është ky zakon që shpreh ashpërsinë e arabëve”. Ata nuk janë të vetëdijshëm se këto masa ndëshkimore kanë për qëllim mbrojtjen e popujve të mëdhenj nga shkatërrimi dhe zvetnimi. Shfrenimi seksual moei aso përmasash saqë shkatërroi gjenerata të tëra , duke e vetnuar rininë tonë që të mos përfillojë kurrfarë aktiviteti. Të gjithë ngarendin të kënaqen në forma të ndryshme të perverzitetit që aq lehtë mund të vihet deri ato. Pse të konsiderohet ashpërsi rrahja e një mëkatari kue një dënim i tillë mund të ndikojë që mos priset gjenerata e re ?

Po ashtu , shohim se si zotrinjtë e kësaj klasës sonë sunduese që pesëmbëdhjetë vjet e më tepër masakrojnë në Vietnam duke harxhuar buxhet të shumtë në biznesin e derdhjes së gjakut dhe askush mos ketë të drejtë të ankohej. Por nëse Islami i urdhëron ihtarët e vet të angazhohen për luftë dhe për mbrojtje , ashtu që njerëzit t’u nënshtrohen ligjeve të dobishme për ta , dhe po aq se urdhëron që të vriten disa të poshtër ose prej atyre që nxisin pohstërsi , atëherë ata pyesin : “cili është qëllimi i kësaj luftë?

E gjithë kjo qëu tha paraqet planet e hartuara para disa shekujsh që tash po realizohen dhe japin frytet e tyre.

Ata më së pari hapnin ndonjë shkollë diku 15) , edhe ne diç të tillë e parashihshim , pa iu thënë gjë. Kolegët tanë po ashtu qenë neglijentë në këtë aspekt dhe nuk penguin veprimtarinë e tyre , ashtu që sot , siç shihni , ato shkolla u shumëzuan , misionarët e tyre , u shpërndanë në provinca dhe fshatra dhe i kovertojnë fëmijët tanë në të krishterë dhe ateistë.

Plani i tyre është që të na mbajnë në apati , të mbetemi në gjendje të mjerueshme që të mund të na i eksloatojnë begatitë tona , pasuritë minerale të vendit tonë dhe resurset e tjera. Ata dëshirojnë që net ë mbesim të njerë e fatzinj dhe varfanjakët tanë të bien në kurthën e mjerimit të vet. Në vend që t’u nënshtrohen dispozitave islame të cilat japin zgjidhjet më fatlume për problemet e fukarallëkut , ata dhe agjentët e tyre edhe më tutje duan të jetojnë nëpër palate dhe të çojnë jetë luksoze.

Planet e tyre janë aq gjithëpërfshirëse asqë prekin edhe institucionet arsimore fetare. Nëse dikush dëshiron të flaës mbi pushtetin islam dhe rivendosjën e tij , patjetër t’i përmbahet parimit takijë 16) dhe patjetër duhet të marrë në sy rezistencën ndaj atyre që i janë shitur imperializmit.

Erdhi puna deri aty saqë disa njerëz konsideronin se rrobat ushtarake s’kanë kurrjë të përbashkët me burrinë dhe drejtësinë , edhe pse prijësit tanë fetarë ishin edhe ushtarë , komandantë dhe luftëtarë. Visheshin me tesha ushtarake dhe shkonin në luftë ashtu siç

janë përshkruar në historinë tonë : kanë vrrarë dhe kanë rënë të vrrarë. Komandanti i besimtarëve (paqa e Zotit qoftë mbi të) edhe vetë vente helmetën në krye , merrte parzmën dhe ngjeshte shpatën. Imam Hasani 19) dhe Martiri i të Munduarëve (paqa e Zotit qoftë mbi ta) vepruan në të njejtën mënyrë. Imamet e mëvonshëm nuk patën raste të volitshme për të shkuar në luftë , ndonëse Imam Bakiri 21) (paqja qoftë mbi të) për nga natyra ishte luftëtar. Por sot bartja e uniformës konsiderohet si humbje e burrërisë 21) dhe flitet se ajo nuk duhet të vishet. Sit ë mundemi të formojmë pushtetin islam , atëherë atë do ta afrojmë edhe me gunë e turban , sepse bëjmë ofenzivë kundër përbindëshit të përbetuar.

E gjithë kjo është rezultat i valëve propagandistike të cilat u përplasën dhe nëpër institucione arsimore fetare dhe na obligoi të argumentojmë se Islami posedon rregulla mbi pushtetin.

E tillë është pra gjendja jonë që na e kurdisën të huajt nëpërmjet propagandës dhe agjentëve të tyre. Mënjanuan të gjitha procedurat juridike dhe zakonet politike i zëvendësuan me huazimet evropiane , kështu pra , zvogluan fushëveprimin e Islamit dhe e syrgjynosën nga shoqëria islame. Dhe për qëllimet e tyre eksploatuese , në pushtet vunë agjentët e tyre.

Pak më parë sjicuan planin suberviv dhe të korruptuar të imperializmit. Na duhet t'i shqyrtojmë disa faktorë të brendshëm , posaçërisht efektin verbues të imperializmit ndaj disa individëve të shoqërisë sonë. Meqë vendet imperialiste arritën shkallë të lartë zhvillimi dhe pasuri të mëdha – si rezultat i zhvillimit shkencor dhe teknologjik por edhe si rezultat i plaçkitjes së popujve të Azisë dhe të Afrikës – disa njerëz e humbën vetëbesimin dhe e bindën vetveten se e vetmja rrugë e përparimit teknologjik është braktisja e zakoneve dhe bindjeve të veta. Kur ndodhi , për shembull , zbritja në hënë , ata sollën përfundim se muslimanët duhet t'i hedhin të gjitha zakonet e veta! Por , ç'lidhje ka shkuarja në hënë me ligjet islame? A nuk shohin ata se vende me sisteme të kundërta shoqërore , bëjnë gara në përparimin shkencor dhe në pushtimin e hapësirës (kosmosit) . Lëshoni ata le të shkojnë edhe në Mars jasht rrugës qumshtore (Kashta e kumtrit) ; dhe atëherë do të jenë të privuar nga gëzimi i vërtetë , nga vryrtet morale dhe përparimi shpirtëror , deh do të jenë të paafte t'i zgjidhin problemet e tyre shoqërore sepse , zgjidhja e problemeve shoqërore dhe shërimi i mjerimit të njerëzve mund të arrihet me mbështetje të fortë në bazat e fesë dhe të moralit. Arritja e të mirave materiale , pushtimi i hapësirës natyrore pa një mbështetje të tillë nuk do të kenë efekt. Ato duhet të jenë të përmbushura dhe të ekuilibruara me fenë , me besimin e fortë , dhe me moralin islam që me të vërtetë t'i shërbejnë njerëzimit e jot a rezikojnë. Ne tash më e kemi atë besim të fortë , atë moral , ato ligje që janë të domosdoshme. Po të shkojë dikush në ndojnë vend të shpikë diçka nuk duhet të shpejtojë e t'u ikë parimeve fetare që janë rregullatori më i mirë për të siguruar reakti në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

E njëjta i referohet edhe propagandës imperialiste. Disa anëtarë të shoqërisë sonë , mjerisht , edhe pse nuk ka qenë e lejueshme qenë e lejueshme , ranë nën ndikimin e propagandës së tyre armiqësore. Imperialistët përhapin ndërmjet nesh bindjen se Islami nuk ka formë specifike të pushtetit dhe të regjimit institucional. Madje thuhet se ato ligje që i ka , nuk kanë metoda të aplikueshme dhe , sit ë tilla , funksioni i tyre është tjesht legjislativ. Kjo propagandë paraqet pjesë të planit mbrojtës të imperializmit në

pengimin e muslimanëve të merren me veprimtari politike si dhe për pengimin në vënien e pushtetit islam. Kjo është në mospajtim të plotë me themelet e besimit tonë.

Ne e respektojmë pushtetin dhe besojmë se Pejgamberi a.s ka qenë i obliguar të caktojë trashëgimtarin , gjë që edhe e ka bërë. A thua se trashëgimtari ka qenë i caktuar vetëm për komentimin e ligjit? Komentimi i ligjit nuk kërkohet prej trashëgimtarit të Pejgamberit. Ai vetëm i ka interpretuar ligjet. Sa i takon ligjit , mjaftonte të shkruanin ndonjë libër dhe t'ua përcillnin njerëzve që të mund t'i orientonin aksionet e tyre. Është e logjikshme që trashëgimtari të vihet për të mbajtur pushtetin. Ligji kërkon njerëz që do ta zbatojnë atë. E ne jeta gjë vlen edhe për të gjithë vendet e botës sepse sjellja e ligjit vetvetiu ka pak vlef të dhe nuk mund t'iu sigurojë njerëzve lumturinë. Pas sjelljes së ligjit, patjetër duhet të krijohet edhe pushteti ekzekutiv , ai është jo i plotë. Mu për atë Islami, ç'prej se themeloi ligjet , po ashtu krijoi edhe pushtetin ekzekutiv.

Pyetje më vete do të ishte : Kush u desh të ekzekutojë këtë pushtet ? Po të mos kishte caktuar Pejgamberi a.s. trashëgimtarin që do të merrte pushtetin ekzekutiv , atëherë Ai nuk do ta kishte plotësuar misionin e Tij , ashti siç konfirmohet në Kur'an.22) Nevoja e zbatimit të Ligjit Hyjnor , nevoja e themelimit të pushtetit ekzekutiv dhe rëndësia e atij pushteti në përmbushjen e qëllimeve të misionit profetik për vënien e një regjimi të drejtë që do t'i silte lumturinë njerëzisë – të gjitha këto paraqesin sinonim në përmbushjen e misionit profetik.

Në kohën e Pejgamberit a.s. ligjet jo vetëm që janë komentuar por edhe janë zbatuar në përpikshmëri. Pejgamberi i All-llahut ka qenë zbatues i Sheriatit. Ai i ka zbatuar masat ndëshkuese sipas Islamit : u ka prerë duart vjedhësve dhe ka urdhëruar të rihet dikush ose të mbulohet me gurë. Trashëgimtari i Pejgamberit ka qenë i detyruar të bëjë të njejtën gjë. Detyrë e tij nuk ka qenë të sjellë ligjin , por zbatimin e Ligjit Hyjnor që e shpalli Pejgamberi a.s.. Ja se për çka është më se i nevojshëm formimi i pushtetit dhe themelimi i organeve ekzekutive. Besimi në nevojën e patjetërsueshme të një pushtetit të këtillë është pjesë e besimit në Imamatin , si dhe në përpjekjet dhe në luftën për jetësimin e tij.

Mirë të keni kujdes. Për shkak të armiqësisë ndaj jush ata morën guximin të shtrembërojnë pikpamjet islame , prandaj është detyrë juaja që të bëni prezentimin e Islamit drejtë , si dhe doktrinën e Imamamatit. Patjetër duhet t'u thoni njerëzve : “Ne besojmë se Pejgamberi s.a. ka caktuar trashëgimtarin i cili do të mbajë përgjegjësinë për çështjet e muslimanëve , dhe se ai e bëri këtë në përputhmëri me dëshirën e Zotit. Sipas kësaj , edhe ne patjetër të bindemi në dosmosdoshmërinë e vënies së pushtetit , dhe të bëjmë përpjekje për themelimin e organeve gjyqësore dhe administrative. “Shkruani dhe publikoni libra mbi ligjet islame dhe mbi efektet e dobishme për njerëzinë. Përsosni stilin tuaj dhe metodën e predikimit dhe të veprimtarive tjera të ngjashme.

Dienie se detyrë juja është themelimi i pushtetit islam. Kini besim në vetvete dhe dieni se jeni të aftë për realizimin e kësaj detyre. Imperialistët planet e tyre i filluan para trekatër shekujsh. Filluan nga zeroja dhe ja shihni se ku arritën! Edhe ne do të fillojmë

nga zeroja dhe nuk do t'i vemë veshin ropamës së disa ksenomaniakëve 23) dhe shërbyesëve besnik të imperializmit.

Paraqitnjani Islamin njerëzve në formën e drejtë , ashtu që rinia jonë mos e ekspozojnë veten si ahundë që rrinë në ndojnë skaj të Nexhefit ose Komës duke studiuar çështjet e menstruacionit dhe të lindjes , dhe , në vend se të merren me politikë , bien konkluzione se feja patjetër duhet të jetë e ndarë nga politika.

Kjo parollë për ndarjen e fesë nga politika dhe kërkesat që shkencëtarët islamë mos përzihen në çështje shoqërore e politike , e shpikën dhe e propaganduan imperialistët : vetëm njeriu i pafe i përhap këto ide. A thua feja dhe politika që e ndarë në kohën e Pejgamberit a.s. ? A ekzistonte nga njëra anë , grupi i predikuesëve , dhe përballë tyre , grupi i politikanëve dhe liderëve ? A thua ishin të ndara feja dhe politika në kohën e halifëve madje edhe kur ata ishin jolegjitim – edhe në kohën e Komandantit të Besimtarëve r.a.? A kanë ekzistuar dy pushtete të ndara? Këto parolla dhe këto kërkesa i shpërndanë imperialistët dhe agjentët e tyre politikë vetëm e vetëm që të pengojnë fenë në rregullimin e çështjeve të kësaj bote , si dhe në krijimin e shtetit islam. Njëkohësisht shkaktuan përçarje ndërmjet dijetarëve islamë , nja njëra anë , dhe masës së popullit që luftonin për liri dhe pavarësi , në anën tjetër. Ashtu arritën dominimin mbi popullin tonë dhe i plaçkitën resurset tona , që gjithnjë e patëm qëllim të dorës së parë.

Po qe se ne muslimanët nuk bëjmë kurgjëntjetër pos të kryejmë lutjet me rregul , pra të falemi , e të lutemi për All-llahun , të lartësojmë emrin e Tij , imperialistët dhe pushteti tiranik nuk do të na prishin reaktinë. Po të themi vetëm : “Të tuboheminë thirrjen e ezanit 24) dhe të falemi . leni ata le të vijnë dhe le të na plaçkisin krejt çka kemi , All-llahu i sheh ata , vetëm Ai është i Gjithëfuqishëm , dhe , dhëntë Zoti , ne do të jemi të shpërblyer në botën tjetër” – poqese kjo është logjika e jonë , ata aspak nuk do të na shqetësojnë.

Njëherë në kohën e okupacionit të Bagdatit një officer britanik kishte pyetur : “Ezanin që po e dëgjoj nga minareja a është i dëmshëm për politikën britanike?” Kur ju përgjigjen se nuk është i rrezikshëm kishte thënë : “Lejoni ata le të thërasin në namaz sa të duan. “Nëse nuk jeni të kujdesshëm ndaj politikës së imperialistëve , duke kujtuar se Islami përmban vetëm disa tema që ju vazhdimisht i studioni por nuk veproni sipas tyre , atëherë imperialistët do t'ju lënë në qetësi. Faluni ju sa të doni; pasuritë e naftës janë ato që i duan ata , pse të mërzhiten për lutjet tuaja. Ata i duan minierat tona , ata duan të shndërrojnë vendin tonë në treg të prodhimeve të tyre. Ja se për çka ata vunë pushtet marionette , që mos na mundësojnë industrializimin e vendit , por të krijojnë truste dhe aso industrie që do të jetë tërësisht e varuar prej botës së jashtme.

Ata nuk duan që net ë jemi vërtet qenie njerëzore , sepse ata u frikohen qenieve të vërteta njerëzore. Po qe se paraqitet vetëm një qenie e tillë ata do t'i frikësohen , sepse atë do ta përkrah populli , ndërsa ndikimi i tij do t'ua shkatërronte tërë themelet e tiranisë , të imperializmit dhe të pushtetit marionet. Ashtu sa here që është paraqitur ndonjë njeri i tillë , ata e kan vrarë , e kanë burgosur ose e kanë syrgjynosur , dhe janë mundur ta përgojnë : “Ky është ahunt politik edhe vetë Pejgamberi a.s. ka qenë qenie politike. Këtë propagandë të çoroditur e ndërmarin agjentët e imperializmit që t'ju pengojnë të mos merreni me çështjet shoqërore dhe me organizimin e luftës kundër pushtetit tradhtar dhe politikës së tyre antiislame dhe antinacionale. Ata duan të punojnë sipas qejfit të tyre dhe askush mos ua zëjë rrugën.”

NEVOJA PËR SHTET ISLAM

Vetëm teksti i Ligjit nuk mjafton për transformimin shoqëror. Që ligji të garantojë transformim të gjithanshëm dhe lumturi nevojitet pushtet ekzekutiv dhe ekzekutues. Për këtë shkak All-llahu i Gjithëfuqishëm , me shpalljen e përmbajtjes së Zakonit (d.m.th. dispozitat e Sheriatit) përcaktoi edhe forma të posaçme të pushtetit me institucione ekzekutive dhe administrative.

Pejgamberi a.s. qëndroi në ballë të institucioneve ekzekutive dhe administrative të shoqërisë islame. Me transmetimin e Shpalljes dhe me përhapjen dhe komentimin e dispozitave fetare – islame , ai u angazhua për zbatimin e ligjit dhe për vënien e themeleve të dispozitave islame , duke krijuar kështu Shtetin Islam. Ai nuk u kënaq vetëm me proklamimin e Ligjit , por ë të njëjtën kohë edhe e zbatoi , duke ua prerë duart , duke i mbuluar me gurë ose duke i rrahur me kamxhik delikuentët. Pas Pejgamberit të Ndershëm , trashëgimtari i tij pati të njëjtën funksion dhe të njëjtat detyra. Kur Pejgamberi caktoi trashëgimtari , e bëri atë që të zbatohet Ligji dhe të jetësohen urdhërat e All-llahut. Pikërisht si funksion-zbatimi i Zakonit dhe themelimi institucioneve islame – bëri që caktimi i trashëgimtarit të jetë aq me rëndësi dhe se pot ë mos jetësohej ky institucion Pejgamberi nuk do ta plotësonte misionin e Tij. Sepse , pas Pejgamberit , mislimanët do të kenë nevojë për një njeri që do t'i zbatojë ligjet dhe do të themelojë institucione islame që shoqërisë t'i sigurojë kënaqësi në këtë botë dhe në tjetrën. Në të vërtetë , për nga vetë natyra e tyre , ligje dhe institucionet shoqërore duhet patjetër të kenë organe egzekutive. Gjithmonë dhe kudo legjislacioni vetë nuk mund të sigurojë mirëqenie për njeriun. Pas themelimit të legjislaturës duhet të krijohet edhe pushteti ekzekutiv , i cili do të zbatojë ligjin dhe do t'u mundësojnë njerëzve të shfrytëzojnë ligjet në bazë të të cilave gjyqet do të sjellin aktgjykime të drejta. Mu për këtë Islami themeloi pushtetin ekzekutiv , siç themeloi edhe ligjin. Individit i cili udhëheq me këtë pushtet njihet me emrin vali emër 25).

Sunneti 26) dhe rruga e Pejgamberit janë dëshim e nevojës së patjetërsueshme të themelimit të pushtetit. Ai , siç na dëshmon historia , e themeloi shtetin vetë. U angazhua në zbatimin e ligjit , në themelimin e dispozitave islame dhe të atyre administrative. Dërgoi nëpër krahin të ndryshme mëkëmbës të vet , vetë qëndronte në gjyq dhe i emëronte gjyqtarët , dërgonte misionarë nëpër shtete të ndryshme , me kryetarë fisesh dhe me mbretër të shumë lidhte kontrata dhe hynte në pakt me ta , komandonte në luftëra. Shkurt , i kryente të gjitha funksionet shtetërore. Pastaj caktoi sundimtarin i cili do ta trashëgonte , në përputhshmëri me urdhërat Hyjnore. Fakti se All-llahu i Gjithëfuqishëm , nëpërmjet Pejgamberit e Tij , caktoi njeriun i cili do të sundonte mbi popullin muslimanë pas Pejgamberit , vetvetiu është një indikacion se pushteti mbetet nevojë e patjetërsueshme edhe pas largimit të Pejgamberit nga kjo jetë. Përveç kësaj , meqë Pejgamberi a.s. me caktimin e trashëgimtarit e shpalli publikisht urdhërin Hyjnor , madje në mënyrë implicite vërtetoi nevojën e ekzistimit të pushtetit.

Qartë shihet se nevoja e sendertimit të Zakonit , që kushtëzoi edhe formimin e pushtetit nga Pejgamberi a.s. , nuk që i kufizuar vetëm për kohën e tij , por vazhdoi të ekzistojë edhe pas largimit të tij nga kjo botë. Sipas njërës nga ajetet e shumta të Kur'anit , dispozitat islame nuk janë të kufizuar në kohë dhe në hapësirë , ato janë të përhershme dhe duhet të sendërtohen deri në fund të kohës. Ato nuk janë shpalluar

vetëm për kohën e Pejgamberit e pastaj të flaken , ashtu që ndëshkimi dhe kodi pental të mos aplikoheshin të mos aplikoheshin tatimet sipas rregulave islame dhe të mospërfillej çështja e mbrojtjes së vendeve dhe popujve muslimanë.

Deklarimi se ligjet islame mund të hiqen ose të reduktohen për kohë dhe hapësira të veçanta bie ndesh me bazat qenësore të Fesë Islame. Meqë zbatimi i Ligjit ishte i domosdoshëm edhe pas shkuarjes së Pejgamberit nga kjo botë dhe si tillë do të mbetet përgjithmonë . patjetër duhet të bëhet konstituimi i pushtetit dhe krijimi i organeve ekzekutive dhe administrative. Po qe se nuk krijohet pushteti dhe organe të atilla që do të sigurojnë zbatimin e Ligjit ashtu që të gjitha aktivitetet individuale të zhvillohen brenda një sistemi unik juridik , atëherë në shoqëri do të mbretërojë kaosi dhe anarkia dhe paraqitet korrupsioni dhe zvetnimi shoqëror e intelektual.

Edhe logjika . edhe Ligji i Zotit , pra , vërtetojnë se edhe në kohën tonë nevojitet po ajo që nevojitet edhe në kohën e Pejgamberit si dhe në kohën e Komandantit të Besimtarëve , Ali ibën Ebi Talibit r.a. e që është konstituimi i pushtetit dhe i organeve ekzekutive dhe administrative.

Që të sqarohet më mirë kjo çështje , do t'i parashtrojmë disa pyetje : A është drejtë që nga koha e Fshehtësisë së Vogël 27) e deri në ditët tona (është kjo një periudhë prej dymbëdhjetë shekujsh dhe që mund të vazhdojë edhe me qindra mileniume nëse nuk është shkruar që të paraqitet Imami i fshehur) , ligjet islame të jenë të refuzuara dhe të papërfilluar , dhe secili të veprojë si ia do pika e qejfit , dhe të mbretërojë anarkia? Zakonet në të cilat Pejgamberi a.s. u mundua njëzet e tre vjet që t'i sqarojë , t'i përhapë dhe t'i zbatojë , a mund të vlejë vetëm për një periudhë të kufizuar?

A thua All-llahu xh.sh. e kufizoi vlefshmërinë e zakoneve të Tij në dyqindvjet? Gjithçka i përket Islamit a thua do të duhej të braktisej pas Fshehjes së Vogël? Gjithsecili që ka bindje të tillë dhe e proklamon atë , është në gjendje më të keqe se sa personi që beson dhe deklaron kinse Islami është i abroguar dhe i revokueshëm me ndonjë shpallje tjetër. 28)

Askush nuk mund të thotë se edhe më tutje nuk duhet të mbrohen kufijt dhe tërësia territoriale e atdheut islamik , se nuk duhet të mblidhen tatimet siç janë xhizja , haraçi , humsi dhe zekati , se ligji penal islam , me dispozitat e tij për shpagimin e gjakut dhe për përcaktimin e ndëshkimit , duhet të anulohet.

Secili që deklaron se nuk është i nevojshëm të formohet një pushtet islam , në mënyrë implicite mohon nevojën e zbatimit të ligjit islam , karakterin universal dhe gjithëpërfshirës të këtij zakoni , dhe vlerën e përjetëshme të vetë fesë.

Pas vdekjes së Pejgamberit a.s. askush prej muslimanëve nuk dyshonte në nevojën e vënies së pushtetit. Askush nuk tha: “Neve nuk na duhet më pushteti”. Ishte e pamundshme të dëgjohet diç e tillë. Ekzistonte një pajtueshmëri unanime në lidhje me nevojën e ekzistimit të pushtetit. Mospajtime pati vetëm në lidhje me personin i cili duhej ta merrte përgjegjësinë e pushtetit dhe të vihej në krye të shtetit. Pra , pas Pejgamberit a.s. edhe në kohën e hulefave dhe të Komandantit të Besimtarëve ishte

themeluar pushteti; ishte formuar aparati shtetëror me organet e veta administrative dhe ekzekutive.

Natyra dhe karakteri i ligjeve islame dhe dispozitave Hyjnore të Sheriatit sigurojnë argumentet plotësuese për arsyeshmërinë e themelimit të pushtetit , sepse ato zakone janë sjellë me qëllim të themelimit të shtetit dhe qeverimit politik , ekonomik e kulturor.

E para , ligjet e Sheriatit ngërthejnë një tog ligjesh e rregullash që përbëjnë tërë sistemin shoqëror. Në këtë system janë theksuar të gjitha çështje më të rëndësishme : sjellja e individit ndaj fqinjëve , ndaj bashkëqytetarëve , ndaj fisit, ndaj fëmijëve dhe prindërve , çështje të jetës bashkëshortore; parashohin rregulla që i përkasin luftës dhe paqjes , komunikimit ndërmjet popujve , rregula përkatëse për sanksionet dhe ligjet e tregut; rregula që i përkasin zejtarisë dhe bujqësisë. Ligji islam përmban rregula të paramartësës , martesës e të kurorëzimit , mënyrën se si duhet lidhur atë , dhe rregulat tjera , që lidhen me zhvillimin embrional , që bëjnë fjalë për ushqimin që duhet ngrënë prindët gjatë kohës së mbarsimit... Ai në vazhdim , institucionalizon detyrat e prindit ndaj fëmijës për gjiri , dhe hollësisht përshkruhet se si duhet të edukohet fëmija , madje se si duhet të sillen bashkëshortët ndërmjet veti si dhe ndaj fëmijës së tyre.

Islami siguron ligje dhe udhëzime për të gjitha segmentet e jetës më qëllim që të krijojë qenie humane që paraqesin inkorporim të ligjit lëvizës , ose , të shprehem pak më ndryshe , të vullnetit zakonor të realizuesit instinktiv. Është e qartë se Islami sa i ka kushtuar rëndësi pushtetit dhe marrëdhënieve politike e ekonomike në shoqëri , me qëllim që të krijojë kushtet që do të kontribuojnë në formimin e qenieve shoqërore të ndershme dhe të pastra moralisht.

Kur'ani Ndershëm dhe Sunneti ngërthejnë ligje dhe norma të atilla që njeriut t'i sigurojnë mirëqenie dhe konsolidim të pozitës së tij në shoqëri. Libri el-Kafi 30) ka një kaptinë me titull "Të gjitha nevojat njerëzore janë të paraqitura në Kirab dhe në Sunnet" , në të cilin kapitull Kitab është Kur'ani që përmban "ekspozim të të gjitha gjarëve"31). Sipas disa traditave , Imami 32) betohet se Kitabi dhe Sunneti përmbajnë padyshim të gjitha gjërat e nevojshme.

E dyta , po qe se i studiojmë më për së afërmi natyrën dhe karakterin e dispozitave ligjore , do të hetojmë se zbatimi dhe jetësimi i tyre mvaret nga themelimi i pushtetit , madje janë të përealizueshme obligimet ndaj All-llahut po qe se nuk themelohen institucionet përkatëse administrative dhe ekzekutive. Do t'i përmendim vetëm disa lloje normative sa për ilustrim; të tjerat mund ti zbuloni vetë.

Tatimi dhe format e tjera të buxhetit që i parasheh Islami nuk janë vetëm për t'iu siguruar mjete për jetesë të varfërve dhe për t'i furnizuar pasardhësit e Pejgamberit a.s. Ato janë të destinuar për kompletimin e tërësishëm të pushtetit dhe për sigurimin e të dalave (shpenzimeve) .

Humsi , për shembull , është burim i madh i të hyrave që derdhen në arkën shtetërore dhe paraqet një kapitull të rëndësishëm në këtë sferë. Sipas shkollës shiite , humsi duhet të caktohet për të gjitha fitimet tregtare e bujqësore si dhe për të gjitha resurset natyrore , le të jenë ato të mbidheshme apo të nëndheshme. Shkurt , për të gjitha llojet e të hyrave e të pasurive tjera . Ky obligim vlen si për pemëshitësin përtej kësaj xhamie , po ashtu edhe për magnatin e anijendërtimtarisë ose xehetarisë.

Të gjithë ata duhet të paguajnë një të pestën e tepricës së të hyarve , pasi të jenë zbritur shpenzimet e zakonshme , lëshohen në arkën shtetërore. Qartë është se një sasi kaq e madhe e të hyrave i shërben qëllimit të konsolidimit të pushtetit islam dhe për plotësimin e nevojave financiare të tij. Sikur të llogaritnim një të pestën e tepricës së të hyrave të gjitha vendeve islame (ose të gjithë botës po t'i takonte stadi islam) do të ishte shumë e qartë se qëllimi i caktimit të këtyre tatimeve nuk është vetëm për mbajtjen e sjjideve 33) dhe ulemave , por përkundrazi diçka më e rëndësishme që është plotësimi i nevojave financiare të organeve dhe institucioneve shtetërore. Kur të arrihet pushteti islam , ai patjetër duhet të qeveriset në bazë të të dhënave që i ka paraparë Islami-e që janë humsi , zekati (që nuk paraqet shumë të volitshme 34) , pastaj xhizja dhe haraçi.

A thua sejjidëve do t'u duhej ndonjëherë një buxhet aqi madh?

Humsi i tregut të Bagdadit do të mjaftonte për nevojat e sjjideve dhe për mirëmbajtjen e medreseve si dhe të varfërve në botën islame , pavarësisht nga humsi i tregut të Teheranit , të Stambollit dhe të qyteteve tjera. Akumulimi i një buxheti aq të madh patjetër duhet t'i shërbejë formimit të pushtetit dhe qeverisjes së shteteve islame. Ai u themelua me qëllim të kënaqjes së nevojave natyrore të poullit , të shërbimeve publike , siç janë shëndetësia , arsimimi , mbrojtja dhe zhvillimi ekonomik. Pastaj në përputhje me procedurën islame për mbledhjen , ruajtjen dhe harxhimin e këtyre mjeteve materiale , pamundësohen të gjitha format e uzurpimit të paligjshëm të pasurisë shoqërore ashtu që as kryetari i shtetit e as dikush tjetër që i është besuar udhëheqja në punët shoqërore (d.m.th. anëtarët e pushtetit) s'kanë privilegje më tepër se sa qytetarët e tjerë në shfrytëzimin e begative shoqërore ; të gjithë kanë hise të njejtë. Kështu pra , këtë pasuri kolosale shtetërore – si thuani : ta hedhim në oqean apo ta djegim , deri sa të vijë Imami , ose ta harxhojnë nja pesëdhjetë sejjidë derisa të ngihen? Po t'ua japim tërë këto të holla nja 500.000 sejjidëve , ata nuk do të dinin çka të bëjnë me to.

Të gjithë e dimë se sejjidët dhe të varfërit kanë të drejtë të shfrytëzojnë nga arka shtetërore aq sa u nevojitet. Buxheti injë vendi islam është rregulluar ashtu që çdo burim I të hyrave e ka të përcaktuar mënyrën e shpërndarjes (destinacionin). Zekati , kontributet vullnetare , dhe humsi , grumbullohen dhe harxhohen ndaras. Ekziston hadith që flet për atë se sejjidët patjetër duhet ta kthejnë tepricën që e kanë marrë nga shteti. Xhizja me të cilën obligohen ehlu-dhimma 35) dhe haraçi që mbledhet bga të dhënat bujqësore , paraqesin dy burime plotësuese të rëndësishme. Institucionalizimi I këtyre tatimeve po ashtu tregon se zgjedhja e udhëheqësit dhe themelimi I pushtetit janë të domosdoshme. Është obligim I kryetarit ose I mëkëmbësit të caktojë tatimin personal të edh-dhimeve në përputhje me të ardhurat dhe fuqinë financiare të tyre , dhe të aplikojnë rregullat e parapara të tatimit për tokën e punueshme . Ai gjithashtu duhet të mbledhë haraç në ato vise të lira që janë “toka të All-llahut” ose janë në pronësi të shtetit islam. Për realizimin e kësaj detyre lypet të ekzistojë institucion I përhershëm , normadhe rregulla , masa politike dhe administrative. Ky obligim nuk mund të rezlizohet pa pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të sistemit shoqëror. Është obligim I atyre që qeverisin me shtetin islam , më së pari të caktojnë lartësinë e tatimit konform parimeve

fundamentale , pasta t'I mbledhin ato , dhe , në fund , t'I shpenzojnë në atë mënyrë që të ndihmojë për mirëqenien e muslimanëve.

Shihni , pra , se rregullat fiskale të Islamit po ashtu konfirmojnë nevojën e themelimit të pushtetit , sepse ato rregulla nuk mund të plotësohen pa themelimin e institucioneve përkatëse islame.

Dispozitat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e rregullimit shoqëror islamik , të integritetit territorial dhe pavarësisë së ummetit 36) islam gjithashtu kërkojnë formimin e pushtetit. Një shembull me interes është urdhëri: “E ju përgatituni sa të keni mundësi force , (mjete luftarake) e kuaj të caktuar për betejë kundër tyre” (Kur’ani 8:60) që parasheh organizim të forcave mbrojtëse dhe I urdhëron muslimanët që gjithmonë të jenë syçelë me pushkën gati , madje edhe në kohë paqeje.

Po të kishin vepruar muslimanët sipas këtij ajeti dhe , po të kishin ngjeshur rradhët e tyre si për rast lufte , nuk do të mundte një grusht hebrejsh të okupjë vendet tona , të ndezë dhe të shkatërrojë Mesxhiduk-Aksanë 37) , kurse populli të mos jetë i aftër t'i përgjigjet aty për aty. E gjithë kjo është rezultat i mospërbushjes së urdhërave të All-llahut xh.sh. dhe shkak i mosformimit të shtetit juridik. Kryetarët e shteteve muslimanë po të përfaqësonin denjësisht besimtarët dhe zbatonin dispozitat e All-llahut , atëherë do t'i lenin anash dallimet e parëndësishme , do të flaknin aktivitete e tyre përçarëse dhe do të bashkoheshin si gishtat e dorës. Atëherë një grusht i vogël hebrejsh qyqarë (agjentë të Amerikës , të Britanisë dhe të fuqive tjera të huaja) nuk do të ishte i aftë të bëjë atë që bëri , pa marrë parasysh ndihmën e madhe që do t'iu jepte Britania dhe Amerika. E gjithë kjo ndodhi për shkak të paaftësisë së atyre që i udhëheqin muslimanët.

Ajeti : “Përgatitni kundër tyre tërë fuqinë që mund të mblidhni” ju urdhëron që të jeni sa më të përgatitur , që armiqtë tuaj mos u shkelin dhe tiranizojnë. Mu për atë se na mungon uniteti , fuqia dhe gatishmëria , kemi mbetur të nënshtruar dhe në mëshirën e agjentëve të huaj.

Ekzistojnë një varg dispozitash të Sheriatit që nuk mund të zbatohen pa themelimin e aparatit shtetëror : për shembull , larja e gjakut që duhet të caktohet saktë dhe t'u jepet atyre që u takon , ose ndëshkimet trupore të përcaktuara me Sheriat , që duhet të ekzekutohen nën kontrollin e kryetarit musliman. Të gjitha këto ligje na rekomandojnë në institucionet e pushtetit , sepse vetëm forca e kryetarit është në gjendje të kryejë këtë funksion.

Pasi ndërroi jetë Pejgamberi a.s. armiqtë kokëfortë të fesë , emevitët 38) (malkimi qoftë mbi ta) nuk lejuan që pushteti islam të stabilizohet nën pushtetin e Ali ibën Talibit r.a.. Ata nuk lejuan ekzistimin e asaj forme të pushtetit me të cilin do të ishin të kënaqur. All-llahu I Lartësuar dhe i Gjithëfuqishëm dhe Pejgamberi më i Nderuar .

Bënë transformimin e tërë bazës së pushtetit dhe politika e tyre , në pjesën më të madhe , ishte në kundërshti me Islamin. Format e pushtetit emevit dhe abasit 39) dhe masat politike e administrative që ata i aplikonin , ishin antiislame. Me kthimin në në monarki

, kjo formë e pushtetit u bastardhua , siç që monarkia e mbretërve iranianë . e perandorëve romakë dhe e faraonëve egjiptas. Dhe , si shihni , kjo formë e pushtetit , në pjesën më të madhe joislame , arriti deri në ditët tona.

Edhe logjika , edhe Sheriati lypin që mos i lejojmë pushtetmbajtësit të kenë karakter joislamike , madje edhe antiislamik. Argumentet janë të qarta. I pari , ekzistimi i rregullimit politik joislamik domosdo ka për qëllim mosvënien e sistemit politik islam. Pra , të gjitha sistemet joislame janë sisteme kufri 40) Meqë pushtetmbajtësi në njëfarë dore është një instancë taguti 41) , e kemi borxh që t'i flakim dhe t'i shkatërrojmë të gjitha gjurmët e kufrit. Jemi të obliguar , po ashtu , të ndërtojmë rend shoqëror të përshatshëm për arsimimin e njerëzve fetarë dhe të ndershëm , ren që do të ishte tërësisht i kundërt me atë që nxori sundues tagutë dhe shirk 42) vazhdimisht prodhon zvetnim të atillë siç e keni tash në Iran , zvetnim që është quajtur “zvetnim në tokë”. 43) Ky zvetnim payjetër duhet flakur , kurse ata që nxisin duhet të dënohen për veprat e kryera. Kjo është e njëjta çoroditje që e patën shpikur faraonët me potezat e tyre politikë , për çka Kur'ani thotë : “Ai me të vërtetë ishte prej më shkatërrimtarëve” (28:4). Njeriu që është besimtar , i devotshëm dhe i drejtë , nuk mund të gjallërojë në një rreth të tillë sociopolitik dhe të mbrojtë fenë e tij dhe të sillet si duhet. Ai ka dy rrugë për të zgjedhur : të kryejë vepra që janë kufër dhe kundër të drejtës , ose , të mos kryejë vepra të tilla dhe mos i nënshtrohen urdhërave të tagutit. Njeriu i drejtë I kundërvihet dhe lufton kundër tagutit , me qëllim që ta shkatërrojë atë rreth të prishur. Ne , pra , nuk kërkojmë diç tjetër pos të rrënojmë këto sisteme që në vetvete përmbajnë zvetnim dhe i çorodisin të tjerët , si dhe duam t'i përmbysim të gjitha sistemet e korruptuara , shtypëse dhe kriminele.

Ky është obligim që duhet ta kryejë çdo musliman , në çdo nevd musliman , që të mund të jetësohet revolucioni politik islam.

Shohim , po ashtu , se si egoistët imperialistë dhe sunduesit tiranë e kanë copëtuar atdheun islam. E kanë ndarë ummetin islam copë-copë dhe artificialisht kanë krijuar kombë të ndara. Dikur ekzistonte Perandoria e madhe Osmane , të cilën imperialistët e ndanë gjithandëj. Rusia , Britania , Austria dhe fuqitë e tjera imperialiste u bashkuan në luftërat kundër Osmanlinjëve dhe secila arriti të gllabërojë pjesë të Perandorisë Osmane. Është e vërtetë se numër i konsiderueshëm i sunduesve osmanlinj nuk kanë trashëguar sistemin monarkik. Por prapëseprapë ekzistimi i Perandorisë Osmane përfaqësonte rrezik për imperialistët. Gjithnjë ka pasur mundësi që nga populli të del ndonjë njeri i drejtë dhe me ndihmën e tij (të popullit) të marrë kontrollin e shtetit dhe të përmbysë imperializmin , duke i mobilizuar pjesëtarët e kombit të vet.

Për këtë shkak , pas luftërave të shumta , imperialistët në fund të Luftës së Parë Botërore e ndanë Shtetin Osman , duke krijuar nga territori i saj nja dhjetë apesëmbëdhjetë shtete të vogla 44). Pastaj secila prej këtyre njësisve territoriale i është besuar ndonjërit prej shërbëtorëve të tyre ose ndonjë grupi të caktuar , por duhet theksuar se disa vende arritën të çlirohesh nga supremacia e agjentëve imperialistë.

Që të sigurohej uniteti i ummetit tonë , që të çlirohej atdheu i muslimanëve nga prangat e okupatorit , e në disa vende që të mund të pengohej depërtimi i imperialistëve dhe vënia e pushtetit marionet , është më se i domosdoshëm konsolidimi i pushtetit. Që të arrihet uniteti dhe çlirimi i popujve muslimanë , duhet me çdo kusht të rrënohet

pushteti i koruptuar që e kanë vendosur imperialistët , dhe patjetër jemi të detyruar të krijojmë pushtetin islam , i cili do t'i shërbejë popullit. Formimi i një pushteti të tillë do t'i shërbejë unitetit të muslimanëve; mu ashtu siç pat thënë Fatimeja Ez- Zehra 45) r.a. në një bisedë : “Imamati ekziston për të vënë rregul ndërmjet muslimanëve dhe që përçarja të zëvendësohet me unitet”.

Imperialistët me ndihmën e agjentëve politikë na kanë imponuar një sistem ekonomik jo të drejtë dhe me të e ndanë popullin tonë në dy grupe: në shtypës dhe të shtypur. Qindra milionë muslimanë janë të uritur dhe të privuar nga e drejta e mbrojtjes shëndetësore dhe arsimimit , ndërsa një numër i vogël në duart e tyre mbajnë pasurinë dhe pushtetin , kalojnë një jetë të shthurur e luksoze. Të uriturit dhe të shkelurit u desht që të luftojnë pandërpre për t'u çliruar nga shfrytëzimi i egër i plaçkitësve të tyre , lufta e tyre vazhdon edhe sot. Por rrugën e tyre e penguan disa qarqe sunduese dhe strukturat shtypëse që gjenden në krye të shteteve të tyre. Detyrë jona është që t'i shpëtojmë të shtypurit , dhe të munduarit. Duhet t'u ndihmojmë të shtypurve , kurse në anën tjetër duhet t'i urrejmë shtypësit. Kjo është mu ajo detyrë që Komandanti i Besimtarëve r.a. ua besoi dy nipave të tij në testamentin e njohur: “Bëhuni armiq të shtypësve kurse miq të të shtypurve”.

Dijtarët islamë janë të detyrua të luftojnë kundër të gjitha përpjekjeve të shtypësve që të venë monopol mbi burimet e pasurive dhe shfrytëzimin e paligjshëm të tyre. Ata nuk duhet të lejojnë që masat e popullit të mbeten të uritur , kurse plaçkitësit t'i uzurpojnë burimet e pasurive dhe të jetojnë me bollëk. Komandanti i Besimtarëve thotë: “Pranova detyrë shtetore sepse All-llahu i Lartësuar dhe i gjithëfuqishëm ka kërkuar garancë nga dijetarët islamë që të mos heshtin para grykësve dhe shtypësve , nga njëra anë , dhe nuk do të heshtin urinë dhe keqtrajtimit që u bëhen të shtypurve , nga ana tjetër. “Ja teskti i plotë të cillit i referohemi:

Betohem në Atë që e bën bërthamën të çilet , në Atë që krijoi shpirtërat e të gjitha qenjeve të gjalla , po të mos kishin qenë ata që erdhën të japin betimin , po të mos ishin obligimet e pushtetarit që m'u imponuan nga përkrahja e gjithanshme , dhe po të mos ishte garancia që All-llahu e mori prej dijetarëve islamë se nuk do të rrinë të heshtur para babëzisë dhe shfrytëzimit të egër , nga njëra anë , si dhe në flakjen e varfërisë dhe shfrytëzimit të të shtypurve , nga ana tjetër – po të mos ishin të gjitha këto , unë do t'i lëshoja frerët e pushtetit dhe për kurgjë nuk do ta kërkoja. Ju do të shihnit se kjo botë juaja , me të gjitha pozitat e rangjet , në sytë e mi është më e vogël se sa lagështira që vjen nga të teshurit e dhisë. 47)

Si mund të heshtim sot kur shohim se si banda tradhtarësh dhe uzurpuesish , agjentë të fuqive të huaja , morën pasurinë dhe mundimin e punës së qindra muslimanëve , falë përkrahjes së zotrinjve të tyre dhe forcës së bajonetave , duke mos u dhënë muslimanëve as të drejta themelore që të përparojnë. Dijetarët islamë e kanë për detyrë ta abrogojnë këtë sistem grabitqar , madje për shkak të mirëqenies së miliona qenieve njerëzore , ta rrënojnë këtë pushtet mizor dhe të formojnë pushtetin islam.

Logjik , Sheriati , praksa e Pejgamberit a.s.v.s. , praksa e Komandantit të Besimtarëve , përmbajtja e shumë ajeteve kur'anore-të gjitha këto udhëzojnë në domosdoshmërinë e formimit të pushtetit. Si shembull të traditës së imamatit do të citoj diç nga Imam Riza (48).

Abdul – Vahid ibën Muhammed ibën Abdu an-Nisaburi el-Attari ka thënë: Kam dëgjuar prej Ebul Hasan Ali ibën Muhammed ibën-Kutab al-Nisaburi , se ai ka dëgjuar për këtë traditë prej Ebu Muhammed el-Fadël ibë Sazan en-Nisaburit. Nëse dikush pyet: Pse i Gjithdishi i caktoi ata aty të jenë në pushtet , kurse ne na urdhëroi t'u nënshtrohemi? Atëherë ne u përgjigjemi : për shumë arsye. Ja njëra arsye: Njerëzve u është urdhëruar t'u përmbahen disa normave të caktuara dhe mos i tejkalojnë ato. Kjo nuk do të arrihet as të vërtetohet po qe se mbi të nuk vihet një tutor që do të garantojë rahatit dhe mos lejojë që dikush të sharrojë në humnerë. Po të mos ketë një tutor të tillë askush nuk do të bindte në zvetnim që mund të përciilej te të tjerët. Arsyeja e dytë është se asnjëherë nuk ka pasur një grup njerëzish , e as popull , pa ndonjë sundues e lider , mbase është e nevojshme për interesat fetare dhe jetësore. Nuk do të përkonte me urtinë Hyjnore , sepse Ai , i Gjithëfuqishmi , e di se njerëzve u nevojitet një udhëheqës që të mund të jetojnë , të gjenden në jetë.

Në realitet , nëpërmjet udhëheqësve u mundësoi që njerëzit të luftojnë kundër armikut , të ndanë prehtë e luftës , të ruajnë solidaritetin e bashkësisë së tyre , të pengojnë shtypjen e mizoritë e shtypësve.

Arsye tjetër është se : po të mos kishte caktuar All-llahu udhëheqës të besueshëm , të kujdeshëm , të vryshëm , bashkësia do të ngecte , feja do të zhdukej , kurse normat që janë shpallur do të pësonin ndërrime radikale. Pastaj , ngase njerëzit janë të papërkryer dhe të pa kompletuar që të mund të logjikojnë si duhet nga këndvështrime të ndryshme. Pra , po të mos kishte përkujdesës që të ruajnë atë që është shpallur nëpërmjet Pejgamberit , do të mbretëronte degjenerimi , ashu siç e kemi përshkruar. Ligjet e shpallura , normat , dispozitat dhe feja do të ndërroheshin dhe ky do të ishte edhe një hap më afër degjenerimit të tërë njerëzisë. (49)

Na mbeti pa analizuar pjesa e parë e hadithit që i përket çështjet misionare , edhe pse përkon me diskutimin tonë. Ajo që na intereson neve është pjesa e dytë , të cilën do ta parafranojmë.

Sikur të pyesë dikush “Pse All-llahu i Gjithëdishi i përcaktoi (misionarë-shën. i përkthyesit) ata që kanë pushtetin , kurse ju ju urdhëroi t'u nënshtrohemi? përgjigjuni kështu : “Ai veproi ashtu për shumë shkaqe dhe arsye. Një prej tyre është se njerëzve iu është treguar rruga e drejtë dhe iu është urdhëruar që mos largohen nga ajo rrugë , as t'i tejkalojnë kufijt e së lejuarës , sepse , po të largohen nga rruga e drejtë , do të binin viktimë e degjenerimit. Po njerëzit nuk janë në gjendje t'i përmbahen rrugës së drejtë dhe të jetësojnë ligjet e Zotit , prandaj duhet të emërohet një person i besueshëm (ose pushtet) që do të jetë kompetent për këtë , dhe nuk do të lejonte që njerëzit të dalin nga suazat e asaj që është e lejueshme dhe që nuk do të merrte nëpër këmbë të drejtat e të tjerëve. Po qe se nuk emërohet një person ose pushtet me restriksione të tilla , askush me vetëdëshirë nuk do të hiqte dorë nga kënaqësitë që do t'u shkaktonte dëm të tjerëve. Gjithë-secili do t'i shtypte të tjerët për shkak të interesave vetanake.”

“Shahku i dytë dhe arsyeja e dytë është : a s’shihni se asnjëherë s’ka mundur të ekzistojë ndonjë grupacion , popull ose bashkësi religjioze pa ndonjë udhëheqës që do angazhohej për zbatimin e ligjit dhe për mirëmbajtjen e institucioneve – shkurt : pa një kryetar ose lider. Sepse , personi i tillë ka rëndësi të veçantë për realizimin e parimeve fetare dhe çështjeve jetësore. Nuk është e lejuar , sipas kësaj , konform Urtisë Hyjnore , që All-llahu të lejë njerëzit , krijesat e veta , pa liderë ose udhëheqës , sepse Ai fort mirë e di se jeta e tyre mvaret nga ekzistenca e individëve të tillë. Sepse , nën udhëheqjen e tij , ata luftojnë kundër armiqtëve të tyre , i ndajnë të mirat shoqërore ndërmjet veti , falin namazin e xhumasë dhe i kryejnë ibadetet e tjera bashkarisht , ua presin duart delikuentëve që ua shkelin të drejtat të shtypurve.”

“Ja edhe një arsye tjetër : po të mos u kishte caktuar All-llahu Imam njerëzve , që të kujdeset me Sheriatin dhe rregullin shtetror , që besnikërisht t’iu shërbejë njerëzve si një kujdestar i zellshëm , atëherë feja do të bunte pre e mplakjes dhe shkatërrimit. Dispozitat dhe institucionet e saj do të humbeshin , ritet dhe zakonet islame do të transformoheshin , ose do të shtrembëroheshin. Risimtarët heretikë do t’ia mveshnin fesë disa gjëra të kota , kurse ateistët dhe pabesimtarët do t’i kishin mangësuar , për t’ua prezentuar muslimanëve në formën jo të drejtë. Shihet , pra , se si njerëzit janë të prirur drejt çoroditjes. Ata nuk janë të përsosur dhe patjetër duhet të mundohen të bëhen të tillë. Përveç kësaj , ata grinden ndërmjet veti , pasi kanë aspirata të ndryshme dhe qëndrime të paharmonizuara. All-llahu po të mos kishte caktuar për njerëzit një njeri që të vente rregull , që të ruante Ligjin“ dhe të kujdesej për Shpalljen që e transmetoi Pejgamberi në mënyrën që e përshkruam , njerëzit do të binin viktimë e çoroditjes. Ligjet islame , ritet dhe adetet tona do të transformoeshin , feja dhe përmbajtja e saj tërësisht do të ndryshoheshin , dhe do të shkaktonte prishjen e tërë gjinisë njerëzore.

Siç mund të konstatojmë nga këto fjalë të Imamit , paqja qoftë mbi të , ekzistojnë shumë argumente që rekomandojnë domosdoshmërinë e zgjedhjes së një autoriteti. Këto janë argumente , me vlera të qëndrueshme , të pakufizuara në kohë , për këtë arsye edhe domosdoja e formimit të pushtetit është i përjetshëm. Gjithnjë do të ndodhë që njerëzit t’i tejkalojnë normat islamike , dhe t’i shkelin të drejtat e të tjerëve për hirë të rehatësi dhe interesit të vet. Nuk mund të thuhet se raste të tilla ka pasur vetëm në kohën e komandantit të Besimtarëve , paqja qoftë mbi të , dhe pastaj të jenë bërë njerëzit melekë. Urtësia e Krijuesit vendosi që njerëzit të jetojnë në harmoni me parimet juridike dhe të veprojnë Brenda kufijve të caktuar mbi bazën e Drejtësisë Hyjnore.

Kjo urti është e përjetshme dhe e prandryshueshme dhe është njeri prej attributeve të All-llahut të gjithëfuqishëm. Kështu pra , sot dhe gjithmonë , ekzistimi i bartësit të autoritetit , pushtetmbajtësit që vepron si kryetar dhe mbrojtës i ligjeve dhe institucioneve islame paraqesin domosdoshmëri . Kryetari i cili pengon shkeljen e të drejtave të të tjerëve , i cili është dinjitoz dhe mbrojtës i denjë i krijesave të Zotit , i cili udhëheq njerëzit sipas mësimëve , doktrinave , ligjeve dhe institucioneve islame , dhe pengon ndërrimet e padëshirueshme të cilat ateistët dhe armiqtë e fesë duan t’i shtijnë në ligjet dhe institucionet islame. Halifati i Komandantit të Besimtarëve a thua nuk i ka shërbyer këtij qëllim?

Të njëjtët faktorë që e detyruan të bëhet imam edhe sot e kësaj dite janë evidentë : dallimi i vetëm është se asnjë person nuk është caktuar për atë detyrë. 50) Parimi i domosdoshmërisë së pushtetit është mbështetur në parimet e përgjithshme dhe gjithnjë do të jetë frytdhënës.

Nëse dispozitat islame do të jenë të domosdoshme të mbeten në fuqi , nëse do të duhet të pengohet shkelja e të drejtave të dobtëve nga ana e klasës shtypëse , nëse duhet që pakicës sunduese mos i lejohet të plaçkisë dhe të shkatërojë popullin për shkak të interesit material dhe të vetkënaqësisë , nëse duhet të ruhet rendi shoqëror islamik dhe të shkohet rrugës drejt pa asnjë përjashtim , nëse duhet të pengohen bidatet dhe tendencat antiislame nga ana e të ashtuquajturve parlamentarë , 51) nëse në vendet islamike duhet patjetër të shuhet ndikimi i fuqive të huaja – pushteti është më se i domosdoshëm. Asnjëri prej këtyre qëllimeve nuk do të arrihet pa konstituimin e organeve të shtetit. Natyrisht , është i domosdoshëm pushteti juridik , në krye të të cilit do të qëndronte kryetari i denjë dhe kujdestari i drejtë. Ata të cilit na kan nënshtuar janë krejtësisht të padobishëm , seose janë tiranë , të prishur moralisht dhr jokompetentë.

Ne në të shkuarën nuk kemi vepruar bashkarisht që të themelojmë pushtet juridik dhe të përbysim kryetarët e korruptuar dhe tradhëtarë. Disa njerëz ishin zemërngushtë , madje kundërshtonin themelimin e pushtetit islam , madje disa shkuan aq larg saqë hymnizuan kryetarët mizorë. Mu për këtë kemi ardhur në këtë situatë. Në shoqëri kanë rënë ndikimi dhe sovraniteti i Islamit. Islami ra viktimë i ndasive dhe dobësive të ndryshme. Zakonet islame u hoqën , ose u janë nënshtuar ndryshimeve e modifikimeve gjithëfarëshe. Imperialistët kanë propaganduar ndër muslimanë ligje dhe kulturrë të huaj me ndihmën e agjentëve të tyre , kanë arritur t’ua bëjnë joshës Perëndimin. Kjo ka shkaktuar mungesën e liderëve ndër ne , si dhe mungesën e institucioneve të udhëheqjes. Ne na duhen organe të pushtetit juridik. Sa vetvetiu duket.

FORMA E PUSHTETIT ISLAM

Pushteti islam nuk vjen në kolizion me asnjë formë të pushtetit ekzistues. Ky pushtet nuk është tirani , sepse në pushtetin tiranik kryetari i shtetit mund të veprojë sit ë dojë me pasurine dhe jetët e njerëzve; pra duke e shfytëzuar e duke i vrrarë mizorisht , kurse dikujt duke i dhënë pasuri të shumta nga arka shtetërore. Pejgamberi a.s, Komandanti i Besimtarve r.a. si dhe halifët e tjerë nuk kanë pasur ingerenca të tilla. Pushteti islam nuk është as tirani , as pushtet absolutist , por është pushtet kushtetues i bazur në mendimin e shumicës , në përputhshmëri të plotë me parimet kur'anore dhe me sunetet e Pejgamberit a.s. ligjet dhe dispozitat islame përbëjnë një tog konditash që patjetër duhet të respektohen dhe të praktikohen. Sipas kësaj , Pushteti islam mund të përkufizohet si sundim i Ligjit të Zotit mbe njerëzit.

Dalimi themelor ndërmjet Pushteti islam , nga njëra anë , dhe monarkisë kushtetuese dhe republikës , nga ana tjetër , konsiston në këtë: përderisa në regjimet e tilla , me rastin e aprovimit të ligjit shpërndahen përfaqësuesit e popullit dhe monarku , në Islam pushteti i ligjdhënës i takon vetëm All-llahut te Gjithëfuqishëm dhe vetëm Atij i takon të sjellë lifjin. Ligjdhënësi i Shenjtë Islam është i vetmi pushtet legjislativ. Askush nuk ka të drejtë të sjellë zakone , as që të zbatojë ndonjë zakon tjetër , përveç Ligjit të Ligjdhënësit Hyjnor. Pikërisht për këtë , në pushtetin islam Kuvendi legjislativ është njeri prej tri segmenteve të pushtetit. Ky trup legjislativ sjell programet e ministrive sipas dispozitave islame dhe përcakton se cilat shërbime publike do të qeverisin me pushtetin.

Muslimanët i kanë përvetësuar tërësisht ligjet islame të proklamuar bë Kur'an dhe Sunnet , dhe iu përmbahen atyre në mënyrë dinjitoze , duke i konsideruar ato si ligj të popullit.

Përkundrazi , në monarkitë kushtetuese , shumica e atyre që deklarojnë se janë përfaqësues te shumicës së popullit miratojnë ligje që u pëlqejnë atyre dhe pastaj ia imponojnë tërë popullatës.

Pushteti islam është pushtet i sheriatit. Në këtë formë të pushtetit sovraniteti i takon vetëm All-llahut xh.sh. kurse Sheriati është urdhëri i Tij. Ligji Islam , Urdhëri Hyjnor , ka autoritet absolute mbi çdo individ si dhe mbi pushtetin islam. Të gjithë , duke përfshirë këtu edhe Pejgamberin a.s. dhe sahabët e tij , ju patën nënshtuar Sheriatit dhe ky Ligj do të mbetet i pandryshueshëm për gjithnjë , sepse All-llahu i Gjithëfuqishëm e ka sqaruar në gjuhën e Kur'anit dhe atë të Pejgamberit më të Ndershëm. Fakt është se Pejgamberi mori detyrën e mëkëmbësit të Zotit në Tokë , All-llahu i Gjithëfuqishëm dhe i Lartmadhërishti e caktoi përfaqësues të Tij (“Mëkëmbës i All-llahut në tokë”); ai nuk themeloi pushtetin me iniciativën e vet që të bëhëj lider i muslimanëve. Po ashtu kur filloi të hetojë se ndërmjet muslimanëve do të paraqiteshin mospajtime , sepse njohuritë e tyre fetare ishin të kufizuara , All-llahu i Lartësuar nëpërmjet Shpalljes e

obligoi Pejgamberin që menjëherë , qoftë edhe në mes të shkretëtirisë , të zgjedhë çështjen e trashigimisë (së pushtetit – shën. i përkthyesit). Atëherë Pejgamberi më i ndershëm emëroi Komandantin e Besimtarëve (paqja qoftë mbi të) për trashëgimtar të tij , në përputhje me Ligjin. Jo pse ky ishte dhëndër i tij , ose pse i kryente disa shërbime me rëndësi , por për atë se ishte sjellë ndaj Ligjit të All-llahut me përgjegjësinë më të madhe 52).

Në Islam , pra , pushteti shkon me Ligjin : Ligji është i vetmi mekanizëm që shërben si udhërrëfyes e shoqërisë. Madje dhe pushteti i kufizuar që iu pat dhënë Pejgamberit a.s. dhe atyre që e trashiguan atë pushtet prej ytij , iu pat ardhur prej All-llahut. Sa herë që Pejgamberi komentonte diçka ose kur proklamonte ndonjë rregull , e bënte me bindje të thellë ndaj Ligjit të Zotit , të cilit Ligj çdokush , pa përjashtim , duhej t’i nënshtrohet. Ligji i Zotit vlen si për udhëheqësit , po ashtu edhe për të nënshtrouarit. Ligji i All-llahut është i vetmi ligj i plotëfuqishëm që duhet aplikuar. Përlujta Pejgamberit bëhet po ashtu në përputhje me urdhërat e Zotit: “Dhe përlujta Pejgamberit” (Kur’ani,4:59). Mendimi individual , le të jetë edhe mendimi i Pejgamberit , nuk mund të ndërhyjë në çështjet e pushtetit dhe të Ligjit të Zotit. Këtu të gjithë i janë nënshtroar dëshirës së All-llahut.

Pushteti islam nuk është formë e pushtetit monarchist , as që është pushtet imperialist. Në një tip pushteti të këtillë , pushtetmbajtësit kanë pushtet mbi pasurinë dhe mbi shtresën e nënshtrouar. Islami nuk ka kurgjë të përbashkët me një formë të këtillë sundimi. Në pushtetin islam , për dallim prej pushteteve tjera monarkiste e imperialiste nuk sheh kund palate të larta , luksoze , shërbëtorë dhe vasalë , kujdestarë kuajsh , agjutantë të trashëgimtarëve të fronit që harxhojnë gjysmën e buxhetit të shtetit. Të gjithë ju e dini se si ka jetuar Pejgamberi , i cili ishte edhe kryetar i Shteti Islam. Të njejtren mënyrë të jetës ruajtën edhe trashëgimtarët e parë deri në fillim të Parandorisë Emevite (Omajade). Dy trashëgimtarët e parë të Pejgamberit shkuan rrugës së tij , në organizimin e jashtëm të jetës personale , edhe pse në çështjet e tjera bënë gabime , që sollën një varg devijimesh në kohën e Othmanit r.a. , pikërisht ato devijime që edhe sot na kanë sjellë shumë telashe 53). Në kohën e Komandantit të Besimtarëve (paqja qoftë mbi të) sistemi i pushtetit ishte i drejtë , ashtu që ai njeri i jashtëzakonshëm arriti të sundojë gjithë atë mbretëri , të cilës ia bashkangjiti edhe Iranin , Egjiptin , Hixhazin dhe Jemenin. Jetoj duke kursyer më shumë se nxënësi i tij më i varfër. Njëherë pat blerë dy xhybe , njëra ishte më e mirë. Të mirën e mbajti për vete , por , ngase mangët ishin shumë të gjata , ishkurtoi. Ja pra me çka është veshur kryetari i mbretërisë së madhe e të pasur , dhe me popullsi aqë të dendur.

Sikur të ishte ruajtur kjo mënyrë e sjelljes dhe sikur pushteti ta kishte ruajtur formën a modelin islam , nuk do të kishte monarki e as mbretëri , as uzurpime të jetës dhe të pasurisë së njerëzve , as shtypje e as plaçkitje , as abuzime të pasurisë shoqërore , as imoralitet e as sjellje të poshtra.

Numri më i madh i formave të koruptuara rrjedhin prej klasës sunduese , prej familjes tiranikë në pushtet dhe prej njerëzve të shfrenuar që shoqërohen me ta.

Pëkirisht ata kryetarë janë themelues të qendrave të korrupsionit , të prostitucionit dhe të konsumimit të alkoolit , dhe të ardhurat nga zekati i harxhojnë për ndërtimin e kinemave. 55)

Po të mos ishin këto ceremoniale të mbretërve të shfrenuar 56) , nuk do të kishte as harxhime mendjehetësh , as degjenerime të pareshtura të shoqërisë. Madje asnjëherë nuk do të kishte defiçit të buxhetit kombëtar , për ç'arsye sot jemi të detyruar t'u përulemi Amerikës dhe Britanisë dhe prej tyre të lypim ndihma dhe kredi. A thua , vallë , vendi u vafërua nga harxhimet e paskrupullta dhe nga degjenerimi , ose për atë se na mungon nafta? A thua s'kemi xehe dhe resurse tjera natyrore? I kemi të gjitha të mirat , por ky parazitizëm , ky degjenerim , ku shfrenim – të gjitha këto bëhen në llogari të popullit – na solli neve këtë gjendje të mjerueshme. A thua se ai (Shahu) kishte nevojë aq shpesh të shkonte në Amerikë dhe t'i përulej atij vjedhësit , madje t'i kërkonte ndihmë.

Përveç kësaj , burokracia e panevojshme , sistemi i qarkulimit të parave që është i imponuar , dhe që është tërësisht i huaj për Islamin , imponon edhe më tutje harxhime të shumta të buxhetit shtetëror , në sasi aq të mëdha asqë i tejkalojnë harxhimet e kategorisë së parë. Ky system administrative nuk ka kurgjë të përbashkët me Islamin. Formalitetet e panevojshme që nuk i ofrojnë popullit tonë kurrfarë lehtësimesh , porse i sjellin fatkeqësi e telashe , që s'i përkasin Islamit.

Për shembull , metoda që e aplikon Islami për mbrojtjen e të drejtave të njeriut , për zgjidhjen e kontesteve gjyqësore është shumë e thjeshtë , praktike dhe efikase. Sikur të aplikoheshin metodat e Drejtësisë Islame , gjykatësit në çdo qytet me ndihmën e vetëm dy nëpunësve , me penë e ngjyrë , do t'i zgjidhnin kontestet gjyqësor shumë shpejt dhe do t'i kthenin njerëzit në punët e tyre. Por , sot organizata burokatike e Ministrisë te Drejtësisë ka marrë përmasa të atilla që të mos mund t'i kryejë obligimet e veta , ngase është e pa aftë krejtësisht.

Pikërisht gjërat e këtilla shkaktuan që vendi ynë të varfërohet dhe most ë jete në gjendje të prodhojë kurgjë tjetër pos të bëjë harxhime marmandëse.

KUALIFIKIMI I SUNDIMTARIT

Kualifikimi që duhet ta ketë sundimtari mvaret drejtpërdrejt nga natyra dhe forma e Pushtetit islam. Përveç dy veçorive të përgjithshme , që janë inteligjenca dhe aftësia organizative , ekzistojnë edhe dy kualifikime permanente.

Njohja e ligjit dhe e drejtësisë. 57)

Pas largimit të Pejgamberit a.s. nga kjo jetë pati mjaft polemika në lidhje me identitetin e personit që duhet ta trashëgojë Pejgamberin , port ë gjithë muslimanët u pajtuan me atë që trashëgimtari të jetë i dishëm dhe përkryer : mospajtme pati vetëm në çështjen e identitetit.

Meqenëse Pushteti islam është pushtet i Ligjit , është e patjetërsueshme që sundimtari ta njohë Ligjin , siç e do tradita. Madje , të njohish ligjin nuk është e domosdoshme vetëm për sundimtarin , por edhe për të gjithë nëpunësit që kryejnë funksione të ndryshme. Por , sundimtari duhet t'ua kalojë të gjithëve me dije. Për të fituar legjitimitetin e Imamit , imamët tanë kanë konfirmuar se sundimtari patjetër duhet të jetë më i dishëm se të tjerët. Disa vërejtje që vijnë nga ulematë shiitë kanë të njëjtin qëllim. Një njeri e ka pyetur halifin për një çështje ligjore , kurse ai nuk ka ditur t'i përgjigjet. Pra , ka qenë i paaftë që të jetë në pozitën e liderit dhe të trashëgimtarit të Pejgamberit. Ose ka bërë diçka që bie ndesh me dispozitat islame; nuk ka qenë i dënje për atë pozitë të lartë.

Të njohish Ligjin dhe drejtësinë , në sy të muslimanëve , janë dy veçori themelore. Në krahasim me këto , gjërat e tjera janë më pak të rëndësishme. Njohja e natyrës së melekëve , për shembull . ose cilësitë e Krijuesit , të Gjithpushtetshëm e të Lartësuar , nuk janë çështje të udhëheqësit.

Në këtë aspekt ai që i njeh shkencat natyrore , i zbulon fshehtësitë e natyrës; ai që e njeh artin e muzikës nuk do të thotë se është aftësuar të bëhet udhëheqës , që do të thotë se nuk ka përparësi para atyre që e njohin Ligjin islam dhe janë të drejtë. Çështjet më të rëndësishme që janë shqyruar edhe gjatë kohës së Pejgamberit a.s. dhe gjatë kohës imamëve tanë , të cilat i kanë pranuar muslimanët unanimisht , janë: 1) dituria e sundimtarit ose halifes . d.m.th. njohja e ligjeve dhe dispozitave islame dhe 2) drejtësia e tij , d.m.th. të ketë përsosshmëri morale dhe të besimit.

Është e ligjikshme nevoja e këtyre veçorive , sepse Pushteti islam është pushtet Ligji , e jo despozitëm i individit ndaj njerëzve , ose mbisundimi i një grupi mbi tërë popullin. Po qe se sundimtari nuk e di përmbajtjen e Ligjit , atëherë nuk është i aftë të sundojë. Sepse nëse sundimtari shqipton dënimet sipas të tjerëve , atëherë ai e ka ngushtuar mundësinë e sundimit. Po qe se nuk aplikon një udhëheqje të drejtë nuk mund t'i jetësojë ligjet islamike. Parimi se “fakihu ka autoritet mbi sundimtarin” është i njohur. Nëse sundimtari i takon Islamit , ai patjetër duhet të jetë i mvarur prej fakihut dhe të konsultohet me të për ligjet dhe dispozitat islame , në mënyrë që t'i zbatojë ato

denjësisht. Me atë rast sundimtarët e vërtetë janë vetë fukaha 59) , ashtu që pushteti edhe zyrtarisht duhet t'u takojë atyre. Pushteti duhet t'iu besohet atyre (sundimtarëve – shën. i përkthyesit) e jo individëve që janë të detyruar të zbatojnë këshillat e fukahave për shkak të mos njohjes së Ligjit.

Natyrisht , nuk është e domosdoshme që të , gjithë nëpunësit , funksionarët dhe mäkëmbësit provincial , t'i dinë ligjet islame dhe të jenë fukaha. Mjafton të dinë ligjet që janë në lidhje të ngushtë me punët e funksionit të tyre. Kështu ka qenë edhe në kohën e Pejgamberit a.s. dhe të Komandantit të Besimtarëve e.a.. Autoritetet më të mëdhenj duhet të këndë dy cilësitë e përmendura – dituri të gjithëmbarshme dhe drejtësi , kurse ndihmësit e tij , nëpunësit dhe misionarët e caktuar nëpër province duhet të dinë zakonet relevante për të kryer obligimet e tyre.

Për gjërat e tjera patjetër duhet të konsultohen me sundimtarin.

Sundimtari po ashtu , duhet të ketë moral të lartë dhe besim të fortë. Patjetër të jetë i drejtë dhe i mbrojtur prej mëkateve. Ai që dëshiron të shqiptojë dënimet sipas dispozitave islame (d.m.th. të zbatojë ligjin penal) , të mbikëqyrë arkën shtetërore , të hyrat dhe të dalat e shtetit , dhe All-llahu t'I japë fuqi të qeverisë me njerëzit e Tij , nuk mund të jetë mëkatar. All-llahu në Kur'an thotë: “Premtimi im nuk i përfshin gabimtarët”(2:124). Sipas kësaj , Ai nuk do t'i japë funksione të tilla një shtypësi dhe mëkatarin.

Nëse sundimtari nuk sillet drejt në ndarjen e drejtësisë ndërmjet muslimanëve , nuk do të jetë i drejtë edhe në grumbullimin e tatimeve si dhe në zbatimin e ligjit penal. Në këtë mënyrë iu mundësohet edhe njerëzve të besueshëm që të imponojnë qëndrimet e veta dhe të keqpërdorin arkën shtetërore.

Pra , qëndrimi shiit lidhje me pushtetin dhe karakterin e individit që i besohet një detyrë me përgjegjësi , i njohur qysh në kohën që pasoi pas largimit të Pejgamberit nga kjo jetë dhe deri në kohën e fillimit të Fshehtësisë 61).

Hollësisht është përshkruar se sundimtari patjetër duhet ta njohë Sheriatin dhe dispozitat islame dhe patjetër duhet të jetë i drejtë në zbatimin e tyre.

Sot , kur gjendemi në kohën e fshehjes së Imamit (paqja qoftë mbi të) është e domosdoshme që të ruhen dispozitat islame që i përkasin pushtetit , dhe të pengohet anarkia. Sipas kësaj , gjithmonë është e domosdoshme vënia e pushtetit legjitim.

Njëmend na imponohet të konstituojmë pushtetin që të mund të mbrohem nga agresioni dhe të mbrojmë dinjitetin e muslimanëve në rast sulmi. Sheriati na këshillon që të jemi të gatshëm të mbrohem nga ata që duan të na sulmojnë. Pushteti , me organet e veta juridik dhe ekzekutive , është i detyruar që të pengojë njerëzit të mos ia uzupojnë të drejtat njëri-tjetrit. Asnjë prek këtyre qëllimeve nuk mund të realizohet vetvetiu : duhet themeluar pushtetin.

Meqenëse për themelimin e pushtetit nevojitet buxhet i konsiderueshëm , Ligdhënësi i Shenjtë hollësisht e ka sqaruar karakterin e buxhetit dhe të tatimeve , siç janë haraçi , humsi , zekati etj.

Meqenëse All-llahu i Gjithëfuqishëm nuk ka caktuar asnjë njeri që të marrë pushtetin në kohën e Fshetësisë , atëherë çka duhet bërë? A thua duhet të braktisim Islamin? A na duhet edhe më tutje? A thua Islami ka qenë i vlefshëm vetëm për dyqind vjet? A mos i ka trajtuar Islami detyrat tona sipas gjërave tjera , e jo sipas aspektit të pushtetit?

Të mos kesh pushtet islam do të thotë t'i lëshë kufijt tanë të pambrojtur. A mund të qëndrojmë duarkryq , përderisa armiqtë tanë bëjnë çka u do qejfi? Për gjithë këtë ende nuk kemi përgjigje të duhur. A mund të pranojë dikush se ashtu duhet të jetë? Ose përgjigja mund të jetë: pushteti është i domosdoshëm dhe se funksionimi i pushtetit ka qenë në rregull që në fillim të Islamit e deri në kohën e Imamit të Dymbëdhjetë (paqja qoftë mbi të) dhe në kohën e Fshehtësisë , edhe pse ai nuk caktoi askend për të kryer atë funksion?

Dy veçori , njohja e Ligjit dhe drejtësia , sot janë të pranishme te një numër i vogël i fukahave. Po të vepronin ata bashkërisht , do të mund të venin pushtetin e të drejtës universale në tokë.

Po të paraqitet një njeri i denjë që i ka këto dy cilësi dhe vendon pushtet të drejtë , ain ë udhëheqjen e tij do të kishte autoritet si Pejgamberi më i Nderuar (paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të) dhe të gjithë njerëzit do t'i bindeshin atij.

Është rrenë dhe ide e gabueshme e dhënë se autorizimet e Pejgamberit a.s. kanë qenë më të mëdha se autorizimet e Komandantit të Besimtarëve (paqja qoftë mbi të) ndërsa autorizimet e tij – më të mëdha se të fakihut. Natyrisht , virtytet e Pejgamberit më të Nderuar kanë qenë më të mëdha sesa të gjithë gjinisë njerëzore , kurse pas Tij Komandanti i Besimtarëve ka qenë njeriu më i paqortueshëm në botë.

Por , superioriteti , duke marrë parasysh virtytet shpirtërore , nuk ia shton autorizimiet sundimtarit. All-llahu iu ka dhënë të njëjtat autorizime pushtetit actual sikur që i kanë pasur Pejgamberi a.s. dhe Imamët (paqja qoftë mbi të) për të mbledhur dhe për të mobilizuar ushtrinë , për të caktuar mëkëmbës dhe nëpunës , për të grumbulluar tatimin dhe për të harxhuar ato të ardhura për të mirën e mislimanëve. Sot nuk merret parasysh personaliteti i dikujt , sepse pushteti i takon atij që posedon dije dhe është i drejtë.

Kur themi se në kohën e Fshehtësisë fakihu ekonomik ka pasur njëjtin autoritet siç e kanë pasur Pejgamberi me i ndershëm dhe Imamët , nuk duhet kuptuar se statusi i fakihut është identik me statusin e Imamit apo të Pejgamberit. Sepse , ne këtu nuk flasim për statusin , pose për funksionin. Me nocionin autoritet nënkuptojmë pushtetin , qeverisjen e vendit , zbatimin e ligjeve të shenjta të Sheriatit. Kjo paraqet obligim të rëndë dhe serioz dhe nuk i garanton askujt status të jashtëzakonshëm që do ta ngrinte mbi nivelin e natyrës se zakonshme të njeriut. Me fjalë tjera , autoriteti këtu ka kuptimin e pushtetit , administrimit dhe zbatimit të Ligjit. Ndryshe nga bindja e shumë njerëzve . ai nuk është privilegj por përgjegjësi e madhe. Pushteti i fakihut është racional dhe çështje e jashtme 62). Ai ekziston vetëm si lloj emërimi , siç është emërimi i kujdestarit të fëmijëve të rinj.

Në aspektin e dtyrave dhe të pozitës , nuk ekziston dallim ndërmjet kujdestarit të një populli dhe të kujdestarit të një fëmije të ri. Imami , ashtu siç ka mundur të caktojë dikend për kujdestar të jomoshërriturve , po ashtu është dashur të caktojë ndonjë për

mëkëmbës në provincë ose në ndonjë pozitë tjetër. Në rastet e ketilla , nuk është e logjikshme të ekzistojë dallimi ndërmjet Pejgamberit dhe Imamit , nga njëra anë , dhe fakihut të drejtë , në tjetrën anë.

Njëra prej çështjeve me rëndësi . për të cilën fakihu duhet të ketë kujdes , është aplikimi i masave ndëshkuese sipas Islami. A mund të ketë divergjenca në lidhje me këtë ndërmjet Pejgamberit më të Ndershëm , Imamit dhe fakihut?

A thua se fakihu do të parashih më pak të rëna me kërbag pse i takon rendit më të ulët? Në të vërtetë , dënimi për kurorëshkelësin është njëqind të rëna me kërbag.

Po qe se Pejgamberi shqipton dënimin , a thua ai duhet të dënojë të akuzuarin me njëqind e pesëdhjetë të rëna , Komandanti i Besimtarëve me njëqind të rëna kurse fakihu me pesëdhjetë ?

Sundimtarët mbikëqyrin pushtetin ekzekutiv dhe kanë obligimi të zbatojnë ligjin e All-llahut. Nuk prish punë se a është ai Pejgamberi më i Nderuar , Komandanti i Besimtarëve ose përfaqësuesi a gjykatësi të cilin ai e ka emëruar në Basra ose në Kufe. E njëjta gjë vlen edhe për fakihun.

Çështje tjetër me rëndësi si për Pejgamberin më të Nderuar po ashtu edhe për Komandantin e Besimtarëve ka qenë grumbullimi i tatimit , humsit , zekatit , xhizjes dhe haraçit. Atëherë , kur Pejgamberi mblidhte zekatin , sa ka mundur të marrë? Një të dhjetën në një vend kurse një tënjëzetën në vendet e tjera? Si ka vepruar Komandanti i Besimtarëve kur erdhi në sundim? E si do të vepronte sot njëri prej fakihëve më të shquar , a do të mund të imponojë autoritetin e vet? Në rastet e ketilla , a mund të ketë ndryshim ndërmjet autoritetit të Pejgamberit më të Nderuar , të Aliut dhe të fakihut? All-llahu i Gjithëfuqishëm caktoi Pejgamberin më të Nderuar sundimtarë të të gjithë muslimanëve; përderisa ishte gjallë autoriteti i tij shtrihej të të gjithë , madje edhe te Aliu. Më vonë Imami kishte autoritet mbi muslimanët , madje edhe mbi trashigimtarin e vet si Imam; urdhërat e tij vlenin për të gjithë , ai ka mundur të emërojë dhe të pushojë nga puna gjykatësit dhe mëkëmbësit.

Autoritetin , që kanë pasur Pejgamberi dhe Imamët në themelimin e pushtetit , në zbatimin e Ligjit , në administrimin e punëve , e ka edhe fakihu. Por , Fukahatë nuk kanë autoritet absolute mbi fukahatë e tjerë të të njëjtës kohë , që të mund t'i emërojnë ose t'i ndërrojnë. Nuk ekziston hierarki e cila e rradhit një fakih mbi tjetrin , ose që i jep njërit më shumë autoritet se tjetrit.

Meqenëse kjo është sqaruar edhe më herët fukahatë , në mënyrë kolektive dhe individuale , duhet të bëjnë çmos për themelimin e pushtetit , për zbatimin e Ligjit islam dhe për mbrojtjen e territorit në vet.

Nëse kjo detyrë mbetet në dorë vetëm të një njeriu , ai duhet patjetër të angazhohet për realizimin e detyrës në fjalë. Në rastin e dytë kjo është detyrë që u përket të gjithë fukahave. Edhe kur nuk është në gjendje që ta kryejë këtë detyrë , autoriteti që e gëzon si fukaha nuk i humbet , sepse ai është i ndarë prej anës së Zotit. Nëse munden , duhet të mbledhin tatimet , siç janë zekati , humsi dhe Haraçi , ta shpenzojnë për mirëqenien e muslimanëve dhe të shqiptojnë dënimet sipas ligjit. Fakti se net ash nuk mund të krijojmë formën e një pushteti komplet , nuk do të thotë se mund të rrijmë duarkryq. Përkundrazi , shumë më tepër duhet të mundohemi në realizimin e këtij qëllim , duhet të ndërmarim aso detyrash që i kërkojnë muslimanët dhe që janë në ingerencat e pushtetit. Të dëshmon se pushteti dhe autoriteti i takojnë Imamit nuk nënkupton heshtazi se Imami nuk ka status të udhëheqësit shpirtëror , Imami , në të vërtetë , ka disa dimensione shpirtërore që nuk janë të lidhura ngusht me funksionin e sundimtarit. Statusi i udhëheqësit shpirtëror Imamit është mëkëmbësia universale e Huyjnore e tij , të cilën gjë e kanë theksuar Imamët. Kjo mëkëmbësi vlen për të gjithë kreaturën , mbi baza të së cilës edhe atomet e univerzumit i nënshtrohen të autoritetshmit. Njëra prej çështjeve qenësore të shkollës sonë Shiite është se askush , as kerubini e as pejgamberët , nuk mund të arrijnë statusin shpirtëror të Imamit. 63)

Në të vërtetë , sipas traditave që kanë arritur deri ten e , Pejgamberi më i Nderuar si dhe Imamët kanë ekzistuar qysh para krijimit të botës. Ata kanë qenë superior ndaj të gjithë njerëzve tjerë në çdo aspect.64) Pozita e tyre kufizohet vetëm me dëshirën e All-llahut , siç mësojmë nga fjalët e Xhebrailit me rastin e miraxhit: “Sikur të isha afruar edhe sa gishti , me siguri do të digjesha”.65) Kurse vetë Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ne kemi aso pozitash te All-llahu që i tejkalojmë ato të karubinëve dhe të të dërguarve”.66) Një pjesë e besimit tonë konsiston në faktin se Imamët gëzojnë status të njejtë , para se të paraqitet , çështja e pushtetit.

Për shembull, Fatimeja e gëzontë këtë status edhe pse nuk ishte në pushtet , as gjykatëse e as mëkëmbëse 67). Këto staturë dallojnë tërësisht nga ato të sundimtarëve. Sepse , kur themi se Fatimeja nuk ka qenë gjykatëse ,as sundimtare , kjo nuk do të thotë se ajo qenë si ju ose si unë , dhe se nuk ka pasur superioritet shpirtëror mbi ne. Po ashtu , kur dikush në përputhje me mësimet kur’anore thotë: “Pejgamberi ka më tepër të drejta mbi besimtarët sesa ata për vetë” (33:6) , ai i ka përshkruar diçka më të lartë sesa që është e drejta e tij të qeverisë me besimtarët. Por , këtu nuk do t’i shqyrtojmë këto gjëra , sepse ato i përkasin një fush tjetër.

Marjja e pushtetit vetëvetiu nuk sjell ndonjë status të veçantë , porse është mjet për përmbushjen e detyrave në jetësimin e Ligjit dhe në vënien e rendit të drejtë shoqëror islamik. Komandanti i Besimtarëve (paqja qoftë mbi të) i ka thënë ibën Abbasit , në lidje me natyrën e psuhtetit dhe të komandimit: “Sa vlen kjo këpucë?” Ibën Abbasi i është përgjigjur: “Asnjë metelik”. Në çka Komandanti i Besimtarëve ia kthen: “Të urdhëruarit juve është edhe më i pavlefshëm në sytë e mi , me këtë përjashtim: me anë të sundimit dhe të komanduarit vihet drejtësia” – d.m.th. Ligjet dhe institucionet islame – “dhe rrënohet krejt çka është e padrejtë” 68) , pra , të gjitha ligjet dhe institucionet shypëse që s’tolerohen.

Sundimi dhe komandimi , pra , vetvetiu janë vetëm mjete , dhe kur këto mjete nuk përdoren për qëllime të mira , për arritjen e qëllimeve fisnike , atëherë nuk kanë kurrfarë vlere në sy të njerëzve të Zotit. Komandanti i besimtarëve , kështu e përshkruan këtë gjë “në Nexhhul Belaga”: Po të mos ishte obligimi që më është ngarkuar dhe që më detyron të marr këtë detyrë shtetërore , unë do ta lëshoja. 69) Shihet qartë se të marrish pushtetin do të thotë të sigurosh mjetin e jo statusin shpirtëror , sepse pot ë kishte qenë pushteti gjendje shpirtërore , askush s’do të mund ta uzurponte e as ta lëshonte , Sundimi dhe komandimi janë të vlefshëm kur bëhen mjete për krijimin e Ligjit islam dhe për vënien e rendit shoqëror të drejtë islam; atëherë edhe personi që sundon mund të arrijë ndonjë vlerë dhe virtyt më tepër.

Disa njerëz , që janë verbuar nga gjërat e kësaj bote , paramendojnë se liderizmi dhe pushteti vetvetiu paraqesin lartësim dhe status të veçantë për Imamin , dhe pot ë mos jenë ata në pushtet , prishet bota. Sot sundimtarët sovjetikë , ministri i parë britanik dhe kryetari amerikan e mbajnë pushtetin por të gjithë janë pabesimtarë. Ata janë pabesimtarë , por kanë pushtetin politik dhe kanë ndikim të fortë gjë që u mundësojnë të zbatojnë ligje johumane dhe të marrin masa politike për interesat e veta.

Detyrët e Imamit dhe fukahave të drejtë është që institucionet e pushtetit t’i shfrytëzojnë në jetësimin e Ligjit Hyjnor , në vënien e rendit të drejtë islamik që do t’i shërbejë tërë njerëzisë. Pushteti për ata nuk paraqet kurgjë tjetër përvos vuajtje dhe mjerim , por ç’ të bëjnë? U është dhënë detyrë , mission që duhet patjetër ta realizojnë; pushteti i fukahave nuk është kurgjë tjetër përveçse përmbushja e detyrës.

Kur sqaroi se pse pranoi detyrën e pushtetmbajtësit , Komandanti i Besimtarëve (paqja qoftë mbi të) deklaroi se atë e bëri për qëllim të larta d.m.th. për vënien e drejtësisë dhe flakjen e padrejtësisë.

Në të vërtetë ka thënë: “O Zot! Ti e di se qëllimi ynë nuk është që të zëmë ndonjë pzitë , po që t’i çlirojmë të shtypurit nga dora e padrejtësisë. Ajo që më shtyri të pranojë këtë detyrë udhëheqëse është kjo: All-llahu i Gjithëfuqishëm mori garancë nga dijetarët e fesë dhe ua besoi atyre obligimin që mos heshtin para lakmisë dhe egoizmit të njeriut shtypës e mizor , nga njëra anë , dhe para zgjerimit të urisë së të shtypurve , në anën tjetër”. E pat thënë edhe këtë: “O Zot! Të mirë e di se lufta që kemi ndërrmarë ne nuk u bë për të arritur pushtet politik e as për të siguruar të mira materiale”. Pastaj bën arsyetimin e qëllimeve se për çka aid he shokët e tij luftuan dhe dhanë mundin e tyre: “Qëllimi ynë ishte që t’i përtrimë parimet e ndritshme të fesë Sate dhe t’i përmirësojmë punët administrative në tokën Tënde , ashtu që shërbëtorët në zgjedhën e egër të jenë të sigurtë dhe ligjet që janë hequr të jetësohen sërish”. 70))

Sundimtari i cili dëshiron , me anë të organeve të pushtetit që i ka në dispozicion të arrijë qëllimet e larta islame , ato qëllime që i ka theksuar Komandanti i Besimtarëve , patjetër duhet të ketë veçoritë qenësore për të cilat kemi folu: patjetër ta njohë Ligjin dhe të jetë i drejtë.

Pasi ka paraqitur qëllimet e pushtetit , menjëherë ka përmendur edhe këto cilësi qenësore të sundimtarit: “O Zot! Kam qenë njeriu i parë që pranova fenë Tënde posa dëgjova të Dërguarin Tënd (paqja qoftë mbi të) duke e shpallur. Askush nuk më udhëhoqi në lutje përveç vetë Pejgamberit. Kurse ju , o njerëz,! Ju mirë e dini se nuk ka hije që dikush që është i pangopur dhe koprrac të merr pushtetin dhe të luaj me autoritetin , me jetërat dhe të ardhurat e muslimanëve , në kundërshti të plotë me dispozitat e parapara për të udhëhequr”.

“Mandej , ai nuk guxon të jetë xhahil dhe i painformuar me ligjin ashtu që me mosdijen e tij t’i çorientojnë njerëzit. Au nuk guxon të jetë jo i drejtë dhe i ashpër , duke ua këputur të gjitha lidhjet afariste për shkak të sjelljeve të tij mizore.Nuk guxon t’i frikësojë njerëzit , pastaj me disa të miqësohet , kurse me disa të armiqësohet. Ai patjetër duhet të mbledh veten nga marrja ryshfet kur rri në gjykatore , që të mos shkilen të drejtat e njeriut , ashtu që ai që kërkon të drejtën mos fitojë atë që s’i takon. Ai nuk guxon të braktisë praksën e Pejgamberit dhe të pezullojë Ligjin , sepse shoqëria mund të marrë drejtim të gabueshëm dhe të vihet në rrezik.” 71)

Vini re se si ky fjalim sillet rreth dy gjërave , diturisë dhe drejtësisë , dhe se si Komandanti i Besimtarëve i konsideron cilësi të domosdoshme të sundimtarit. Në formulimin “Ai nuk guxon të jetë xhahil dhe i painformuar me Ligjin ashtu që me mosdijen e tij t’i çorientojnë njerëzit” theksi bie te dija , kurse në pjesën tjetër të fjalisë theksi bie mbi drejtësinë , në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Kuptimi i mirëfilltë i drejtësisë nënkupton se sundimtari patjetër duhet të sillet si Komandanti i Besimtarëve ndaj njerëze tjerë , sin ë sjelljë po ashtu edhe në transaksionet ndaj popullit , si në shqiptimin e dënimit po ashtu edhe në shpenzimin e buxhetit të shtetit. Me fjalë tjera , sundimtari dmosdo të pranojë programin e qeverisjes së shtetit të cilin program Komandanti i Besimtarëve ia përshkroi Malik Ashtarit 72) , në të vërtetë , të gjithë sundimtarëve dhe mëkëmbësve , sepse ai letërqarkore ua pat dërguar të gjithëve që ishin në pushtet.

Në qoftë se fukahatë bëhen sundimtarë , ata patjetër duhet ta respektojnë këto përmbledhje udhëzimesh.

Ja një hadith të padyshimtë (sahi). Komandanti i Besimtarëve (paqja qoftë mbi të) transmeton se Pejgamberi më i Nderuar (paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të) ka thënëv : “O Zot! Mëshiroji ata që do të më trashëgojnë”. E ka përsëritur dy herë , pastaj dikush e ka pyetur : “O i Dërguar i All-llahut! Kush janë ata që do të trashëgonjë?” U përgjigj : “Janë ata që do të vinë pas meje , që do të përcjellin traditën dhe praksën time dhe njerëzit do t’i mësojnë me to pas meje”.

Shejh Saduk 73) (All-llahu e mëshiroftë) transmeton nga vargu i pesë transmetuesve (gjegjësisht katër , sepse dy prej tyre janë identikë) në librat vijues : Xhamiul – Ahbar , Ujun Ahbarar – Rida dhe El – Mexhalis. 74)

Në mes tjerash kjo traditë njihet si musned 75) dhe në një vend hasim fjalët “dhe i mësojmë ata” kurse nëpër vendet e tjera e hasim “dhe i mësojmë me to njerëzit”. GGGjithkund ku tradita është shënuar si mursel 76) hasim vetëm fillimin e thënies me formën e dëgjuar të fjalës “dhe i mësojnë njerëzit pas meje”.

Duke marrë parasysh këtë traditë , mund të marrim njërin prek këtyre dy supozimeve: i pari , se është i vetmi shembull i traditës , dhe se fjalia është lënë mënjanë , por nuk mund të thuhet se ishte një gabim rasti , kur dihet se traditën e përcollën disa zinxhirë transmetuesish , kurse tregimtarët relativisht kanë jetuar në largësi të mëdha prej njëri-tjetrit , njëri në Belh , tjetri në Nishapur dhe në vende të tjera. Nuk ka kurrfarë mundësi që kjo fjali të jetë shtuar kastile. Krejtësisht është e pabesueshme të ndodhë që secili prej atyre njerëzve që kanë jetuar ndaras prej njëri-tjetrit , të shtojë një fjali të tillë. Sipas kësaj , nëse kjo është e vetmja traditë , konfirmojmë me siguri se fjala që fillon me “dhe i mësojnë ata” është lënë mënjanë në njërin nga verzionet që i ka shënuar Shejh Saduku (ose i ka shpëtuar përshkruesit të veprave të tij) , ose vetë Shejh Saduku e ka lënë pa përmendur për ndonjë arsye tjetër.

Supozimi i dytë se ekzistojnë dy tradita të veçanta , njëra pa fjalinë “dhe i mesojnë ata” , kurse tjetra me të. Nëse kjo fjali është pjesë e traditës , nuk iu referohet atyre që e kanë për detyrë të predikojnë dhe që nuk janë kompetentë të japin gjykimet e tyre. Ekzistojnë disa studiues të traditës (muhaddithinë) që aspak nuk njohin hadithin , që në mënyrë implicite është përmbledhur në fjalët: “Shumë sutiues të Ligjit nuk arrinë të bëhen fukaha”. Ata janë vetëm mjete për të mbajtur mend , për të tubuar dhe për të shënuar atë që është thënë dhe të njëjtën t’ua përcjellin njerëzve. Për dijetarët e këtillë nuk mund të thuhet se janë trashëgimtarë të Pejgamberit , të cilët i studiojnë dituritë islame 77). Natyrisht , përpjekjet e tyre për të ruajtur interesat e islamit janë evidente , dhe shumë studiues të traditës kanë qenë fukaha të vërtetë , kompetentë për të dhënë gjykime të pavarura : p.sh. Kolajniu 78) , Shejh Saduki 79) dhe i ati i tij (All-llahu i mëshiroftë). Që të tre qenë fukaha dhe ua mësuuan njerëzve parimet dhe shkencat islame. Kurt hemi se Shejh Saduki dallohej nga Shejh Mufidi 80) , nuk duhet kuptuar se ka qenë i panjohur me njohuritë e fikhut 81) , ose se ka qenë më pak i dishëm se Shejh Mufidi. Madje , Shejh Saduki ka qenë njeri që të gjitha parimet dhe shkollat fetare. Dallohej nga Shejh mufidi dhe të tjerët , që mund të krahasohen me të , me atë se ata kanë qenë muxhtehide dhe kanë dhënë fetva për çështje të ndijshme , ndërsa Shejh saduki ka qenë fakih i cili nuk u ikte konkluzave të veta , ose ato i sillte rrallë. Fjalia për të cilën bëjmë fjalë u përket atyre që i komentojnë shkencat islame , i sqarojnë parimet islame , dhe atyre që Islamit ua mësojnë të tjerëve , duke i përgatitur ata që t’i mësojnë të tjerët. Pejgamberi më i Nderuar dhe Imamët (paqja qoftë mbi ata) në të njëjtën mënyrë i kanë proklamuar dispozitat islame : kanë pasur qerthujt (kruzhonet) e tyre që i kanë vizituar me mija njerëz , detyrë e të cilëve ka qenë që t’i mësojnë të tjerët.

Kuptimi i këtyre tubimeve në mënyrën implicite është ngërthyer në fjalinë “dhe i mësojnë njerëzit...” përhapin Islamit ndër njerëz dhe i njohtojnë me dispozitat islame. Nëse besojmë se Islami është për të gjithë njerëzit e botës , atëherë çdo njeri i

vetëdëshëm e ka të qartë se muslimanët , sidomos dijetarët , kanë për detyrë të përhapin dituritë e Islamit , parimet e tij dhe me to të njihen njerëzit në botë.

Nëse supozojmë se fjalia “dhe i mësojnë njerëzuit” nuk i përket fundit të hadithit , atëherë duhet të shohim se ç’deshti të thotë Pejgamberi (paqja dhe mëshira qofshin mbi të) me fjalët : “O Zot! Mëshiroji ata që do të më trashëgojnë; ata që do të vijnë pas meje; ata që do të përcjellin traditën dhe praksën time”. Edhe në këtë formë , kjo traditë nuk mund t’iu referohet atyre që vetëm transmetojnë traditën dhe nuk janë fukaha. Sepse , normat Hyjnore që paraqesin një tërësi normash të njohura islame të njohura si sunnet i Pejgamberit dhe është fat i mirë se ato janë shpallur. Për këtë , ai që do të përhapë praksën e Pejgamberit , patjetër duhet t’i njohë të gjitha dispozitat e All-llahut: patjetër duhet të jetë i zoti të dallojë atë që është autentike nga ato të rrejshmet , ato që janë absolute nga ato që kanë përdorim të kufizuar , të veçantat nga të përgjithshmet. Me tutje , duhet të jetë në gjendje të dallojë kategoritë racionale , të dallojë traditën nga ato që janë kushtet të tekisë dhe të ngjashme , dhe plotësisht të jetë i noftuar me kriteriumet e domosdoshme që i paraqitëm hollësisht. Tradicionalistët që nuk kanë arritur shkallën e ixhtihadit 83) dhe vetëm i transmetojnë hadithet nuk dinë kurgjë për këtë. Ata janë të paaftë të dallojnë praksën e vërtetë të Pejgamberit të All-llahut. Vetëm transmetimi në sytë e Pejgamberit nuk ka pasur ndonjë vlerë , dhe dëshira e tij nuk ka qenë që në populli të thurren fjali si “Pejgamberi i All-llahut ka thënë” ose “Transmetohet sipas thënieve të Pejgamberit të all-llahut”. Në vend të këtyre , ai ka dashur që në popull të përhapet vepra e tij e vërtetë si dhe dispozitat e vërteta islame. Hadithi “Kushdo që do të ruaj për popullin tim katërdhjetë hadithe All-llahu do ta ringjallë si fakih” 84) dhe të ngjashëm si ky që lëvdojnë transmetuesin e haditheve nuk u referohen tradicionalistëve , të cilët nuk kanë haber me natyrën e kësaj tradite.

Ato u dedikohen atyre që mund të dallojnë traditën e vërtetë të Pejgamberit më të Nderura dhe që janë në përputhje me normat e vërteta të Islamit. Persona të këtyllë janë vetëm muxhtehidët dhe fukahatë. Vetëm ata janë të aftë të vlerësojnë të gjitha aspektet e ndonjë dispozite, dhe të konkludojnë për dispozitat e vërteta islame në bazë të kriterieve që i trashëguan prej imamit (paqja qoftë mbi te). Ata janë trashëgimtarët e Pejgamberit më të Nderuar paqja dhe mëshira qoftë mbi të). Për ta është lutur Pejgamberi kur thoshte: „O Zot! Mëshiroji trashëgimtarët e mi”.

Pra, nuk ka dyshim, se hadithi „O Zot! mëshiroji trashëgimtarët e mi” nuk u referohet transmetuesve që kanë qenë vetëm shkruar. Shkruar nuk mund të janë trashëgimtarë të Pejgamberit. Trashëgimtarët janë fukahatë. Përhapja e dispozitave islame dhe udhëzimi besimtarët është obligim i fukahave që janë të drejtë. Nëse nuk janë të drejtë, do të ndodhë si me ata që trilluan tradita të dëmshme për Islamin, siç qe Samura ibën Xhandabi85) i cili trilloi çkamos kundër Komandantit të Besimtarëve. Po që se nuk janë fukaha nuk mund të kuptojnë natyrën e fikhut dhe të normave islame, dhe mund të përhapin mijëra thënie për të lavdëruar mbretërit që i kanë trilluar agjentët mizorë dhe pseudoshkencëtarët servilë të pallateve mbretërore. Lehtë mund të vërehet se çfarë rezultatesh arritën ata me dy thëniet që i vunë krahas Kur’anit, me porosi të theksuar që të organizohen kryengritje kundër mbretërve si në kohën e hazreti Musait

kundër faranëve 86). Përveç Kur'anit të Nderuar , ekzistojnë edhe një varg hadithesh që nxisin njerëzit të luftojnë kundër tiranëve dhe kundër atyre që çorodisin fenë 87). Përtacët i lënë këto mënjane , duke u mbështetur në ato dy hadithet e dobëta , të cilat i shpifën predikuesit e oborrit , të cilët proklamonin se duhet të pajtohemi me sundimin mbretëror dhe të betohemi për besnikëri ndaj oborrit mbretëror. Po të kishim njohuri të mjaftueshme fetare , do të vepronim sipas haditheve të shumta që sigmatizojnë shtypësit.

Po që se kanë arritur të njihen me raditën e pastër islame, atëherë mund të konstatohet se u mungon drejtësija. Sepse, nëse nuk janë të drjtë dhe nuk arrijnë t'iu shmangen mëkateve, atëherë nuk i kanë marrë parasysh mësimet kur'anore dhe hadithet që i denoncojnë shtypësit. Orekset e tyre grabitqare i shtyjnë t'u përmbahën haditheve të dobëta e jo diturisë. Orekset e tilla si dhe ambicjet e sëmura i bëjnë njerëzit t'u nënshtrohen pallateve mbretërore.

Gjithësesi, detyrë e fukahave të drejtë është që të përhapin dituritë dhe dispozitat islame. Vetëm njerëzit e tillë janë në gjendje të dallojnë dispozitat e vërteta nga të rrejshmet, ata i dallojnë edhe traditat e Imamit që janë rezultatat i të qenit tekij. Sepse, ne e dimë se Imamët tanë dikur u pajtuan me kushtet e imponuara dhe nuk mundën të shprehin dispozitat e parapara; u qenë nënshtuar sundimtarëve tiranë që ua patën imponuar tekine dhe frikën. Natyrisht, frika e tyre ishte për shkak të fesë, e jo për ata personalisht. Në raste të veçanta pot ë mos iu ishin përmbajtur kushteve të tekisë, sundimtarët mizorë tërësisht do të çoroditin fenë e vërtetë.

Nuk ka dyshim se tradita për të culën folëm i përket pushtetit të fakihut, sepse të jesh trashëgimtar do të thotë të trashëgosh funksionin e misionarit. Në këtë aspekt, thënia implicite “ O Zot! mëshiroji trashëgimtarët e mi; nuk qëndron larg thënies tjetër implicite : “ Aliu është trashëgimtari im “ , sepse kuptimi i trashëgimisë në të dy rastet është i njëjtë. Thënia “ata që do të vijnë pas meje dhe do të transmetojnë sunnetin tim” bën përshkrimin e trashëgimtarit; nuk e përkufizon trashëgiminë, sepse nocioni “trashëgimi” në fillimet e Islamit ishte mjaft i njohur dhe nuk kishte pyetur Pejgamberin se për kë mendon të emërojë për trashëgimtar, nuk mori kurrfarë informatash për rëndësinë e trashëgimisë. Ky njeri kërkoi prej Pejgamberit që më për së aferimi të tregojë se për kë mendon ta lërë trashëgimtar, të cilën gjë ai e bëri në përgjigjen e tij. Me rëndësi është se fjalitë “Aliu është trashëgimtari im” dhe “ Imamët janë trashëgimtarët e mi” askush nuk i komentoi në raport me detyrën e dhënies së një gjykimi të drejtë.

Prej këtyre fjalive nxjerrin konkluzat për çështjen e trashëgimisë dhe të pushtetit, për të cilën bëjmë fjalë. Vepruan kështu sepse mednuan se qëndrimi i Pejgamberit të Nderuar është decide ndaj disa individëve të caktuar, meqenëse secili Imam ka qenë trashëgimtar, dijetarët e fesë nuk mund të bëhen trashëgimtar, as sundimtar apo

mëkëmbës. Rezultat i gjithë kësaj do të ishte që Islami të mbetej pa ansjë lider që do të kujdesej për të, që normat islame të injorohen, që kufijt e Shtetit Islam të mbeten në mëshirën dhe pamëshirën e armiqve të fesë, dhe të qarkullojnë gjithfarë verzionesh perverse që s'kanë kurgjë të përbashkët me Islamin.

Muhamed ibën Jahja transmeton, duke iu referuar Ahmed ibën Ahmedit, i cili e kishte dëgjuar prej Ibën Mahbubit, kurse këtë e kishte informuar Ali ibën Abi Hamza se Imam Ebul Hasan Musa, i biri i Xhaferit 88) (paqja qoftë mbi të dytë) ka thënë: “Kur vdes ndonjë besimtar, melektë qajnë bashkë me tokën në të cilën ai i është falur All-llahut, kurse punët e mira të tij i hapin dyert e qiellit. Në kështjellën e Islamit paraqitet një plasaritje të cilën askush nuk mund ta ndreqë, sepse besimtarët që janë fukaha janë kështjella e Islamit, si ledhet përçark që mbrojnë qytetin”.89)

Në të njëjtin kapitull të El-Kafisë eksizton versioni tjetër kun thuhët:

“Kurdoherë që ndonjë besimtar që është fakih...” në vend rë “Kurdoherë që ndonjë besimtar...” Përkundrazi, në filim të versionit që e cituam, shprehja “që është fakih” mungon. Më vonë, në versionin e dytë, ku përmendet arsyeja pse qajnë melektë, hasim shprehjen “besimtarët që janë fukaha”. Kjo qartë tregon se fjala fakih ka qenë e lënë mënjanë në fillim të raditës, veçanërisht për atë se nocioni “kështjella e Islami” plotësisht është në pajtim me fakihun.

Fjalët e Imamit se “ besimtarët që janë fukaha janë kështjella e Islamit” më të vërtetë e përshkruajnë detyrën e fakihut si detyrë për rautjen e besimit, të dispozitave dhe institucioneve ilsame. Është e qartë se fjalët e Imamit nuk janë fjalë ceremoniali kurtoaz që ne herë pas here i ndërrojmë njëri me tjetrin (unë ty të quaj “Mbështetës të sheriatit” dhe ti ma kthen me të njëjtat fjalë). As ato kanë diçka të ngjajshme me atë që përdorim ne gjtë adresimit.

Nëse fakihu rri në një kënd të vendbanimit të tij dhe nuk angazhohet në asnjë punë shoqërore, nuk i ruan ligjet islame, nuk i përhap normat islame, nëse nuk merr pjesë në realizimin e qëllimeve të larta islame, nese nuk interesohet për problemet e muslimanëve, si mund të quhet ai “kështjellë e Islamit” ose mbrojtësi i Islamit?

Nëse një kryetar i thotë një nëpunësi ose komandanti “Shko dhe ruaj këtë dhe këtë vend” , a do të mundte mos e kryejë këtë detyrë dhe të shkonte të flente në shtëpi, e ta lëshonte armikun të vijë e të shkretojë gjithëçka para vetes. Apo do të duhej në çdo mënyrë të luftojë dhe ta ruajë vendin që i është besuar?

Nesë thini se ne ruajmë bile disa nga dispozitat islame, atëherë më lejoni të parashtroj këtë pyetje: A i zbatoni ligjin penal islam dhe sanksionet që parasheh ai? Do të përgjigjeni negativisht.

Kështu u paraqitën plasaritje në bedemet mbrojtëse që e rrethonin Islamin, edhe përkundër faktit se ju jeni sa për sy e faqe mbrojtësit e tij.

Pastaj ju pyes: “A i ruani kufijt e Islamit dhe tërësinë territoriale të atdheut islamik? Për këtë do të përgjigjeni: Jo, detyrë jona është vetëm t'i lutëmi Zotit. Kjo do te thotë se ra një copë e murit.

Tash ju pyes: “A ua merrni të pasurve atë që ata duhet t`ua japin të varferve? Sepse, detyrë juaja është që t`ua merrni të pasurve dhe t`ua ndani të varferve” . Përgjigja juaj, natyrisht, do të jetë: “Jo, nuk është punë për ne! Insaallah, do të vijmë të tjerë dhe do ta kryejnë këtë detyrë.” Pastaj bie edhe pjesa tjetër e murit, dhe situatë jonë bëhet sin ë kohën e Shah Sultan Huseinit, kur ai pritte të bjerëe Isfahani.90)

çështë kjo lloj kështjelle? Në çdo kënd është ndonjë “shtyllë e Islamit”, por krejt atë që mund t`a bëjë i jepet shkas të dëshmohet.

A kjo është domethënia e fjalës “kështjellë?

Kuptimi i deklaratës së Imamit se fukahtë janë kështjellë e Islamit nënkupton se ata janë të obliguar të mbrojnë Islamin dhe duhet të bëjnë çmos që të realizojnë atë detyrë të rëndësishme. Kjo është njëra prej detyrave më të rëndësishme, absolute dhe jo obligim i kushtëzuar. Kjo është çështje që fukahët duhet t`i kushtojnë kujdes të vacant.

Shkollat fetare duhet t`i japin rëndësi kësaj lënde dhe me të gjitha mjetet e mundshme të mbrojnë Islamin, siç vepruan Pejgamberi i Nderuar dhe Imamët (paqja qoftë mbi ta) për mbrojtjen e besimit të tyre, të ligjit dhe institucioneve islame. ne thuajse i kemi lëshuar të gjitha aspektet e detyrës sonë, duke u kufizuar në transmetimin e disa pjesëve të Ligjit islam nga gjenerata në gjeneratë. Shumë dispozita islame praktikisht janë bërë pjesë të shkencave okultiste (të fshehta), kurse vetë Islami u bë i huaj.91)

Vetëm emir ka mundur të mbijetojë.

tërësisht janë harruar të gjitha rregullat e ligjit penal që paraqesin ligjin penal më të mirë që i është dedikuar njerëzimit.

Mbijetoi vetëm emir i tyre. Sa u përket ajeteve kur`anore të cilat i sanksionojnë dënimet. “Kurgjë nuk mbetet prej tyre përveç recitimit”92)

Për shembull, ne e shqiptojmë ajetin: “Laviren dhe lavirin t`i rrahni, secilin prej tyre me nga një qind të rëna” (24:2). por nuk dimë çka të bëjmë kur ballafaqohemi me raste të këtilla. Ne i deklamojmë ajetet vetëm për ta perfeksionuar recitimin tonë dhe secilit tingull t`ia japim vlerën që ka.

Situata aktuale që mbretëron në shoqërinë tonë, gjendja sot e Bashkësisë Islame, supremacia dhe korrupcioni, mbrojtja dhe mbështetja që psuhteti ynë i japin shkeljes së kurorës asgjë prej këtyre ne s`na intereson. Mjafton që ne të dimë se cilat dënime parashihen për lavirin dhe laviren, dhe nuk mundemi të sigurojmë kushte për të marrë masa kundër tyre.

Ju pyes, a është kjo mënyra me të cilën vepronte Pejgamberi më i Nderuar (paqja dhe mëshira qofshin mbi të)?

A thua ai kënaqej vetëm me recitimin e Kur`anit, e pastaj ta ketë lënë anësh, pa u angazhuar në jetësimin e normave ndëshkimore?

A thua praksa e trashëgimtarëve të Pejgamberit ishte çështje e të zënit besë popullin, duke thënë: “Ne s`kemi më kurrfarë pune me ju”. Ose, përkundrazi, ata shqiptonin dënime për lloje të ndryshme kundërvrajtjesh me rrahje, mbulim me gurë, me burgim të vazhdueshëm, arestim?

Studioni kapitujt e Ligjit islam që i përkasin ligjit penal dhe larjes së gjakut. Do të shihni se të gjitha këto çështje janë pjesë e Islamit dhe shkak i ardhjes së Islamit. Islami erdhi për të vënë rend në shoqëri:

udhëheqja dhe qeverisja janë vetëm për rregulimin e problemeve shoqërore.

Obligim yni është që ta ruajmë Islamin. Kjo është njëra prej detyrave më të rëndësishme që na takojnë neve. Madje është më e nevojshme se fjala dhe agjërimi. Për realizimin e kësaj detyre dhuet të derdhedh edhe gjak. Nuk ka më të çmueshëm se gjaku i Imam Huseinit, që u derdh për Islamin, për madhështinë e paçmueshme të Islamit. Duhet mirë ta kuptojmë këtë dhe t`ua përcjelim të tjerëve. Ju mund të jeni ithtarë të vërtetë të Pejgamberit (paqja dhe mëshira qofshin mbi të) si dhe mbrojtës të Islamit vetëm nëse njerëzve uashpjegoni Islamin; mos thoni: “Do të presim deri sat ë vijë Imam ii kohës”. E konsideroni si të anuluar lutjen tonë deri në ardhjen i Imami? Mbrojtja e Islamit madje është e rëndësishme se të falurit. Mos e ndiqni logjikën e zëvendësimit të Humeinit⁹⁴) i cili e kishte adet të thonte: “Duhet t`i intensifikojmë mëkatet, që të vije Imam i Kohës, Nëse nuk mbisundojnë mëkatet, ai nukdo të paraqitet!”⁹⁵). Mos rini këtu, duke diskutuar ndërmejt veti. Studioni të gjitha dispozitat islame, propagandoni të gjitha aspektet e të vërtetës me të shkruar dhe me botimin e librave. Ky veprim nuk mund të mbetet pa rezultat, siç vërtetohet edhe përvoja ime.

Transmeton Aliu, duke u mbështetur në të dhënat e të atit, nga En-Nefvaliu, i cili e kishte marrë transmetimin e Es-Sakuniut, për të cilin ka folur edhe Ebu Abdullahu (paqja qoftë mbi të) se Pajgamberi më i Ndershëm (paqja dhe mëshira qoftë mbi të) ka thënë: “fukahatë janë realizatorë të porosive të Pejgamberit , gjithandej përderisa nuk mirret me gjërat e palejueshme, kënaqësite dhe mirësitë e kësaj botë”.

Pastaj e kanë pyetur Pejgamberin: “O Pejgamber i All-llahut! si mund të kuptojmë se ata a mirren me këtë”? Iu përgjigj: “Të thuhet se a i shërbejnë fuqisë mbizotruese. Po qe se e bëjnë këtë, frikësohuni për fenë e tyre dhe largohuni prej tyre”⁹⁶). Studimi më i thuktë i këtij hadithi do të na shpiente në një shqyrtim shumë të gjerë. Do të bëjmë fjalë për fjalinë “Fukahatë janë realizatorë të porosive të Pejgamberit”, sepse na intereson më tepër për shkak të rëndësisë që ka për temën e pushtetit të Fakihut.

Para së gjithash duhet të shohim cilat janë obligimet, autorizimet dhe funksionet që i kanë pasur Pejgamberët, që të mund të zbulojmë cilat janë detyrat e fukahave, trashëgimtarëve të Pejgamberëve.

Në përputhje me logjikën dhe me esencën e natyrës së fesë, qëlimi i dërgimit të pejgamberëve dhe detyra e tyre nuk ishte vetëm të gjykojnë për ndonjë problem të veçantë dhe të komentojnë dispozitat fetare. Këto dispozita nuk i janë shpallur Pejgamberit (paqja dhe mëshira qoftë mbi të) vetëm e vetëm që aid he imamët t`ua transmetojnë besnikërisht besimtarëve, si dhe muftive e emëruar⁹⁷), por që këtë trashëgim ta marrin edhe fukahatë dhe t`ua përcjelin njerëzve pa asfarë ndryshimi.

Kuptimin e thenies :Fukahatë janë realizatorë të porosive të Pejgamberit” nuk duhet kuptuar si obligim të fukahave vetëm për të dhënë opinione juridike. Sepse, funksioni më

i rëndësishëm i Pejgamberit është vënia e rendit të drjtë, nëpërmejt zbatimit të ligjit dhe dispozitave Hyjnore.

Kjo qartë buron nga ajeti i Kur`anit: “Ne i dërguam të dërguarit tonë dokumente të qarta dhe ne zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t`i Permbahën njerëzit e të së drejtës”. (57:25). Qëllimi i dërgimit të Pejgamberëve ka qenë që të konsolidohet jeta e qenies njerëzore mbi bazat e alturizmit të vërtetë. Kjo mund të arrihet pas vënies së pushtetit dhe zbatimit të ligjit, le ta zbatojë atë vetë Pejgamberi, siç qe rasti me më të Ndershmin Pejgamber (paqja dhe mëshira qofshin mbi të) ose pasardhësit që të vijnë mbas tij.

All-llahu i gjithëfuqishëm për humsin thotë: “Ju (besimtarë) ta dini se një e pesta e asaj që e fituat, nga donjë send, i takon All-llahut, të Dërguarit të tij, të afërmve të tij...” (8:41). Për sa i përket zekatit thotë: “Merr prej pasurisë së tyre lëmoshe...” (9:103).

Eksiztojnë edhe dispozita të tjera Hyjnore për format e tjera të përcaktimit të tatimit. Pra, Pejgamberi më i ndershëm nuk pati për detyrë vetëm t`i shqyrtoje këto dispozita, por edhe zbatimin e tyre: si ua proklamonte, ashtu duhej edhe t`i praktikonte. është dashur të mbledhë humsin, zekatin, haraçin dhe të mirat materiale të grumbulluara t`i shpenzojë për mirëqenien e muslimanëve; që të vërë drejtësi mes njerëzve; të pengojë çfarëdo keqpërdorimi të pasurisë shtetërore.

All-llahu i Gjithëfuqishëm vuri në ballë të bashkësisë njerëzore Pejgamberin më të Ndershëm (paqja dhe mëshira qoftë mbi të) dhe i obligoi njerëzit që t`i nënshtrohen: “O ju që besuat, bindjuni All-llahut, respektoni të Dërguarin dhe përgjegjësit nga ju” (4:59). Qëllimi i këtij ajeti nuk është i panjohur. Nënshtrimi para dispozitave të fesë është dëgjueshmëri ndaj All-llahut: çdo veprim që kryhet në përputhje me dispozitat Hyjnore, qoftë shërbim ritual apo jo, është formë e dëgjueshmëri ndaj All-llahut. Ne e dëgjojmë Pejgamberin sepse ashtu na ka urdhëruar All-llahu. Por, për shembull, po qe se Pejgamberi në cilësi të liderit dhe të udhëqësit të ummetit urdhëron që të gjithë t`i bashkangjiten ushtirës së Usames98), dhe askush mos ketë të drejtë të diskutojë, ajo do të ishte urdhër it ë Dërguarit dhe jo urdhër i All-llahut.

All-llahu e obligoi me detyrën e pushtetmbajtësit dha ai, në përputhje me intersant e muslimanëve, duhet të përgatisë dhe të mobilizojë ushtinë, të caktojë dhe të shkarkojë mëkëmbësit dhe gjykatësit, etj.

NëKëtë rast, parimi “Fukahatë janë realizatorë të porosive të të dërguarit” do të thotë së fakihu i drejtë duhet t`i kryejë patjetër të gjitha obligimet me të cilat janë ngarkuar edhe të dërguarit. Drejtësia është nocion shumë më i gjerë se sa zbatimi i porosive, dhe dikush mund të jetë zbatues i porosive në kryerjen e punëve financiare port ë mos jetë i

drjtë ne kuptimin më të gjerë.99) Megjithatë parimi “Fukahatë janë realizatorë të porosive të Pejgamberit” përfshin ata që nuk lënë pa zbatuar asnjë dispozitë të Sheriatit, dhe nuk janë të përlyer, siç kuptohet nga thënia: “Përderisa nuk merren me punë të palejueshme, me kënaqësitë dhe mirësitë e kësaj botë” d.m.th. deri sa nuk janë zhytur në kënetat e kësaj jete. Nëse fakihu ka për qëllim të grumbullojë pasuri të kësaj bote, ai më nuk është i drejtë dhe nuk mund të jetë zbatues i porosive të Pejgamberit më të Ndershëm (paqja dhe mëshira qoftë mbi të) dhe zbatues i dispozitave të Islamit. Vetëm fukahatë e drejtë mund të kryejnë me nder dispozitat islame dhe vendosmërisht mund të themelojnë institucionet e tyre, t`i zbatojnë dispozitat ndëshkimore të Ligjit islam dhe t`i ruajn kufijt dhe integritetin territorial të atthdeut. Shkurtimisht, realizimi i të gjitha ligjeve që i përkasin pushtetit kalojnë në kompetencant e fukahave: grumbullimi i humsit, zekatit, sadakave, xhizjes, dhe hartaçit si dhe shpenzimi i të hollave të grumbulluara për qëllime shoqërore; zbatimi i dispozitave të Sheriatit dhe aplikimi i masave ndëshkimore (që duhet të kryhen në mbikqyrjen e pushtetarit); mbrojtja e kufijeve dhe sigurimi i rendit publik. Mu ashtu siç ka qenë i angazhuar Pejgamberi (paqja dhe mëshira qoftë mbi të) në kryerjen e parimeve Hyjnore dhe në themelimin e institucioneve islame, edhe fukahatë e drejtë patjetër duhet të jenë liderë dhe sundues që i zbatojnë dispozitat e Zotit dhe themelojnë institucionet islame. Mbasi që pushteti islam është pushtet i Sheriatit, funksionimin e tij duhet ta mbikqyrin ata që e dinë Sheriatin, e që janë fukahatë. Ata mbikqyrin të gjitha punët administrative si dhe planifikimet.

Fukahatë janë zbatues porosive me rastin e aplikimit të masave ndëshkimore. Ata nuk guxojnë të ndodhë heqja e ligjit ilsam, ose mosrealizimi i tërësishëm i tij. Nëse fakihu dëshiron të dënojë kurorëshkelësin, patjetër duhet t`i caktojë njëqind shkopinj dhe të ekzekutohen para masës, aq sa është e paraparë.

Ai nuk ka të drejtë të caktojë as një rënie më tepër, as të shajë të akuzuarin, as t`i mshojë me shpullë ose ta mbyll në burg qoftë edhe një ditë. Po ashtu, kur mblidhen tatimet, ai duhet të sillen në përputhje me kriteriumet dhe ligjet islame; ai nuk guxon të marrë asnjë shahi 100) më tepër sesa parasheh Ligji. Ai nuk guxon të lejojë anarki (çrregullim) në punët e arkës shtetëror, nuk guxon të mungojë asnjë shahi . Nëse, mos dhëntë Zoti, fakihu vepron në kundërshti me kriteret e Islamit, atëherë automatikisht do të ndërrohet nga pozita, sepse me fajin e vet e ka marrë nëpër këmbë cilësinë e thirrësit. Ligji është sunduesi i vërtetë. Me ligj iu është garantuar siguria të gjithëve, dhe Ligji (Sheriatit) është strehim i tyre. Muslimanët dhe njerëzit në përgjithësi janë të lirë në suaza të kufijeve të parapara me Zakon. Po qe se sillen në përputhje me dispozitat ligjore, askush nuk ka të drejtë t`iu thotë: “Rini këtu” ose “Shkoni atje” . Pushteti islam nuk iu perngjanë shteteve në të cilët njerëzit janë të privuar nga çdo siguri, për atë secili rri në shtëpi, duke u dridhur nga frika se mos do të jenë të sulmuar edhe nga agjentët e shtetit. Ashtu ka qenë nën pushtetin e Muaviut 101) dhe të sunduesve të ngjashëm. Njerëzit nuk kanë pasur kurrfarë sigurie, janë vrarë, janë syrgjynosur ose burgosur në bazë të një aktakuze ose të vetëm një dyshimi. Sepse pushteti nuk ishte islamik.

Kur u themelua pushteti islam, secili jeton plotësisht i sigurt nën mbrojtjen e Ligjit, dhe asnjë sundues nuk ka të drejtë të ndërmerr asnjë hap në kundërshtim me dispozitat dhe

ligjet e Sheriatit të patëmetë. Kuptimi i thënies “realizator të testamentit” përfshin fukahatë si njerëz në të cilët mund të besohet se do t'i zbatojnë të gjitha obligimet që i parasheh Islami, e jot ë bjerë vendime si t'i fteket. Vallë a nuk ishte ky funksioni i Imamit? A thua ai vetëm e komentoi Ligjin? A thua se ky nuk qe edhe funksioni i të dërguarëve, të cilin funksion e trashiguan edhe realizatorët e testamentit? Natyrisht, të japish mendimin tënd për një çështje dhe të komentosh ligjin është njëra prej dimensioneve të fukahasë.

Por Islami e vështron ligjin si mjet e jo si qëllim më vete. Ligji është mjet dhe instrument për zbatimin e drejtësisë, mjet për përkryerjen intelektuale e morale të njeriut. Ligji bihet për sendërtimin e shtetit juridik, që të ushqejë moralisht dhe shpirtërisht qeniet e fisnikëruara njerëzore.

Detyra më e rëndësishme e të dërguarëve ka ëenq sendërtimi i dispozitave Hynore, për çka u detyruan të jenë edhe mbikëqyrës të pushtetit. Ka ngelur një traditë prej Imam Ridasë (paqja qoftë mbi të), i cili për afërsisht shprehet kështu: “Bashkësisë i duhet një imam i ndershëm, i denjë për të ruajtur njerëzit nga shkatërimi” , pastaj edhe një herë konfirmon se fukahatë janë realizatorë të testamentit të Pejgamberit. Duke i bashkuar këto dy thënie konstatojmë se fukahatë patjetër duhet të jenë udhëheqës të popullit që të ruajnë Islamin nga shkaktërimi, kurse dispozitat e tij nga abrogimi.

Megjithatë, mu për atë pse fukahatë e drejtë nuk kanë pasur pushtetin ekzekutiv në vendet e banuara me muslimanë si dhe pse nuk është zbatuar pushteti i tyre, Islami u shua dhe dispozitat e tij u suprimuan. Shkoi në vend fjala e Imam Ridasë, përvoja e tregoi vërtetësinë e fjalës së tij.

Vallë, a nuk është braktisur Islami? A nuk janë flakur ligjet islame nëpër vendet islamike? Thua se zbatohen dispozitat ndëshkimore sipas Islamit, thua se zbatohen parimet islame, a nuk janë zhdukur institucionet islamike, a nuk mbretëron një kaos, anarki, konfuzion? A nuk do të thotë kjo se Islami po humbet? A mos është Islami diqka që duhet të mbetet vetëm i shkruar nëpër libra, si El-Kafi, e pastaj të hiqet anash? A mund të themi se Islami ruhet po qe se nuk aplikohen dispozitat islame dhe po qe se nuk aplikohen sanksionet ligjore dhe të mbesin pa u dënuar vjedhësit, plaçkitësit, shtypësit, planprishësit – përderisa ne kënaqemi me ruajtjen e librave të Sheriatit, me puthjen dhe lënien anash (duke e lënë anash madje edhe vetë Kur`anin) dhe leximin e Ja-sinit natën e xhuma. 103)

Mbasi që shumë prej nesh nuk kanë besuar se në shoqërinë tonë duhet të udhëheqë pushteti islam, kjo shkaktoi që në shumë vende islamike, jo vetëm të mos ekzistojë rendi shoqëror islamik, por atje mbretëron korrupcioni dhe zbatohen ligjet mizore në vend të atyre islame, madje rregullat islame iu duken si arkaike edhe ulemave.

Kur zhvillohen biseda për këtë çështje ata pohojnë se hadithi “Fukahatë janë realizatorë të porosisë së Pejgamberit” i referohet vetëm dhënies së këshillave juridike. Duke i injoruar ajetet kur`anore, ata në të njëjtën mënyrë zvetnojnë shumë tradita që na udhëzojnë në atë se dijetarët islame janë ata që duhet të mbajnë pushtetin gjatë kohës së Fshehtësisë. A mund të kufizohet realizimi i porosisë në këtë mënyrë? A nuk e ka për detyrë realizatori i porosisë të pengojë suprimimin e dispozitave islame dhe mos marrë masa ndaj kundërvajtësve? A s`ka të drjtë të pengojë shkapërderdhjen e të hyrave dhe të dalave, si dhe malverizimet e ndryshme gjatë qeverisjes me to?

S`ka dyshim se për të gjitha këto detyra duhet të ekzistojë realizator i porosive, dhe se detyra e fukahave është që të marrin tutorinë siç janë porositur, dhe ta zbatojnë në mënyrë të denjë.

Komandanti i Besimtarëve (paqja qoftë mbi të) Shurajhun 104) e quajti hor 105), sepse ai nuk ka qenë as i dërguar, as trashigimtar i të dërguarit, por që kishte zënë pozitën e gjykatësit. Shurajhu ishte njeri që kishte zënë pozitën e gjykatësit në Kufe 50 ose 60 vjet. Ishte i lidhur ngusht për parinë e Muaviut dhe jepte fetva 106) të cilat shkaktuan rebelim kundër shtetit islam. Komandanti i Besimtarëve nuk mundi, gjatë sundimit të tij, që ta ndërrojë Shurajhun, sepse e mbronin disa figura të dështuara me arsyetimin se atë e kishin caktuar Ebu Bekri dhe Ymeri dhe se procedimi nuk mund të thehej. Ja kështu i ishte imponuar Shurajhu Komandantit të Besimtarëve por parapëseprapë arriti që ta detyrojë që në aktvendimet të jetë conform me Ligjin. Nga tradita e mëhershme, qartë shihet se punën e gjykatësit mund ta kryejë vetëm i dërguari ose trashigimtari i tij. Askush nuk e konteston faktin se funksioni i gjykatësit u takon fukahave të drejtë, në përputhje me emërimin e tyre nga imami.

Ky qëndrim unanim nuk ka të bëjë me çështjen e pushtetit të fakihut. Disa dijetaë siç është Naraki 107) ose mes personaliteteve të reja – Naini), konsiderojnë se të gjitha funksionet e jashtme dhe detyrat e Imamit kalojnë në duart e fakihut, ndersa të tjerët nuk mendojnë ashtu. Por nuk ka dyshim se funksioni i gjykatësit i takon fakihut të drejtë. Kjo, në të vërtetë, vetvetiu është e qartë.

Duke e shqyrtuar faktin se fukahatë nuk janë në rangun e misionarit dhe se ata nuk janë “mëktetarë të mjerë”, konstatojmë, në dritën e traditës së posacitur, se ata patjetër duhet të jenë trashigimtarë ose pauses të Pejgamberit më të Ndershëm (paqja dhe mëshira qofshin mbi të). Megjithatë, paso që në përgjithësi është i pranueshëm nocioni “trashigimtar i Pejgamberit” i cili u referohet trashigimtarëve të drejtpërdrejtë, kjo dhe tradita të ngjashme rralë janë cituar si dëshmi për trashigiminë e fukahave. Trashigimtari i drejtpërdrejtë i Pejgamberit më të Ndershëm ka qenë Komandanti i Besimtarëve (paqja qoftë mbi ta), pas të cilit kanë ardhur imamë të tjerë (paqja qoftë mbi ta) dhe punët më të rëndësishme u janë besuar atyre. Por askush të mos mendojë se funksioni i pushtetit ose gjykimi kanë qenë privilegj për Imamin. Sundimi iy besua atyre, sepse ata ishin më të aftit për të vënë pushtet juridik, të zbatojnë ligjet shoqërore mes njerëzve. Statusi shpirtëror i Imamit, që e tejkalon të menduarit e njeriut, nuk kanë kurrfarë lidhesh me emërimin. Po të mos e kishte emëruar Pejgamberi Komandantin e Besimtarëve për trashëgimtarë të tijin, ky edhe më tutje do të kishte cilësitë e larta shpirtërore. Kryerja e një funksioni dhe funksioni vetë nuk i japin rang shpirtëror e as

privilegj nfonjë njeriu, por, përkundrazi, rangu shpirtëror dhe privilegjet e kualifikojnë dikë si njeri të pushtetshëm dhe që ka marrë një përgjegjësi të madhe shoqërore.

Sido që të jetë, nga kjo që u tha, konstatojmë se fukahatë janë trashëgimtar të Pejgamberit, në një shkallë të caktuar, dhe se detyrat që ai ua besoi imamëve (paqja qoftë mbi ta) vlejné edhe për fukahtë.

Ata patjetër duhet t'i kryejné obligimet që i ka kryer Peygamberi (paqja qoftë mbi rë), ashtu siç i zbatoi edhe Komandanti i Besimtarëve (paqja qoftë mbi të).

Ekziston edhe një traditë tjetër e cila mund të na shërbejë si dëshmi për vërtetimin e tezave tona, e cila traditë është me vlerë si për nga zinxhiri i transmetuesve, po ashtu edhe për nga kuptimi që ka. Një zinxhir i transmetuesve, ku bën pjesë edhe Kolajniu, është i dobët, por tjetri që përmend Saduki, të transmetuar prej Sulejman ibën Halidit, është autetntik dhe i besueshëm. Ja teksti i atij transmetimi: Imam Xhafer es-Sadik (109) ka thënë: “Jini të përmbajtur nga gjykimi, sepse gjykimi është i rezervuar për imamin i cili është i njoftuar me Ligjin dhe procedurën gjyqësore dhe ai sillet drejtë ndaj të gjitha muslimanëve; ai (gykimi – shën i përkth.) është i rezervuar për të dërguarin, ose për trashëgimtarin e tij”. Kini kujdes nëse dikush dëshiron të jetë në krye të gjyqit, para së gjithashtu duhet të jetë imam. Se çka koptohet me fjalën imam le t'i mbetet leksikologjisë. Në këtë kontekst edhe vetë i Dërguari llogaritet si imam. Po të mendohej për ndonjë kuptim tjetër të imamin (110), atëherë do të ishte e tepërt t'i atribuohet atij drejtësia dhe dija.

Pastaj, njeriu i cili dëshiron të ketë funksionin e gjykatësit duhet të ketë njohuri të domosdoshme. Nëse dikush është imam por i padishëm në çështje të legjislativës dhe të bëhet gjykatës. Sipas kësaj, pozita e gjykatësit është e rezervuar për ata njerëz që i kanë këto tri kualifikime: të jetë lider, të jetë i dishëm dhe të jetë i drejtë. Më tutje, nga tradita mësojmë se këto tri cilësi mund të gjenden vetëm të i Dërguari ose të realizatorët e testamentit të tij. Kam thënë edhe më herët se funksioni i gjykatësit i takon vetëm fakihut të drejtë; ky është aspekti fundamental i fik`hut që nuk është lëndë shqyrtimi i këtij diskutimi. Pa shihni se a i ka këto tri kualifikime fakihu që të mund të kryejë funksionin e gjykatësit. Është e qartë, në këtu përqëndrohemi në fakihun e drejtë, jo në cilindo qoftë. Fakihu, sipas definicionit, është i udhëzuar për çështjet që kanë të bëjnë me funksionin e gjykatësit, sepse termi fakih përdoret edhe për ata që kanë njohuri nga ligji dhe procedimi gjyqësor sipas Islamit, por që ka njohuri edhe për institucionet e tjera islame (siç është morali) – shkurtimisht, fakihu është ekspert fetar në kuptimin e plotë të fjalës.

Përveç kësaj, nëse fakihu është edhe i drejtë, do të konsiderohet se i ka këto dy kualifikime. Kualifikimi i tretë është se patjetër duhet të jetë imam, në kuptim të prijësit.

Por, tashmë theksuam se fakihu i drejtë mban pozitën e udhëheqësit dhe të liderit, në përputhje me zgjedhjen e tij që i takon Imamit. Pastaj, Imami ka sqaruar se këto tri kualifikime nuk mund të gjenden te askush tjetër përpos te i dërguari ose te trashëgimtari i tij Mbasi që Fukahatë nuk janë të dërguar, patjetër duhet të jenë trashëgimtarë të tyre. Kështu, pra, vijnë në përfundim se fakihu është trashëgimtar i Pejgamberit më të Ndershëm (paqja dhe mëshira qoftë mbi të.) Madje, gjatë kohës së Fshehjes së Imamit, është lider i muslimanëve dhe udhëheqës i mbarë bashkësisë. Vetëm aim und të kryejë funksionin e gjykatësit dhe askush tjetër.

Tradita e tretë i referohet testamentit të tretë të nënshkruar nga Imami, prej të cilit mund të nxirren disa përfundime, të cilat do të mundohem t'i paraqes. Në librin Ikmaludin ve Imamun-ni`metu 111)transmetohet se Is`hak ibën Ja`kubi i ka shkruar letër Imamit të Kohërave 112) (e shpejtoftë All-llahu ardhjen e sërishme të tij) duke kërkuar prej tij disa udhëzime për çështjet aktuale që lindën papritmas. Muhammed ibën Uthman, përfaqësues i Imamit, ia dorëzoi letrën. Erdhi përgjigja, e shkruar nga dora e bekuar e Imamit, ku thotë: “Me rastin e paraqitjes së rrethanave të reja shoqërore, duhet të kërkonim t`ju prijnë ata që e përcjellin traditën tonë, sepse ata janë dëshmia ime për ju, siç jam edhe unë provë e All-llahut.” Ajo çka mund të kuptohet nëpërmjet fjalisë “paraqitje e rrethanave të reja shoqërore” (havadihi vakia) nuk ka të bëjë me dispozita ligjore. Me të shkruarit letër nuk deshti t'p yes se çka duhet bërë për zgjidhjen e çështjeve të papresedan. Sepse përgjigja, sipas shkollës shitte, është më se e qartë: aprovim unanim dhe se për raste të këtilla duhet marrë mendimin e fukahave. Me të vërtet, edhe gjatë jetës së Imamit (paqja qoftë mbi të), njerëzit u drejtoheshin fukahave, dhe parashtronin pyetje të ndryshme.

Njeriu që jetoi në kohën e Fshehtësisë së Vogël dhe kishte lidhje me përfaqësuesin e Imamit, ai i cili i shkroi letër dhe mori përgjigje, është dashur patjetër të dijë se kujt t`i drejtohej për zgjidhjen e çështjeve zakonore. Ajo që nënkuptohet me havadihi vakia ka të bëjë me krijimin e situatave të reja si dhe të problemeve që ndikojnë te njerëzit në përgjithësi. Pyetja të cilën në mënyrë implicite e parashtror Ibën Ja`kubi ishte: Mbasi që tani nuk do të kemi praninë tënde, çka duhet të bëjmë me problemet shoqërore? Cila është detyra jone? Ndoshta edhe ka përmenduar raste specifike dhe për atë ia ka parashtruar pyetjen:

“Kujt t`i drejtohem të na udhëzojë për këto çështje?” Por, si duket kjo pyetje ka pasur karakter të përgjithshëm. Mu për atë edhe Imami i është përgjegjur në mënyrë të përgjithësuar, me fjalet: “Në lidhje me dukuritë dhe problemet e tilla, duhet t`iu drejtoheni atyre që predikojnë traditën tonë d.m.th. fukahave. Ata janë dëshmi për ju, kurse unë jam provë e All-llahut.”

Cila është domethënia e “provës së All-llahut”? çka nënkuptojni ju me atë term. A mundet një traditë e vetme të shërbejë si argument? Po qe se Zurari 115) ka transmetuar një traditë, a mund të merret si argument?

Imami i kohës a mund të krahasohet për nga autoriteti me Zuarin, të cilin ne e ndjekim me qëllim që të sillemi sipas traditës së Pejgamberit më të Ndershëm (paqja qoftë mbi të) siç e transmetoi Zurari? Kurt ë thuhet se ai që ka autoritet është provë e All-llahut, a

mendohet se ai është “argument” vetëm për disa veçanti të Ligjit, me detyrë që të japë këshilla juridike? Më i Ndershmi Pejgamber ka thënë: “Unë tash po shkoj, ndërsa Komandanti i Besimtarëve do të jetë dëshmi për ju”.

Nga kjo a mund të konstantoni se, pasi shkoi Pejgamberi, u sosën të gjitha detyrat, përveç dhënies së këshillave juridike dhe se kjo të ishte e gjithë ajo çka i ishte lënë Komandantit të Besimtarëve (paqja qoftë mbi të)?

Ose, në të kundërtën, termi, “provë e All-llahut” do të thotë se Pejgamberi më i Ndershëm ka qenë prijës autoritativ i të gjithë njerëzve, i dërguar nga ana e Zotit.

Nga kjo nënkuptohet se edhe fakihët janë prijës autoritativë dhe janë përgjegjës për të gjitha çështjet. “Sprovë e All-llahut” është ai të cilin All-llahu e ka caktuar të merret me punë udhëheqjeje. Të gjitha sjelljet e tij, veprimet dhe fjalët e tij janë argumente për muslimanët. Nëse dikush bën ndonjë kundërvajtje, raporti duhet të jetë me kohë për të paraqitur aktpadinë. Nëse “Argumenti” urdhëron që të merren masa ndëshkimore në një mënyrë të caktuar, ose harxhoni prenë e luftës, të zekatit ose të sadakasë 116), dhe ju disi nuk jeni të dëgjueshëm, All-llahu i Gjithëfuqishëm do të paraqesë “argument” kundër jush Ditën e Gjykimit. Edhe përkundër faktit se eksiston “argumenti” dhe ju i drejtoheni pushtetit për kryerjen e punëve tuaja, atëherë All-llahu i Gjithëfuqishëm do t’i referohet “faktit” si argument kundër jush në Ditën e Gjykimit, me fjalët: “Unë solla argumente për ju; pse atëherë ju kthyet shfrytëzuesve dhe sistemit juridik të mëkatarëve?” Po ashtu All-llahu e caktoi Komandantin e Besimtarëve (paqja qoftë mbi të) si argument kundër atyre që nuk ju nënshtrohen dhe që e morën halifatin, kundër Muaviut dhe halifëve emevitë kundër halifëve abasidë dhe atyre që vepruan në përputhje me dëshirat e tyre, e vërteton ky argument: “Pse në mënyrë të paligjishme e uzurpuat pushtetin? Pse e uzurpuat hilafetin, edhe përkundër mangësive të shmuta? All-llahu i thërret të gjithë sundimtarët gjakpirës dhe pushtet që veprojnë në kundërshtim me kriteret islame, duke i pyetur: Përse keni qenë tiranë? Pse e keni shkatëruar pasurinë e muslimanëve? Pse keni organizuar kremtimin e mijëvjeçarëve 117)? Pse tërë pasurinë e popullit e harxhuat për kurorëzime 118) dhe për manifestime të shëmtuara? Nëse dikush prej tyre përgjigjet: “Për shkak të rrethanave nuk kam mundur të veproj drejt dhe të hjek dorë prej pallateve luksoze; kurorëzohesha që t’ia tërhiqja vëmendjen të tjerëve për vendin tim edhe për shkallën e zhvillimit që kishim arritur”? do t’i kthehet përgjigje e këtillë: “Por Komandanti i Besimtarëve a nuk ishte pushtetar? Sundoi mbi të gjithë muslimanët dhe mbi mbretërinë e gjerë.

A ke qenë më agil se ai për përhapjen e famës së Islamit, të muslimanëve dhe të vendeve islamike? Mbretëria yte a është më e madhe se e tija? Vendi në të cilin ke sunduar ti është vetëm një pjesë e mbretërisë së tij: asaj mbretërie i kanë takuar edhe Iraku, Egjipeti dhe Hixhazi përkrah Iranit. Përveç kësaj, vendi prej nga ai ka predikuar ka qenq xhamia, ndërsa në një tjetër përgatitej ushtria për luftë. Ajo ushtri përbëhej prej njerëzve të cilët faleshin rregulisht, ishin besimtarë të vërtetë: ti e di mirë se si përparonte Islami dhe se çfarë rezultatesh u arritën.” Sot fakihët islamë janë dëshmi e gjallë për njerëzit. i dërguari më i Ndershëm (paqja dhe mëshira qofshin mbi të) siç ishte sprovë para All-llahut-atij i ishte besuar udhëheqja e të gjitha punëve, e kush nuk i nënshtrohej kishte edhe një argument kundër vetes-ashtu edhe fukahtë ishin sprovë e Imamit (paqja qoftë mbi të) ndaj njerëzve. Atyre u janë besuar çështjet e muslimanëve, dhe All-llahu do të nxjerrë argumente kundër gjithësecilit që nuk tregon përgjegjësi ndaj të gjithë asaj, që i përket pushtetit, udhëheqjes së muslimanëve dhe shpenzimit të tondeve shoqërore. Nuk ka kurfarë dryshimi për kuptimishtë e traditës që e cituam, edhe pse mund të ketë njëfarë reserve në aspektin e zinxhirit të transmetuesve. Për çdo rast, nëse dikush konsideron se tradita vetvetiu nuk konfirmon tezën që e parashturam, ajo shërben për të vërtetuar argumentet tjera që i përmendëm. Një traditë tjetër që e vërteton tezën tonë është makbuli 119) Omar ibën Hanzala. Meqenëse kjo traditë thirret në disa ajete të Kur`anit, sëpari duhet të shqytojme ajetin përkatës si dhe ajetet që i paraprinë, që të mund të shpjegojmë domethënienë tij, para se të fillojmë hulumtimin e kësaj traditë. Në emër të All-llahut, Mëshiruesit mëshirëbërësit! All-lahu ju urdhëron që t`u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. All-llahu dëgjon dhe sheh si veproni.

O ju që besuat bindjuni All-llahut, respektoni të dërguarin dhe përgjegjësit nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtoni atë te All-llahu (te Libri i Tij) dhe te i dërguari, po qe se i besoni All-llahut dhe Ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë (4:58,59). Në këto ajete All-llahu na urdhëron që t`i këthejmë amanetet pronarëve të tyre. Disa njerëz besojnë se ajo që nënkuptohet nga fjala “Amanet” ka dy kuptime: amanetin që u referohet njerëzve (do të thotë pronësia e tyre) dhe atë që i referohet krijuesit (do të thotë dispozitat e Sheriatit 120). Gjykatësi nuk mund të sjell aktvendim jo të drejtë, d.m.th të bazuar në ndonjë ligj jolegjitim në ndonjë codex joislam. P.sh., ata që merren me planifikimin e punëve të tokës sjellin programe

fiskale në baza ndërkombëtare, nuk guxojnë të venë tatime enorme për katundarët që e punojnë tokën e tyre dhe t'i sjellin në mjerim, kurse ekonominë e vendit ta shkatërrojnë tërësisht. Ligji dhe dispozitat ligjore nuk duhet të tejkalojnë kufijt e as të keqpërdorën. Komandanti i Besimtarëve (paqja qoftë mbi të) duke ua prerë duart dy hajanve tregoi një dashamirësi ndaj tyre, saqë ata u bënë ithtarë të pasionuar. Me një rast tjetër kishte dëgjuar se ushtria plaçkitëse e Muaviut kishte vjedhur një hallkë për në këmbë një gruajë të një dhimmii 122). Aq u shqetësua saqë në një fjalim edhe e shprehu revoltën e tij duke thënë: “Sikur edhe të vdiste dikush në gjendjen në të cilën gjendem unë, askush nuk do ta qortonte për këtë”. Por, edhe përkundër këtij senzibilitetit, Komandanti i Besimtarëve ishte njeri që e nxirrte shpatën kur ishte nevoja që t'ia hjekë flamën ndonjë të degjeneruari, pasi ishte mjaft i fuqishëm. Kjo është domethënia e vërtetë e drjtësisë. Më i Ndershmi Pejgamber (paqja qoftë mbi të) është shembëlltyra më markante e sundimitarit të drejtë. Kur jepte urdhër që të pushtohej ndonjë krahinë, të shfarrosej ndonjë grup që i kishte sjellur dëm Islamit, muslimanëve dhe njerëzisë në përgjithësi, urdherat e tij kanë qenë të drejtë.

Do të ishte në kundërshti me të drejtën pot ë mos jepte një urdhër të tillë, sepse do të ishte mospërfillje e interesave të Islamit, të muslimanëve dhe të mbarë gjinisë njerëzore. Kushdo që sundon te muslimanët ose në përgjithësi një grupacion shoqëror, patjetër duhet të ketë ndërmend të mirën e përgjithshme dhe interesin e përgjithshme kurse t'i lërë pas dore interesat personale. Mu për këtë Islami është predispozuar që interesat personale t'ua nënrendoj interesave kolektive, dhe të nënshtrojë të gjithë ata që janë të degjeneruar dhe i sjellin dëme shoqërisë njerëzore. Pasiqë hebrenjtë e fisiut Benu Kurejdha ishin grupacioni ngatrestarë, të cilët në shtetin islam futën korrupsionin dhe i bënë dëme të shumta Islamit, më i Ndershmi Pejgamberi (mëshira dhe paqja qoftë mbi të) i hoqi qafe. 123) Të besimtarët ekzistojnë dy cilësi themelore: ai e zbaton drejtësinë kur është e patjetërsueshme, me tërë forcën dhe vendosshmërinë, duke mos treguar as një fije ndjese, por, kur janë të thirrur, tregojnë dashuri dhe kujdes të jashtëzakonshme. Në këto dy menyra besimtari i shërben si strehim shoqërisë. Shoqëria me anëtarët muslimanë dha ata jomuslimanë, do të arrijë siguri dhe paqe atëherë kur në pushtet do të vijnë besimtarët dhe secili do të jetojë në paqe dhe pa frikë. Njerëzit që jetojnë sot në frikë e trishtim nga zotërinjtë e tyre, e gjithë kjo është rezultat i pushtetit që nuk bazohet në Ligj: ata janë prototipa të bandizmit. Por, nëse në krye të shtetit qëndron një njeri siç ishte Komandanti i Besimtarëve (paqja qoftë mbi të), d.m.th. me formimin e shteti ilsam, prej frikës do të tmerroheshin vetëm tradhtarët dhe shtypësit-tiranët, ata që marrin nëpër këmbë të drejtat elementare të bashkëkohanikëve të tyre. Për opionin më të gjerë nuk ekziston frika dhe shqetësimi në ajetin e dytë të lartëpërmendur, All-llahu i Gjithfuqishëm thotë: “ O ju që besuat, bindjuni All-llahut, respektoni të dërguarin dhe përgjegjësit nga ju” . (4:59).

Sipas një hadithi, filimi i këtij ajeti (“t'u jepni emanetin të zotëve të tyre”) referohet Imamëve (paqja qoftë mbi ta), kurse pjesa tjetër e ajetit që bën fjalë për sjelljen korrekte, ju referohet atyre që mbajnë pushtetin.

Ajeti i dytë (“O ju që besuat!..”) i kushtëzon të gjithë muslimanët. All-llahu i urdhëron muslimanët që t`i përulen më të ndershmit Pejgamber (paqja qoftë mëshira qoftë mbi të) si dhe atyre që kanë autoritet (do të thotë Imamëve), duke pranuar mësimet e tyre e duke i zbatuar urdhërat e tyre. Thashë se t`u bindesh urdhërave të All-llahut të gjithë fuqishëm nuk është njëlloj si t`ju bindesh urdhërave të Pejgamberit më të Ndershëm (paqja qoftë mbë ti) Të gjitha dispozitat e ligjit të Zotit, kanë të bëjnë me adhurimin e Zotit apo jo, po t`i zbatohs-tregon përulshmërinë tënde ndaj Zotit. Më i Ndershmi Pejgamber nuk ka dhënë asnjë urdhër që ka të bëjë me lutjet, edhe pse i shtynte njerëzit që t`i fallen All-llahut. Kur falemi, ne gjithëesi i nënshtrohemi All-llahut. Përlja ndaj Pejgamberit është ndryshe nga përlja ndaj All-llahut.

Urdhërat e më të Ndershmit Pejgamber janë urdhëra që ai i shprehu gjatë kryerjes se funksionit shtetëror, ashtu siç i urdhëroi muslimanët që t`i bashkangjiten ushtrisë së Usames 124) që t`i mbrojnë kufijt e shtetit islam, të mbledhin tagrat nga një kategori e caktuar njerëzish, dhe të sillen ndërmjet tyre në mënyre të denijë. Të gjitha këto ishin urdhëra të Pejgamberit. All-llahu na ka urdhëruar t`u bindemi urdhërave të Pejgamberit. Po ashtu e kemi për detyrë t`iu nënshtrohemi edhe atyre që kanë autoritet, e ata janë, sipas bindjes sonë, imamët (paqja qoftë mbi ta).

Shkurtimisht përlja urdhërave të tyre është formë e përljes ndaj All-llahut. Mbase që All-llahu i Gjithfuqishëm na ka urdhëruar që të ndjekim rrugën e Pejgamberit dhe të atyre që kanë autoritet, përlja jonë ndaj tyre është shprehje e përljes ndaj All-llahut. Ajeti, të cilin e cituam, më tutje vazhdon: Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrone atë te All-llahu (te Libri i Tij) dhe te i Dërguari.

Dy opsione dëgjohen ndërmjet njerëzve: i pari, se ekziston një zënkë që lind ndërmjet dy grupeve ose ndërmjet dy individëve për ndonjë çështje më rëndësi. Për shembull, dikush mund të deklarojë se akëcili i ka një borxh, kurse pala tjetër e mohon atë. E vërteta e këtij kontesti duhet të vërtetohet conform me sheriatin ose me të drejtën kanunore 125). Në rastet e këtilla, njeriu duhet t`i drejtohet gjyqit i cili do të shqyrtojë lëndën dhe do të sjellë vendim gjegjës. Pra, lloji i parë i kësaj polemike është e karakterit qytetar. Lloji i dytë i kësaj polemike nuk ka të bëjë me mospajtimin e këtij tipi, por ka të bëjë me krimin dhe tiraninë. Për shembull, nëse nje vjedhës e merr me forcë pasurinë e dikuj ose shfrytëzon në mënyrë të paligjshme pasurinë shoqërore, njeriu kompetent të cilat duhet t`i drejtohem nuk është gjykatësi por prokurori. Në rastet si ky, që ka të bëjë me kodin penal dhe jo me kodin civil (me përjashtim të disa rasteve kur ka të bëjë edhe njëri edhe tjeri) para së gjithash prokurori publik është ai që ruan Ligjin dhe dispozitat e tij, pra është mbrojtës i shoqërisë. Ai më së pari ngre

aktadinë, pastaj gjykatësi bën hetimet dhe në fund sjell aktygjykimin. Zbatimin e aktgjyimit, qoftë e kodit civil apo e kodit penal, e bën pushteti ekzekutiv.

Kur`ani, pra, na sygjeron: Sa herë që të keni konfrontime ndërmjet jush, ai të cilit duhet t`i drejtohem patjetër është All-llahu dhe parimet e Tij, si dhe i Dërguari, zbatuesi i këtyre dispozitave. Në çdo polemikë që ka të bëjë me borxhin ose me huanë do të intervenojë i Dërguari në cilësinë e gjykatësit dhe do të sjellë vendimin. Nëse paraqiten pengesa të tjera që uzurpojnë zbatimin e të drejtës, përsëri duhet t`i drejtohem të Dërguarit. Ai, mbas që është burrështeti, është i detyruar të përlligjë drejtësinë. Ai patjetër duhet të dërgojë një nëpunës, detyrë e të cilit është t`ia kthejë të dëmtuarit të drjetën uzurpuar. Pastaj, çkado që i përket të Dërguarit në mëria e imamëve është dëgjeshmueri ndaj më të Ndershmit Pejgamber. Shkurtimisht, të dy ajetet, me të gjitha komponentet, përfshijnë pushtetin në përgjithësi si dhe jurisprudencën.

Madje disa ajete të Kur`anit në mënyrë eksplicite përkrijnë me pushtetin ekzekutiv. Në ajetin vijues All-llahu thotë: “A i vure re ata që mendojnë se besuan atë që zbriti ty, dhe atë që zbriti para teje, se si dëshirojnë që mes tyre të gjykojë djalli (taguti), e duke qenë se janë urdhëruar që të mos e besojnë atë. E dajlli dëshiron t`i humbë bë pafundësi. (4:60). Madje sikur edhe tagutin mos e konsiderojmë si pushtet tiranik dhe si formë të paligjësishë totale që rebelohet ndaj pushtetit Hyjnor dhe të vendosë monarkinë ose ndonjë formë tjetër sundimi, parapësëparë duhet konsideruar si ato pushtet që i përziejnë gjyqtarët me sundimtarët. Sepse, zakonisht, njeriu duhet t`u drejtohet organeve të gjyqit që të sigurojnë të drejtën legjitime, që duhet t`ia garantojë pushteti ekzekutiv, që është degë e veçantë e pushtetit. Pushteti tiranik-duke përfshirë këtu gjyqin, pushtetin ekzekutiv dhe të gjitha komponentat e tjera të pushtetit-inkorporon gjithë atë që nënkuptojmë me tagutin, sepse ai u rebelua kundër pushtetit Hyjnor, duke themeluar ligj të gabueshëm, dhe atë e bën bazë të praksës gjyqësore. All-llahu na urdhëron që të mos u besojmë atyre, por duhet t`iu kundërvihemi atyre dhe normave të tyre jetësore. Të gjithë ata që nga ky aspekt nuk duan t`i besojnë tagutit, do të thotë nuk shprehin gatishmëri të dërgojnë pushtetin jolegjitim, kan obligim të rëndë të cilin duhet plotësuar tërësisht. Tash ta analizojmë traditën e njohur si makbuli i Umer ibën Hanzala-së që të konstatojnë domethëninë dhe qëlimin e tij. Umer ibën Hansala thotë: “E pieta Imam Sadikun (paqja qoftë mbi të) a u lejohet dy shiitëve, të cilët janë konfrontuar për shkak të borxhit dhe të huasë, të kërkojnë vendim prej sunduesit ose prej gjykatësit? Ai është përgjigjur: “Duhet të gjejnë dikë prej mesit tuaj që predikon traditat tona, që është i njoftuar me atë që është e lejuar dhe me atë që është e ndaluar; që është i njoftuar mirë me ligjet dhe dispozitat tona, dhe ta pranojmë si gjykatës dhe arbitër, sepse unë e emëroj si gjykatës tuajin. 126)”

Fillimi dhe mbarimi i kësaj traditë s`lë vend për dyshim, po ashtu edhe të referuarit e Imamit në ajet e Kur`anit, ka për qëllim udhëzimin relevant për emërimin e imamit dhe shërben si përgjigje për shumë gjëra me rëndësi.

E thash edhe më herët se për zgjidhjen e shumë çështjeve civile dhe penale secili duhet t`u drejtohet gjykatësve, pushtetit ekzekutiv dhe autoriteteve kryesore të pushtetit. Individit i drejtohet gjykatësit që të dalë në shesh e vërteta, të shuajë armiqësitë dhe të caktohet dënimi. Kurse pushtetit ekzekutiv i drejtohem për aprovimin e aktvendimit që e shqipton gjykatësi, qoftë lëndë e natyrës së kodit civil ose penal. Për këtë arsye për traditën për të cilën flasim, Imami është pyetur se a mundemi të ndikojmë të pushtetmbajtësit actual dhe te aparati legjislativ i tyre.

Imami me anë të kësaj përgjigje ka ndaluar çfarëdombrojtje nga pushteti jolegjitim, duke i futur aty edhe organet ekzekutive e gjyqësore. Ai ua ndalon muslimanëve që të jenë nën influencën e mbretërve dhe sundimtarëve, si dhe nën influencën e gjykatësve që veprojnë si agjentë të tyre. Sikur edhe t`i jetë vlarë një fëmijë muslimanit ose t`i jetë vjedhur shtëpia, ai nuk ka të drejtë të kërkojë ndihmë nga ai pushtet i korruptuar. Po ashtu nëse dikush i ka borxh dikujt dhe dhënësi ruan document për atë por nuk mund t`i nxjerrë prej borxhliut të keq, parapseparapë nuk guxon t`u drejtohet gjykatësve për ndihmë sepse ata janë nënpunës dhe shërbëtorë të tiranit.

Në rastë të tilla, nëse muslimani kërkon ndihmën e tyre dhe e fiton davanë nëpërmjet pushtetit jolegjitim, ky veprim është haram 127) dhe rezultatit e këtij akti nuk ka të drejtë ta shfrytëzojë. Disa fukaha shkonë aq larg saqë këtë rregullativë e aplikojnë edhe në rastet kur pasuria është kompenzuar. Për shembull, nëse ua kanë vjedhur gunën dhe ju arrini ta gjeni me ndihmën e intervenimit të autoritetit jolegjitim, nuk keni të drejtë që ta bani atë. Për këtë rast edhe mund të diskutohet, por nuk ka dyshim për rastë të përgjithshme. Nëse dikush don t`i kthehet borxhi, dhe këtë mundohet ta arrijë përmes organeve ose ndonjë autoriteti që nuk janë të pranueshëm nga ana e Zotit, një gjë e tillë nuk lejohet me Sheriat.

Kriteri fundamental i sheriatit është obligativ. E gjithë kjo është parim politik. Ky parim i detyron muslimanët që t`iu shmangen gjyqtarëve dhe pushtetit jolegjitim sistemi gjyqësor it ë cilëve nuk sjell diç të mirë por vetëm mjerim. Si kundërshtëpërlim, hap rrugë për të gjet mbrojtje te Imamët (paqja qoftë mbi ta) dhe te ata që përcollën të drejtën për të sunduar dhe për gjykuar. Imamët deshtën t`i pengojnë mbretërit dhe gjykatësit të mos vijnë në poste, sepse All-llahu i ka urdhëruar që mos u besojnë mbretërve dhe satrapëve të ndryshëm (d.m.th. duhej të rebeloheshin kundër tyre) 128). Prej atyre që i konsideromi shtypës dhe të papërshtatshëm që të sundojnë, nuk guxonin të kërkonin ndihmë.

Me këtë rastë, cila do të ishte detyra e bashkësisë Islam? çka duhet të bëjnë pjesëtarët e kësaj Bashkësie nëse paraqiten probleme të reja kur ndërmet tyre bëhen konfrontime? Cilit autoritet duhet t`i shmangemi? Në thënien e cituar më lartë, Imami (paqja qoftë mbi të) ka thënë: “Duhet të gjejnë dikë prej jush që predikon traditat tona, që është e ndaluar”, d.m.th. kurdoherë kur të ndodh mes jush ndonjë konfrontim, kërkonin që atë çështje tua zgjidhin ata që i transmetojnë hadithet sepse ata e kanë në dije se çka u ka lejuar All-llahu dhe çka u ka ndaluar, dhe i dinë të sheriatit. Imami nuk lënë hapësirë për asfarë hamendjeje, që dikush të thoshte: “Pra, dijetarët e hadithit u deshka të veprojnë si

njerëzit autoritativë dhe gjykatësit”. Imami i ka përmendur të gjitha kualifikimet e duhura dhe ka përshtetur personin në të cilin mund të gjejmë mbështetje: ai person duhet të jetë i zoti të japë fetva për atë që është e lejuar ose për atë që është e ndaluar, conform dispozitave që janë të njohura: të njohë dispozitat islame dhe duhet të dijë kriteret për të njohur traditën që rrjedh prej takijes dhe rrethanave të ngjashme (e që nuk duhet të mirren si valide). Është e qartë se njohja e dispozitave islame dhe profesionalizmi në shkencën e hadithit dallon prej aftësisë së vërtetë në transmetimin e hadithit. Në lidhje me këtë Imami thotë: “E emëroj sundues tuajin”-kjo do të thotë: u emëroj për sundues një person që i ka cilësitë e duhura”.

E emëroj secilin që ka aftësi për të mbrojtur interesat e muslimanëve ashtu që muslimanët mos kenë nevojë të të kërkojnë ndihmë prej të tjerëve, përveç se prej tij. Sipas kësaj, nëse dikush ua vjedh pasurinë tuaj i drejtoheni me ankesë autpritetit që e ka caktuar Imami. Nëse qortoheni me dikë për shkak të ndonjë borxhi ose huaje, dhe ju doni të dalë në shesh e vërteta, konstantin tuaj duhet të marrë gjykatësi i caktuar prej Imamit, e jo dikush tjetër. Kjo është detyrë universale e të gjithë muslimanëve, jo vetëm Umar ibën Hanzala-s, i cili, kur u ballafaqua me një problem të veçantë, nxori këtë rregull. Ky urdhër i Imamit, pra, ka karakter universal. Mu ashtu siç vepronte Komandanti i muslimanëve (paqja qoftë mbi të), i cili kishte autoritet absolute dhe autorizim të mbykëqyrë punën e të gjithë ulemave, fukahave dhe të njerëzve tjerë në përgjithsi, ka mundur të emërojë drejtorë dhe gjykatës jo vetëm gjatë jetës së tij por edhe për shekujt e mëvonshëm. Këtë ai e arriti duke emëruar fukaha si “sundimtar” ashtu që askush të mos mendojë se funksioni i tyre është reduktuar në çështjet e drejtësisë-pra larg çështjeve shtetërore. Mund të konstatojmë se që nga fillimi e deri në mbarim të kësaj tradite, si dhe nga ajeti Kur`anor të cilit i referohet ai, imami nuk u përqëndrua vetëm në emërimin e gjykatësve porse ai nuk la të pasqaruara edhe obligimet e tjera të muslimanëve, sepse, në të kundërtën do të mbetej pa përgjigje njëra prej pyetjeve të parashtruara: Kërkimi i drejtësisë prej atyre që janë në krye të pushtetit jolegjitim. Kjo traditë është e përkryer; nuk ka kurrfarë dyshim në zinxhirin e transmetuesve e as në domethënin e saj. Askush nuk mund të dyshojë se Imami (paqja qoftë mbi të) nuk ka caktuar fukaha që të kryejnë funksione shtetërore. Muslimanët janë të obliguar t`u mënshtrohen urdhërave të imamit. Për ta sqaruar më mirë këtë çështje, do të përmendi edhe disa tradita, duke filluar me atë të Ebu Hatixhes.

Ebu Hatixhe, njëri prej shokëve më besnikë të Imam Sadikut (paqja qoftë mbi të), transmeton: “Imami më urdhëroi të përcjell këtë porosi miqve tanë (d.m.th. shitëve): Kur ndërmjet jush do të lind ndonjë armiqësi a ngatërresë, ose ndonjë mospajtim në

dhënien ose marrjen e ndonjë shumë të hollash, assesi mos lejoni që ata çështje ta zgjidhë ndonjëri prej kriminelëve. “Vetë caktoni një gjykatës prej mesit tuaj i cili din të dallojë haramin nga hallali, sepse edhe unë do ta kasha emëruar për gjykatës një njeri të tillë. Askush prej jush mos akuzojë dikend para kësaj fuqie tiranike në pushtet...” (129). Domethënia e fjalisë “ngatërroheni për diçka” ka të bëjë me kodin civil, ashtu që pjesa e parë e urdhërit të Imami do të thotë se nuk kemi të drejtë të ndikojmë te kriminelët. Me fjalën “kriminelë” duhet nënkuptuar ata gjykatës të cilëve pushteti actual në mënyrë jolegjitime u ka lejuar që të zënë pozitën e gjykatësve. Më tutje Imami thotë: “Askush prej jush mos akuzojë dikend para fuqisë tiranike në pushtet”. Kjo do të thotë, çfarëdo polemike që të lindë ndërmjet jush, mos kërkoni ndihmë prej autoriteteve tiranike dhe pushtetit jolegjitim. Mos kërkoni ndihmë prej atyre për çështjet që i takojnë pushtetit ekzekutiv. Shprehja “sundimtari tiran” u referohet të gjithë autoriteteve dhe pushteteve jolegjitime (d.m.th sunduesit joislam, dhe i përfshinë të tri degët e pushtetit-juridik, legjislativ dhe ekzekutiv). Duke pasur parasysh se më parë ka qenë e ndaluar të ndikohet te gjykatësit tiranë, duket se ndalesa e dytë i referohet degës ekzekutive. Fjalja e fundit nuk është përsëritje e deklaratës së mëparshme. E para, Imami ndalon të kërkohet mbrojtje e siguri prej gjykatësve ateistë që janë të lidhura me punën e tyre (hetimi, procesi i dokumentimit etj.), përkrahur se kush mund të jetë gjykatës, dhe sqaron obligimet e itharëve të tij. Pasta jai deklaroi se duhet të përmbahemi e mos kërkujmë mbrojtje prej sunduesve jolegjitimë. Kjo sqaron pse çështja e gjykatës është e ndarë nga çështja e kërkimit të ndihmës prej sunduesit jolegjitim: ato janë dy lëndë të ndryshme. Që të dyja janë të përmendur në traditën e Umar ibën Hazala-s: në të është e ndaluar të kërkosh mbrojtje prej pushtetit jolegjitim dhe gjykatësve të atij shteti.

Në traditën e Ebu Hatixhes , Imami i emëron vetë gjykatësit , kurse në atë që e transmeton Umar ibën Hanzala , Imami i cakton edhe ata që duhet të veprojnë në kuadër të pushtetit ekzekutiv si dhe ata që duhet të veprojnë si gjykatës.

Pra , në përputhje me traditën që e transmeton Ebu Hatixhe , Imami i ka caktuar fukahatë për gjykatës qysh për së gjalli të tij , kurse sipas Umar ibën Hanzala-s , ai ka emëruar administratorët dhe gjykatësit. Tash duhet të gjurmohet se a e humbën fukahatë këtë funksion mbasi Imami e lëshoi këtë jetë. A thua se të gjithë gjykatësit dhe sunduesit (kryetarët) që i kishte emëruar Imami qenë të revokuar pas largimit të Imami?

Pushteti i Imami , natyrisht , dallon nga pushteti i të tjerëve. Sipas shkollës , Shiite , të gjitha urdhërat dhe instruksionet e Imami duhet të dëgjohen edhe gjatë jetës së tij , edhe pas vdekjes së tij. Por , pra marrë parasysh këtë të shohim se ç’ndodh me funksionet dhe obligimet që ata ua ndanë fukahave. Në të gjitha format e pushteteve ekzistuese , qofshin monarkiste , republikane , ose prej atyre që ndjekin ndonjë model tjetër , nëse kryetari i shtetit vdes ose ndërrojnë rrethanat e përgjithshme , ose bëhen ndërrime në administratë , të gjitha këto nuk ndikojnë në gradat ushtarake dhe në emërimet e funksionarëve. Sepse , kuptohet gjenerali nuk nuk do të privohet automatikisht nga rangu i tij , as ambasadori do të zëvendësohet prej dikujt tjetër , as do të hiqet nga pozita e tij ministri i financave , guvernatori local ose ai krahinor. Administrata e re ose

trashëguesja mund t'i ndërojë ose t'u gjejë vende tjera , por automatikisht t'u merren funksionet s'ka ndodhur.

Është e qartë se disa autorizime përfundojnë me vdekjen individit i cili i ndanë. i tillë është rasti i Ixhazei-hazbijes , autoritet të cilin ja ka dhënë dikujt një fakih për të kryer një detyrë në emër të tij , në një qytet, Kur vdes fakihu , ky autoritet shuhet. Por , në rastin e dytë , nëse fakihu i cakton tutor ndonjë çilimiu , emërimi i tij është valid edhe pas vdekjes së fakihut.

Funksionet juridike që ua përcjellin Imamët fukahave mbahen në diskrecion të thellë. Imami (paqja qoftë mbi të) ka qenë i vetëdëshëm për të gjitha aspektet e këtyre çështjeve , dhe nuk mund të ketë kurrfarë indolence nga ana e tij. Ai është dashur të dijë se në të gjitha qeveritë e botës se me vdekjen ose largimin e kryetarit nuk çrregullohet pozita dhe autoriteti i bartësit individual të një shërbimi. Po të kishte për qëllim që mbas vdekjes së tij t'ia merr të drejtën fakihut që të sundojë ose të gjykojë . atëherë ai rastin e lartpërmendur do ta sqaronte me fjalët: “Fukahaja duhet ta ketë këtë funksion derisa të jem gjallë unë”.

Sipas kësaj tradite , pra , Imami (paqja qoftë mbi të) i ka emëruar ulematë në pozita kryetarësh e gjykatësish , dhe ato pozita i kanë pasur të përjetshme. Mundësia që Imami pauses të ketë abroguar këtë vendim dhe të ketë penguar fukahatë të mos zgjidhen në këto dy funksione , është e pamundshme. Imami ua ka ndaluar muslimanëve që të kërkojnë ndihmë prej mbretërve dhe gjykatësve që ata i kanë emëruar për të arritur qëllimet e veta , dhe influenca e tyre konsiderohet punë tagutit 130) ai u caktoi njerëzve kryetarë dhe gjykatës. Trashëgimtari i Imamit po të mos kishte caktuar të njëjtat funksione të prarendësit të tij , çka do të bënin muslimanët dhe si do t'i zgjidhnin mosmarrëveshjet ndërmjet tyre. A do të kërkonin mbrojtje prej gjynahqarit a prej tiranit , që do të ishte njësoj sit ë kërkosh ndikimin e tagutit , dhe në atë mënyrë do të ishin shkelës të urdhërit Hyjnor? Po të mos ketë mbrojtje të vërtetë , do të mbretërojë anarkia , ashtu që njerëzit lirisht do t'ia uzurponin pasurinë njëri-tjetrit , duke qenë të pafrenueshëm në veprimet e tyre.

Jemi të sigurtë se pas Imam Sadikut (paqja qoftë mbi të) as biri i tij e as imamët e tjerë nuk e suprimuan funksionin e fakihut. Me të vërtetë është e pamundshme të suprimojnë këtë funksion dhe të thonë: “Prej tash mos u influenconi prej fukahave në kryerjen e punëve tuaja , por , në vend të tyre , drejtohuni mbretërve , ose mos ndërmerrni kurgjë , dhe lejoni të shkilen të drejtat tuaja”.

Natyrisht , nëse Imami emëron ndonjë gjykatës në një qytet , trashëgimtari i tij mund ta ndërrojë atë dhe të caktojë një gjykatës tjetër , por vetë funksioni dhe pozita e themeluar më parë nuk mund të abrogohet. Kjo vetvetiu është e kuptueshme.

Tradita , të cilën do ta citojë tash , e plotëson tezën që e paraqita. Po të ishte kjo traditë i vetmi argument nuk do të mund të dëshmoja pohimin tim. Thelbi i saj është argumentuar me tradita të shumta. Kjo që pason shërben si argument plotësues.

Imam Sadiku (paqja dhe mëshira qoftë mbi të) ka thënë: (Atij që niset në rrugë për të kërkuar dijen All-llahu i hap rrugën e xhennetit , kurse melektë i mbledhin krahët në shenjë respekti dhe kqnaqësie ndaj All-llahut. Gjithë çka ka në qiell dhe në tokë , madje edhe peshqit në detë kërkojnë merhamet për të. Superioriteti i njeriut të dishëm mbi njerëzit e zakonshëm është sikur superioriteti i hënës së plotë kundrejt yjeve.

Me të vërtetë dijetarët janë trashëgimtarë të peygamberëve: peygamberët nuk lënë trashëgim asnjë dirhem; në vend të tyre ata porosisin dijen , dhe kush e merr atë , e ka marrë pjesën më fisnike , të trashigimisë së tij 131)

Të besueshëm anë të gjithë ata që transmetuan traditën. i ati i Ali ibën Ibrahimit (Ibrahim ibën Hashim) është njëri prej atyre më të besueshmëve. Kjo traditë me ndryshime minimale në përmbajtje , është dokumenti i dytë , i cili nuk është aq bindës , kjo do të thotë se dokumenti është i saktë deri te Ebu Albhtari , por vetë ai nuk është i besueshëm.

Ja tradita e tij:

TRADITA ABU ALBHARI

Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të) thotë : ulemaja janë trashëgimtarë të Pejgamberit (paqja qoftë mbi të) Pejgamberët (paqja qoftë mbi të) nuk lënë kurfarë pasurie si trashëgim , por vetëm traditën (sunnetin – shën. i përkth.) Për këtë arsye kush e shfrytëzon këtë traditë , me të vërtetë ka shfrytëzuar mjaft për vete , për atë shikoni se prej kujt e merrni atë dije , sepse ndërmjet të afërmve të Pejgamberit (Ehli bejti) në të gjitha gjeneratat ka njerëz të ndershëm , të cilët nuk lejojnë që xhahilët dhe qëllimkëqinj të rrejshëm të rrejshëm për fenë.

Studimi i Traditës

Citimi i kësaj tradite (të cilën e transmeton Naraki) ka për qëllim të sqarojë domethënien e deklaratës : “Dijetarët janë trashëgimtarët e pejgamberëve”. Disa gjëra në këtë aspekt duhet sqaruar.

E para , kush janë “dijetarët”? A mendohet për dijetarët e bashkësisë Islame ose për imamët (paqja qoftë mbi ta) ? Disa njerëz janë të mendimit se fjala është për imamët. Por , përkundrazi , siç duket , fjala është për dijetarët e bashkësisë – ulematë. Vetë tradita udhëzon në këtë , sepse cilësitë dhe virtytet e Imamit , që janë përmendur në disa vende tjera , dallojnë nga ajo që përmban kjo traditë. Deklarata se pejgamberët kanë lënë trashëgim traditën , dhe kushdo që e mëson këtë traditë do të arrijë pjesën më fisnike të kësaj trashëgimie , nuk mund të shërbejë si definicion i Imamit. Sipas , kësaj , ajo duhet t’iu referohet dijetarëve të bashkësisë. Në versionin që e transmeton Ebul Buhturi , pas fjalisë : “Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberit” lexojmë: Për këtë shkak , shihni se prej kujt mund të fitoni dije.

Siç duket , me të vërtetë është kuptuar se dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve , poe secili duhet të jetë i kujdesshëm në zgjedhjen e personit prej të cilit të nxjehë dijen që e kanë lënë pejgamberët si trashëgim. Do të ishte në kundërshtim me kuptimin e traditës pot ë përmbanin thënien “trashëgimtarë të pejgamberit” dhe të mendohej për Imamët prej të cilëve njerëzit duhet të marrin mësim. Secili që i njeh traditat që konfirmojnë për statusin e Imamit dhe rangun të cilin ia ka ndarë më i Ndershmi Pejgamber (paqja dhe mëshira qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij) menjëherë do të kuptojë se në këtë traditë nuk është menduar për imamët por për dijetarët e Bashkësisë. Kualifikime dhe epitete të ngjashme janë përdorë edhe për dijetarët e traditave të tjera , p.sh: “Dijetarët e bashkësisë sime janë sikur të gjithë pejgamberët para meje” dhe “Dijetarët e bashkësisë sime janë si pejgamberët e Benu Israilëve”.

Atëherë , pra të përfundojmë se këtu qartë mendohej për ulematë – dijetarët.

Është i mundshëm edhe kundërshtimi i dytë i cili kërkon sqarim. Mund të thuhet se deklarata “Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve nuk mund të shfrytëzohet në dobi të tezës sonë pushteti i fakihut – sepse të dërguarit (el-enbija) kanë vetëm një dimension të pejgamberisë , d.m.th. ata fitojnë dije nga burimi sublime nëpërmjet shpalljes , frymëzimit ose nëpërmjet ndonjë metode tjetër , por e gjithë kjo nuk implikon

e as që kërkon pushtet mbi njerëzit e besimtarët. Po qe se Zoti i gjithëfuqishëm nuk i pajisi me virtyte liderësh , ata as që do të kishin diç të tillë. Po qe se i ka urdhëruar të transmetojnë njohuritë e fituara , atëherë obligimi i tyre më i madh ka qenë t’ua përcjellin njerëzve. Sepse në traditën tonë është bërë dallim ndërmjet të dërguarit en-nejb dhe atij resul: i dyti ka për detyrë të transmetojë njohuritë që i ka marrë , ndërsa i pari vetëm i pranon njohuritë. Madje nubuvveti dallohet prej velajatit dhe sipas kësaj tradite është përdorur shenja titullare “i dërguar” (en-nejb). Dijetarët janë bërë trashëgimtarë të peygamberëve në bazë të shenjës së tyre titullare dhe meqenëse kjo shenjë nuk implikon interesimin për pushtet (velajat) , nuk mund të konstatojmë se dijetarët duhet të kenë pushtetin.

Po të kishte thënë Imami se dijetarët janë në rangun e Musait dhe të Isait a.s. (Mojsiu dhe Jezui) , atëherë do të konstatojmë se dijetarët i kanë të gjithë cilësitë e Musait dhe të Isait , duke përfshirë edhe pushtetin. Mbasi që dijetarët nuk i vuri në rangun e të dërguarëve , nuk mund të nxjerrin përfundim të veçantë nga tradita për të cilën flasim. Në përgjigje të këtij kontesti më së pari duhet të konfirmojmë se kriteret për ta kuptuar traditën dhe tekstin e saj fjalë për fjalë duhet të jenë të pranueshme dhe sit ë tilla ne i kemi përvetësuar. Një fakih posa fillom të zbatojë analizën teknike subtile në të kuptuarit e traditës , atëherë shumë gjëra bëhen të pakuptueshme. Madje , nëse e studiojmë mirë thënien “Dijetarët janë trashëgimtarë të peygamberëve” në dritën e kriterëve të pranueshme , a thua do të na binte ndër mend se në traditë është menduar vetëm për shenjën titullare “i dërguar” dhe se dijetarët janë trashëgimtarë të atij që është i implikuar me atë shenjë? Ose , përkundrazi , kjo dëshmi na jep parimin e përgjithshëm që mund të aplikohet për peygamberë të veçantë? Me fjalë tjera , nëse e pyesim dikë që e di kuptimin e përgjithshëm të fjalëve “Ky dhe ky fakih a janë trashëgimtarë të Musait dhe të Isait?” ai do të përgjigjet – në dritën e traditës për të cilën e keni fjalën – “Po , sepse Musai dhe Isai janë peygamberë”. Nëse pyesim përsëri “Po fakihu , a është trashëgimtar i më të Ndershmit Peygamber” (paqja dhe mëshira qoftë mbi të) ai do të përgjigjet : “Po , sepse më i Ndershmi Peygamber është njëri prej peygamberëve”. Sipas kësaj , fjalën “peygamberët” nuk mund ta marrim si shenjë titullare , sepse është në shumës. Po të ishte përdorur në njëjës (“i dërguar”) atëherë do të ishte e mundshme të mendojmë vetëm për shenjën titullare , por meqenëse është përdorur në shumës , ajo do të thotë “secili peygamber” , dhe jo “secili peygamber” , duke marrë parasysh se në bazë të çkahit është i dërguar”. Ky kuptim vazhdues mund të na shtyjë të mendojmë se fjala është për shenjën titullare , ndryshe nga çdo shenjë tjetër , ashtu që kjo dëshmi merr këtë domethënie: “Fakihu e gëzon statusin e të dërguarit (en-nejb) por jo edhe statusin e lajmëtarit të fesë (resul) dhe të prijësit (valiut). Megjithatë , analizat dhe interpretimet e këtilla janë në kundërshti me doket dhe logjikën e përgjithshme.

Po ashtu mund të lind edhe kundërshtimi i katërt. Dispozitat që i la Peygamberi më i Ndershëm (paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij) janë trashëgimi, edhe pse nuk janë shenjuar sit ë tilla, kurse ata që i pranojnë ato dispozita janë trashëgimtar të asaj begatie. Mirëpo, çfarë dëshmie kemi për funksionin që e ka kryer i Dërguari se mund të

trashëgohet. Ka mundësi ajo që ka qenë e trashëgueshme të përmbajë dispozita dhe sunnete, sepse, është thënë disa herë, pejgamberët trashëgim lënë dijen, ose në versionin që e transmeton Ebul Buhturi, thuhet se ata e kanë rekomanduar “trashëgiminë e traditës dhe atë të thënieve të tyre, por pushteti nuk mund të rekomandohet e as të trashëgohet. Ky kundërshtim po ashtu nuk është i drejtë. Mbase që pushteti dhe të komanduerit janë gjëra racionale, nga ky aspekt duhet të mbështetemi te njerëzit e dishëm. Ata mund t'i pyesim çka mendojnë në lidhje me këtë, a është i mundshëm transferimi i pushtetit nga njëri individ të tjetri, me testament. Për shembull, nëse një njeri të dishëm e pyesim “Kush është trashëgues i pushtetit në këtë vend? thua se do të përgjigjet realisht se pozita e kryetarit nuk mund të trashëgohet, ose në vend të kësaj përgjigje, do të thotë se filani është trashëgimtar i fronit mbretëror?

“Trashëgimtari i fronti” është sintagmë e njohur. Nuk ka dyshim se pushteti mund të kalojë nga njëri person te tjetri, pikërisht si pasuria që trashëgohet. Nëse dikush më së pari e analizon ajetin “Pejgamberi ka të drejta më shumë ndaj besimtarëve sesa ata ndaj vetvetes”, pastaj e analizon edhe hadithin “Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberave” do të bindet se të dyja thëniet i referohen të njëjtit problem: bartjes së një gjëje nga njëri person te tjetri, që është racionale.

Nëse hadithi “Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve” iu referohet imamëve (paqja qoftë mbi ta) dhe kështu hadithi lë të kuptohet se imamët janë trashëgimtarë të pejgamberit (paqja dhe mëshira qoftë mbi të dhe familjen e tij) në çdo aspekt-nuk do të ngurojmë të themi se imamët janë trashëgimtarë të pejgamberit në të gjitha aspektet dhe askush s`mund të pohojë se trashëgimia për të cilën u fol këtu nuk i referohet vetëm dijes dhe çështjeve juridike.

Nëse para vetes kenmi vetëm hadithin “Dijetarët janë trashëgimtar të pejgamberit” dhe po që se nuk e përfillim fillimin dhe mbarimin e kësaj thënie, do ta kemi të qartë se të gjitha funksionet e Pejgamberit që kanë mundur të barten, duke përfshirë edhe pushtetin ndaj njerëzve (të cilat pas pejgamberit kaluan në duar të imamëve) u takojnë edhe fukahave, me përjashtim të atyre funksioneve ë kemi mundësi t'i përjashtojmë sa herë që të ketë arsye për diç të tillë.

Problemi më i madh që mbetet aktual është se hadithi “Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve” përmendet si sugjerim se trashëgiminë e pejgamberit e përbejnë hadithet e tij. Një traditë autentike që e transmeton Kadahu thotë: “Pejgamberët nuk kanë lënë trashëgim as një dirhem; në vende tëdirhemit ata kanë lënë dijen”. Kurse sipas Abul Buhturit thuhet: “Me të vërtetë pejgamberët nuk kanë lënë trashëgim asnjë dirhem, ata kanë lënë trashëgim thëniet e tyre dhe traditën”.

Këto të dhëna na sygjerojnë se trashëgiminë e pejgamberit e përbën tradita e tij, dhe pas kësaj nuk mbetet kurrgjë për të trashëguar, sepse në tekst këtë e përforcon pjesëza “innema” (“me të vërtetë”) e cila ka karakter ekskluziv.

Por edhe, ky kundërshtim është për çdo kritikë. Po të ishte ashtu siç thuhet se Pejgamberi a.s. nuk ka lënë kurrgjë trashëgim përveç sunnetit-traditës së tij, kjo do të binte ndesh me bazat e shkollës Shiite. Pejgamberi pati lënë gjëra që kanë mundur të trashëgohen, dhe s`ka dyshim se në mes tyre ka qenë qeveria ose mbajtja e pushtetit, të cilën ai ia përcolli Komandantit të Besimtarëve (paqja qoftë mbi të) pastaj edhe

imamëve tjerë me rend (paqja qoftë mbi të gjithë ata). Pjesëza “innema” nuk gjendet në tekstin që e ka transmetuar Kaddahu, por vetëm në tekstin që e ka transmetuar Abul Buhturi, zinxhiri i transmetuesve të të cilit është shumë i dobët, siç thashë edhe më herët.

Po e shqyrtojmë me rradhë secilën fjali në tekstin që e ka transmetuar Kaddahu që të mund të shohim se vetë kontestia lë të kuptohet se trashëgiminë e Pejgamberit e përbën vetëm tradita e tij.

“Secilit që niset në rrugë për të kërkuar dituri, All-llahu i hap rrugën drejt xhennetit”. Kjo deklaratë është lavdërim për dijetarët, lavdërim për cilindo dijetarë, ndërsa ne mund ta marrim me mend se kjo deklaratë i lavdëron të gjitha tipat e dijetarëve. Po ta shohim traditën në El-Kafi që bën fjalë për atributet dhe detyrat e dijetarëve, do të shohim se për t`u bërë dijetar dhe trashëgimtar i pejgamberit nuk do të thotë të kesh studiuar disa rreshta dhe hiç më tepër. Dijetari ka obligime që duhet pajtetër t`i kryejë, mu këtu qëndron problemi kryesor i kësaj thirrjeje.

“Melektë i leshojnë krahët e tyre në shenjë kënaqësie për të “. Domethënia e fjalëve” i leshojnë krahët e tyre” u është e qartë atyre që sillen në atë mënyrë. Ky është aktrespekti dhe modestie.

“Gjithë çka ka në qiej dhe në tokë, madje edhe peshqit në detë, lypin mëshirë për të”. Kjo thënie nuk është e nevojshme të sqarohet më tepër, pasi nuk është relevante për temën tonë.

“Superioriteti i njeriut të dishëm mbi njerëzit e zakonshëm është si superioriteti i hënës së plotë mbi yjet”. Domethënia e kësaj fjalie është më se e qartë.

“Më të vërtetë dijetarët janë trashëgimtar të pejgamberëve “. Tërë tradita, që nga fillimi e deri te kjo fjali, tërësisht bën prezentimin e cilësve të larta të dijetarëve dhe i lavdëron ata. Kur trashëgimtarët e pejgamberëve qeverisin popullin si duhet, jemi të porositur t`iu nënshtorhemi urdhërave të tyre.

Domethënia e deklaratës “Pejgamberët nul lënë trashëgim asnjë dirhem” nuk është se ata nuk kanë lënë kurgjë përveç, dijes dhe traditës. Ky është një indikacion se pejgamberët, edhe pse kanë qeverisur popullin, kanë qenë njerëz të All-llahut dhe jo kultura materialiste që mundohen të grumbullojnë thesarin e kësaj bote.

Kjo nënkupton se mënyra e qeverisjes së pejgamberëve ka qenë ndryshe nga sistemi monarchist si dhe nga sistemet e tjera, të cilat i kanë shërbyer sundimtarit si mjet për t`u pasuar dhe për të jetuar i kënaqur.

Mënyra e jetës së Pejgamberit a.s ka qenë shumë e thjeshtë. Ai nuk e shfrytëzoi pozitën dhe autoritetin e tij që të pasurohej materialisht e pastaj ta lente trashëgim. Ajo çka la pas vetes ishte dija, gjëja më fisnikë në botë, veçanërisht dija që i erdhi nga All-llahu xh.sh. Është e mundshme që theksimi i dijes në këtë traditë të ketë qenë e zgjedhur pikërisht për shkak të fisnikërisë së saj.

Nuk mund të thuhet se dijetarët janë trashëgimtarë vetëm të dijes dhe të traditës për arsye se në këtë traditë cilësitë e dijetarëve janë përmendur pasi që janë bërë trashëgimtarë të dijes, e jo trashëgimtarë të pasurisë.

Në disa variante kësaj tradite i shtohet fjalia “Ajo çka e lëmë pas nesh është lëmosha”, por ajo me të vërtetë nuk e ka vendin. Ky formulim u gjet në versionet e traditës Sunnite, dhe ishte i shtuar për shkaqe politike 134). Diç më tepër në kontekst me këto fjali që e përmbushim thënie “Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve” është se kjo thënie nuk mund të ketë kuptim absolute, sepse atëherë do të kishte këtë kuptim:

gjithëçka që u takon pejgamberëve njëkohësisht u takon edhe dijetarëve. Por kjo thënie nuk mund të merret edhe me kuptim të rudhur thuajse dijetarët qenkan vetëm trashëgimtarë të dijes së pejgamberëve. Sikur të kishte këtë kuptim, tradita do të ishte në kundërtënie me traditat e tjera që i kemi përmendur më herët në lidhje me këtë temë. Nga kjo nuk mund të nxirret ndonjë domethënie e kufizuar.

Nëse është e vërtetë se kjo traditë konfirmon se Pejgamberi a.s nuk ka lënë trashëgimtar tjetër përveç dijes dhe se liderizmi dhe pushteti nuk mund të jenë me testament ose të trashëguar, edhe pse nga fjalët e Pejgabmerit “Aliu është trashëgim imi” nuk konstatojmë se Komandanti i Besimtarëve me të vërtetë që trashëgimtar i tij, atëherë jemi të detyruar të gjejmë shpjegim në nas’h 135) duke pasur parasysh trashëgiminë e Komandantit të Besimtarëve dhe të imamëve tjerë (paqja qoftë mbi ta).

Pastaj është e udhës të aplikojmë të njejtën metodë në udhëqjen e pushtetit të fakihut, sepse, sipas traditës së cituar më lartë, fukahatë janë vënë në pozita udhëheqëse. Në këtë mënyrë e shtruar problemin e traditës për ata që kanë indicone e paranjohuri për emërtimet.

Naraki në veprën e tij Aavid 136) citon traditën vijuese nga fikhu Rizavi 137): “Në kohën e sotshme rangi i fakihut është si rangi i pejgamberit të Benu Israilëve”. Natyrisht, nenuk mund të vërtetojmë se Imam Riza me të vërtetë hartoi Fikhu Rizavi-në, por le të na lejohet të kumtoj se plotësisht vërteton tezën tonë.

Dunet patjetër të sqarohet se me “pejgamberë të Benu Israilëve” është menduar për pejgamberët, e jo për fukahatë që jetuan në kohën e hazreti Musës, dhe ndoshta nga kjo apo ajo arsye i quajtën pejgamberë.

Fukahatë që jetuan në kohën e hazreti Musës ishin të nënshtruar autoritetit të tyre dhe i kryenin funksionet e tyre me bindje të plotë. Ndoshta ndonjëherë, duke i dërguar të transmetojnë ndonjë lajm, a ii quajti “bartës të autoritetit”-është e kuptueshme se ne nuk jemi saktë të informuar për gjëra të tilla-por është e qartë se Musai qe njëri prej pejgamberëve të Benu Israilëve, dhe të gjitha funksionet që ekzistonin për pejgamberin a.s kanë ekzistuar edhe për Musanë, por dalloheshin, natyrisht, për “rang” ne konstatojmë se të njejtat funksione që i kreu Musai vlejné edhe për fukahatë.

Xhamiul-Ahbar 138) përmban traditën vijuese të më të Ndershmit Pejgamber (paqja dhe mëshira qoftë mbi të dhe familjën e tij): “Në ditën e gjykimit unë do të mburrem me dijetarët e ummetit tim, sepse dijetarët e ummetit tim janë si pejgamberët para meje”. Kjo traditë shërben si mbështetje për tezën time.

Në Mustadrak 139) është përmendur një traditë nga Gurari 140) me këtë përmbajtje: “Dijetarët janë mbretër të njerëzise:.. Në një version është shënuar “kukama” (të urtët mendimtarët) në vend “hukkama” (sundimtarët) por duket se nuk është në rregull. Sipas Guranit forma e drejtë është “hukkama”. Domethënia e kësaj traditë është e qartë dhe zinxhiri i transmetuesve është me vend, dhe mund të shërbejë në favor të tezës sime.

Mund të citojmë edhe disa sosh. Njëra prej tyre është përmendur në Tuahful Ukul 141) në kaptinën “Administrimi i punëve dhe jetësimi i parimeve të dijetarëve”. Tradita përbëhet prej dy pjesësh. E para, të cilën e transmeton Kalorësi i të Munduarve (paqja qoftë mbi të) prej Komandantit të Besimtarëve- hazreti Aliut (paqja qoftë mbi të), ka të bëjë me urdhërin e të mirës dhe ndalimi is ë keqes. Pjesa e dytë është një fjalim i Kalorësit të të Munduarëve kushtuar pushtetit të fakihut dhe detyrimet që i janë imponuar fakihut siç është lufta kundër mizorëve dhe pushteteve tiranike dhe konsolidimi i pushtetit islam dhe jetësimin e dispozitave të Islamit. Me rastin e këtij fjalimi, që e mbajti në Minne 142) i sqaroi arsyet e xhihadit dhe luftës kundër shtetit tiranik emevit. Nga kjo traditë mund të nxirren dy tema më rëndësi: e para është parimi i sundimit të fakihut, ndërsa e dyta është: se fukahatë nëpërmjet xhihadit dhe urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqja, duhet të përmbysin pushtetmbajtësit tiranikë dhe të nxisin popullin ashtu që lëvizja universale e të gjithë muslimanëve të arrijë të themelojë pushtetin islamik në vend të regjimeve tiranike.

Ja ajo traditë:143) Kalorësi i të Munduarëve (paqja qoftë mbi të) ka thënë: “O njerëz! kujdesohuni për botën që All-llahu ua dha miqve të Vet kur i qortoi rabinët me këto fjalë: “Përse të mos i largojnë njerëzit e ndershëm dhe të dishëm nga fjalët mëkatnore dhe ushqimet e ndaluara. Po shumë keq bëjnë!” (5:63).

All-llahu në vazhdim thotë: “Ata që mohuan të vërtetën nga Benu Israilët, u mallkuan prej gjuhës së Davudit dhe të Isait, të birit të Mejremes. Kështu u veprua sepse kundërshtuan dhe u tepruan. Ata ishin që nuk ndalonin njëri-tjetrin nga e keqja që punonin. E ajo që benin ishte e shëmtuar” (5:78-79). All-llahu ua tërhoqi vërtetjen pse me sytë e tyre i shihnin tiranët duke kryer vepra mizore por nuk i kanë penguar për shkak të interesit të kishin dhe nga frika e ndjekjes dhe padrejtësisë. Megjithatë, Allahu na ka urdhëruar që t’i frikohemi Atij e jo njerëzve. Ai thotë: “Besimtarët dhe besimtarejt janë miq të njëri-tjetrit: porosisin për vepra të mira dhe pengojnë nga veprat e këqia...”(9:71).

Nga ky ajet shohim se All-llahu na urdhëron të bëjmë vepra të mira dhe na pengon nga veprat e këqia, duke e konsideruar këtë si punë të parë. Sepse, Ai e di, nëse në shoqëri jetësohen këto detyra, për tjerat-prej më të lehtëve deri te më të vështirat-të mos flasim. Arsyeja e gjithë kësaj, pra të urdhëruarit në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, qëndron në faktin se vuhemi në mbrojtjen e të drejtave të të munduarëve dh thirrje në Islam. Madje paraqet luftë kundër shtypësve Brenda bashkësisë, përpjekje që të mirat shoqërore dhe preja e luftës të ndahet sipas parimeve juridike islame, dhe se tatimet (zekati dhe të

gjitha format e tjera të të ardhurave fiskale, qofshin ato të detyrueshme ose mbi baza vullnetare) të tubohen dhe pastaj të shprenzohen në mënyrë gjegjëse.

“O dijetarë! Ju keni arritur famë në shoqëri për shkak të devotshërisë suaj, për shkak të këshillave të mira dhe udhëzimeve që ofroni. Njerëzit ju nderojnë për hirë të All-llahut dhe respektit të thellë ndaj jush, për atë juve ju frikohen edhe njerëzit në pushtet dhe e ndiejnë veten të obliguar të sillen sa më njerëzishëm ndaj jush. Kur njerëzit nuk e fitojnë atë që u takon nga arka shtetërore, ju përziheni dhe veproni si monark dhe e matni veten me të mëdhenjt. A thua se të gjitha këto nuk i keni arritur me bekimin e njerëzve se do të zbatoni ligjet e All-llahut edhe pse në të shumtën e rasteve nuk keni vepruar ashtu?

“Ju nuk keni mbrojtur shumicën e të drejtave që u janë besuar. S`keni përfillur të drejtat e të shtypurve ë të nënçmuarëve, keni marrë nëpër këmbë të drejtat e të dobtëve e të fukarave, por me ngulm keni ndjekur ata që e keni konsideruar të drejtë legjitime tuajën. Ju nuk e keni shpenzuar pasurinë e as keni rezikuar jetën për shkak të Njërit që ua ka falur jetën, as që keni luftuar kundër ndonjë grupacioni ose fisi për All-llahun. Ju, dëshironi, dhe e konsideroni të drejtë tuajën, që Ai t`ua falë xhennetin, shefaatin e Pejgamberit dhe t`ju mbrojë nga zjarri në botën tjetër. Ju që pritni të tilla gjëra prej All-llahut, kam frikë se mos hidhërimi i Tij bie mbi ju, mbasi me ndhimën e Tij keni arritur famë dhe pozita të larta dhe nuk tregoni respect ndaj atyre që e dinë All-llahun dhe dëshirojnë t`i zgjerojnë njohuritë e tyre, ndërsa ju gëzoni respect në mesin e robërve të All-llahut në hesap të Tijin”.

Meqenëse sendërtimi i persiatjeve të disa individëve mbetet në kuadër të xhamisë , në të cilën gjendemi tash dhe nuk mund të përhapet më larg , kur e dëgjojnë formullën “shpenzimi i gjërave të ndaluara” ata përfytyrojnë ndonjë tragtar rrugësh se si , ruana Zot , u shet blerësve mall pa mbulesë. Ata nuk pandehin se ekziston një varg formash të rëndësishme “të të shpenzuarit të gjërave të ndaluara”. Shuma të mëdha kapitali janë gllabëruar; janë përvetësuar fondet tona shoqërore , është plaçkitur nafta jonë , vendi ynë i është kthyer blerjes së prodhimeve të shtrenjta dhe të panevojshme të kompanive të huaja , të cilat kompani u mundësojnë agjentëve të tyre lokalë që të vjedhin paratë e popullit. Shumë shtete të huaja e plaçkisin naftën tonë të posanxjerrur nga toka , dhe sasi të mëdha që i paguajnë regjimit që ata vetë e kanë përruruar , iu kthehet sërish , përmes kanalesh tjera , në xhepat e tyre. Për sa i përket sasisë që arrin në arkën shtetërore , vetëm All-llahu e di se ku dhe si shpenzohet. Kjo është forma “e shpenzimit të gjërave të ndaluara” dhe se ka marrë përmasa të përbotshme. Kjo është e keqja e të gjitha të këqia. Hulumtoni me kujdes rrethanat shoqërore dhe sjelljen e pushtetit dhe organeve tjera dhe do të hetoni se so bëhet “shpenzim i gjërave të ndaluara” në mënyrë enorme. Po qe se ndodh ndonjë tëmet në një skaj të vendit , për profitierët e pushtetit është rasti i volitshëm për të shtuar pasuri të paligjshme. Ata i mbushin xhepat e tyre me të hollat e destinuara viktimave të tërmetit. Kryetarët tanë antipopullor sa herë që bëjnë marrëveshje me shtetet dhe kompani të huaja , vjedhin shuma maramendëse të parave të popullit dhe shkapërderdhin shuma plotësuese për zotërinjtë e tyre të jashtëm. Kjo është rrëke e vërtetë e shpenzimit të palejueshëm që vërshon para nesh , mu para syve tanë. Të gjitha këto abuzime antiligjore shkojnë edhe më larg: i hasim në tregtinë me botën e jashtme dhe në kontratat për eksploatimin e pasurive xeherore , në shfrytëzimin e pyjeve

dhe resurseve tjera natyrore , në ndërtimtari , në ndërtimin e rrugëve dhe në furnizimin me armë nga imperialistët – perëndimorë dhe komunistë.

Duhet të marrë fund kjo plaçkitje dhe uzurpimi i pasurisë shoqërore. Për këtë të gjithë jemi përgjegjës , por përgjegjësia e dijetarëve të fesë është e pakontestueshme. Ne duhet t'i udhëheqim muslimanët në xhihad në këtë ndërmarrje të rëndë. Ne duhet patjetër të jemi në rradhët e para. Nëse sot nuk kemi forca që t'i pengojmë këto pshtërsi dhe t'i dënojmë plaçikësit dhe tradhtarët këta hajna që na ndrydhin vazhdimisht , atëherë duhet të mundohemi që të forcohemi. Njëkohësisht , që të mund të përmbushim obligimin tonë minimal duhet të themi të vërtetën para opinionit dhe të nxjerrim në shesh hajnitë dhe mashtrimet e sundimtarëve tanë. Kur t'ua marrim pushtetin , jo vetëm që do të stabilizojmë jetën politike të vendit , por do t'i ndjekim dhe do t'i dënojmë hajnat dhe gënjeshtarët.

Ata e dogjën Mesxhidi Aksanë 148). Ne thirrëm: “Lenie ashtu gjysëm të djegur Mesxhidi Aksanë , mos i fshini gjurmët e krimit!” Por regjimi i Shahut hapi llogarinë rrjedhëse , themeloi fond të posaçëm dhe nisi të mbledhë të holla prej popullit , gjoja për meremetimin e Mesxhidi Aksasë , porn ë realitet ai me atë veprim mbushte xhepat e udhëheqësve tanë , dhe mbulonte aktin kriminel.

Ekzistojnë fatkeqësi të ndryshme që popujt tanë muslimanë i sollën në këtë gjendje. A s'është detyrë e çdo shkencëtari islam që të flet haptazi për të gjitha këto. “Pse rabinët nuk e ndalojnë shpenzimin e gjërave të ndaluara?” Pse nuk protestojnë muslimanët tanë? Pse nuk thuan kurrjë për të gjitha këto plaçkitje?

T'i kthehemi fjalimit të Kalorësit të të Munduarëve (paqja qoftë mbi të) , i cili vazhdon , duke iu referuar këtij ajeti: janë mallkuar ata , nga Izraelitët , të cilët me gjuhën e Davudit dhe Isait , të birit të Merjemes , kanë mohuar , për shkak se ishin të padëgjueshëm , dhe gjithmonë e tepronin (5:78). Për këtë diskutim kjo nuk është aq relevante. Mandej thotë: “All-llahu i qortoi dhe i fajësoi (rabinët) sepse me sytë e vet i shikonin shtypësit duke bërë punë të çoroditura , por nuk i ndalonin. Sipas mendimit të Kalorësit të të Munduarëve , heshtja e tyre ka qenë rezultat i dy faktorëve: i lakmisë dhe i poshtërsisë.

Ose kanë qenë njerëz që kanë përfituar materialisht prej shtypësve , duke marrë rroga të majme ose kanë qenë qyqarë që frikën e kanë pasur në placë.

Duke konsultuar traditën që qëmton çështjen e urdhërit për të bërë vepra të mira dhe për të penguar nga veprat e këqia , mund të konstatojmë se gjykohet sjellja e atyre që gjithmonë trillojnë arsyetime për t'i ikur përgjegjësisë , por heshtja e tyre konsiderohet poshtërsi. All-llahu thotë: “...Më frikësohuni Mua që t'ua plotësoj dhuntinë time dhe që të jeni të udhëzuar” (2:150). Ky ajet për afërsisht ka këtë kuptim: “Pse iu frikësoheni

njerëzve. Miqtë tanë (evlijatë) kanë dhënë jetën për Islamin; ju duhet të jeni të gatshën të bëni të njëjtën gjë”.

Në një vend tjetër në Kur'an thuhet: “Kurse besimtarët dhe besimtares janë miq të njëri-tjetrit: porosisin për vepra të mira dhe pengojnë nga veprat e këqia , edhe kryejnë namazin dhe japin zekatin , edhe e nderojnë All-llahun dhe Pejgamberin e tij. Ata janë , të cilët All-llahu do t'i mëshirojë. Pa dyshim All-llahu është fort i urtë” (9:71). Në këtë ajet All-llahu përmend porosinë për të bërë vepra të mira dhe të pengojmë nga veprat e këqia , sepse Ai e di: nëse këto obligime i kryeni siç duhet , të gjitha të tjerat , qofshin të lehta apo të rënda , do të vijnë në vend të vet. Madje të porosisish për vepra të mira dhe pengosh nga të këqiat do të thotë përkushtim ndaj All-llahut dhe flakje të shtypjes mizore , balafaqim me shtypësit , ndarje e presë së luftës drejt dhe-grumbullim e shpenzim i zekatit në mënyrë reale.

Po qe se këto obligime kryhen siç duhet , të gjitha punët e tjera vetë do të vijnë në vendin e vet. Nëse urdhërojmë në të mirë dhe pengojmë nga veprat e këqia , atëherë mizorët dhe agjentët e tyre nuk do t'ia arrinë të uzurpojnë pasurinë e popullit dhe të manipulojnë me të sipas kapriciozitetit të tyre , dhe nuk do të mund të shkapërderdhin zekatin e marrur nga goja e popullit. Sepse , ai që urdhëron në të mirë dhe pengon nga keqja aktivisht thërret në Islam , duke flakur padrejtësinë dhe duke iu kundërvënë mizorëve.

“Frikohem për ju edhe për një arsye: ju shihni se kontratat e lidhura me All-llahun janë shkelur, dhe aspak nuk ju shqetësojnë. Sikur të kishtë ndodhur kështu me kontrat që i bëni me baballarët tuaj, do të shqetësoheshit pa masë, ndërsa ndaj garancive që i keni dhënë Pejgamberit jeni krejt indifferent. Qorat, nemat dhe bujqit e mjerë gjithkund janë të pambrojtur dhe kurrfarë përkrahje s'kanë. Ju nuk silleni në përputhje me funksionin tuaj, as ndihmoni e as që keni dertin për ata që mundohen të përmirësojnë gjendjen e dijetarëve të fesë. Me lajkat, mashtirimet, servilizim, me kompromise, prej forcave shtypëse të pushtetit ju e bleni sigurinë.”

“Të gjitha këp All-llahu jua ka ndaluar juve edhe ju ka urdhëruar që gjithësecilët t'ia ndaloni këto, por ju aspak nuk i kushtroni kujdes. Fatkeqsia që u ka gjetur juve është më e madhe se të tjerëve, sepse ju është marrë statusi i vërtetë i ulemasë”. Administratimi i tokës, dhënia e këshillave juridike, aprovimi i programeve legjislative është dashur t'i besohet dijetarëve të fesë të cilët janë rojtarë të të drejtës së All-llahut dhe që i dinë parimet mbi atë se çka është e lejuar e çka është e ndaluar. Por pozita juaj ju është uzurpuar, jo për diçka tjetër por pse ju e keni lëshuar strumbullarin e së Vërtetës-Ligjin e Islamit dhe urdhërin e All-llahut dhe jeni grinder për shkak të natyrës së sunnetit, edhe pse ekzistojnë argumente të qarta.

“Po të ishit burra të vërtetë, të qëndrueshëm para vuajtjeve e torturave, të përgatitur t'u qëndroni fatkeqësive për All-llahun, atëherë të gjitha rregulloret e propozuara do

- D.m.th. kontratat shoqërore që i themelojnë institucionet shoqërore dhe i përcaktojnë marrëdhëniet shoqërore në Islam (H.).
- ** D.m.th marrëdhëniet në Islam të bazuara në betimin e dhënë Pejgamberit se do të jenë të nënshtruar dhe se do t'i dëgjojnë trashëgimtarët e Tij.

t'ua silin juve që t'i aprovonit: autoriteti do të ishte në duart tuaja.

Por, ju u lejuat shtypësve që t`ua marrin funksionet tuaja dhe lejuat që pushteti, i cili duhej të ishte i ngritur mbi baza të shariatit” të bjerrë në duart e tyre. Që të venë kontroll të plotë mbi pushtetin u ka mundësuar ikja juaj në mënyrë panike që mos mbeteni të vrarë, si dhe lidhmëria me jetën kalimtare të kësaj bote. Me një mentalitet dhe sjellje të këtillë ju lejuat që të varferit të bien në ktherat e satrapëve. Përderisa disa shkojnë rëshqanas nga të rënat e mizorëve, kurse të tjerët mjerueshëm lutën për një kafshore bukë a një pikë ujë, kryjetarët preokupohen me çeshtjet e mbretërimit, duke merituar trupin e shfrenisë ata rtegojnë paturpësinë ndaj Zotit. Në çdo qytet nga një orator që e kanë emëruar ata hipën në minber 144) Troll ii atdheut është i pambrojtur prej tyre, ata grabisin çka u do zemra. Populli është i pamundshëm që të luftojë vetë. Ndonjë kryetar për nga natyra është diktator, shpirtlig dhe dheltnak. Të tjerët pamëshirshëm ushtrojnë reprezalje mbi nënshtetasit e tyre qyqër, duke i plaçkitur dhe shtypur keq e më keq. Ndonjë i tretë me absolutizimin e tij të vrazhdtë refuzon të njohë All-llahun dhe Ditën e Gjykimit. A s`është për t`u çuditur se si një shoqëri e zënë ngusht në ktherat e shtypësit dinak aq shumë duron kur sheh se si tagrambledhësit dhe mëkëmbësit nuk ndiejnë kurfarë mëshire a keqardhje ndaj besimtarëve të cilët sundojnë?

“All-llahu është Ai që do të na gjykojë për konfrontimet dhe do të sjellë aktgjykim për atë që ndodh ndërmjet nesh”. “O Zot! Ti je i njoftuar se atë që e bëmë ne (d.m.th. luftën që e bëmë kundër emevive) nuk qe garë për pushtet politik, as përpjekje për të siguruar pasuri e luks. Përkundrazi, ne e bëmë atë për t`i treguar botës parimet e shenjta dhe vlerat e Fesë Sate, që të konsolidohet gjendja në vend, që t`iu sigurohen të drejtat legjitime robërve të Tu të shtypur, dhe që të veprojnë në bazë të normave që Ti i ke përcaktuar, në bazë të ligjeve dhe urdhërave që i ke paraparë.” “Andaj, o dijetarë të fesë! Ju duhet të na ndihmoni që t`ia arrimë qëllimit, që t`i rikthejmë të drejtat tona nga ai pushtet që u mundua të shuajë dritën që e ndezi Pejgamberi ynë. Mjaft e kemi All-llahun, Atij i drejtohem dhe prej Tij ndihmë kërkojmë, në duart e Tij është fati ynë dhe Atij do t`i kthehem.”

Në fillim të këtij fjalimi, kur Kalorësi i të Munduarëve tha: “O njerëz! veni re këshillës së All-llahut që Ai u dha miqve të Vet kur i qortoi rabinët,” me atë rast Ai nuk iu drejtua vetëm një grupi të caktuar njerëzish-të pranishmëve, banorëve të një vendi, qyteti ose të një shteti, as të gjithë popujve të botës. Këshilla e tij iu dedikohet të gjithë atyre që i përgjigjen da`ves në çdo kohë, sepse fillon me shprehjen “O njerëz! (ja ejuhen-nas) e cila shprehje me përmblajtjen e saj universale përmendet në Kur`an 145). All-llahu i kritikon rabinët, dijetarët hebrej, dhe e gjykon sjelljen e tyre, por në të njëjtën kohë iu drejtohet miqve të Vet (evlijave) dhe i këshillon ata. Fjala “evlija” u atribuohet atyre që i knaë kthyer fytyrat e tyre drejt All-llahut dhe zënë pozita me përgjegjësi në shoqëri, e jo Dymbëdhjetë Imamitë. 146)

Në ajetin që e analizojmë, All-llahu thotë: “Përse të mos i largojnë njerëzit e ndershëm dhe të dishëm nga fjalët mëkatnore dhe ushqimet e ndaluara. Po shumë keq bëjnë”. Ai, pra, i qorton rabinët dhe dijetarët e fesë hebreje pse nuk i pengojnë shtypësit-mizorët të mos bëjnë mëkate në të folur-term që ngërthen rrenën, mallkimin, sharjet, fshehjen e së vërtetës etj. – dhe shpenzojnë atë që u është e ndaluar. Kjo kritikë nuk iu drejtohet vetëm dijetarëve të fesë hebreje por edhe të atyre të krishterë. Ajo që iu referohet dijetarëve të botës muslimane si dhe të botës jomuslimane. Nëse dijetarët fetarë të komunitetit musliman heshtin përpara masave repressive politike, All-llahu do t`i dënojë, dhe këtu nuk bëhet dallim ndërmjet dijetarëve të kohës së shkuar, të së tashmes ose të kohës së ardhshme-ata janë të barabartë në çdo aspekt. Kalorësi i të Munduarëve (paqja qoftë mbi të) iu referua këtij ajeti të Kur`anit me qëllim që dijetarëve të

komunitetit musliman t`ua tërheq vërtetjen që të jenë më syçelë në kryerjen e detyrave të tyre, të urdhërojnë për të mirë dhe të pengojnë sjelljet e pahijshme.

Duke cituar këtë ajeti ai tërhoqi vërejtjen në dy gjëra: e para, kur dijetarët efesë nuk i përfillin obligimet e veta, është shumë më e dëmshme sesa kur njerëzit nuk i përmbushin obligimet normale. Nëse një tregtar dek në treg dhe vepron kundër ligjeve të tregut, ai vetë do t`ia sheh sherin një sjellje të tillë. Por, nëse dijetarët e fesë nuk i kryejnë obligimet e tyre heshtazi, më lejoni ta them, para tiranisë, lejojnë ngulfatjen e Islamit. Nëse ata, përkundrazi, veprojnë në përputhje me obligimet e tyre dhe haptas flasin sa herë që u mundësohet, duke shërbyer kështu në të mirë të Islamit.

E dyta, çkado që është në kundërshti me shariatën duhet ndaluar, sidomos theksohet mëkati në të folur si dhe shpenzimi i asaj që është e ndaluar. Nga kjo nënkuptohet se këto dy të këqia janë më të rezikshmet se cilado e keqe tjetër, të cilat duhet luftuar vazhdimisht. Hëre-hëre deklaratat dhe propaganda që e bëjnë regjimet shtypëse janë shumë më të dëmshme për Islamin dhe muslimanët sesa veprimet e tyre politike. All-llahu i qorton dijetarët e fesë që nuk i pengojnë shtypësit të mos fllasin fjalëboshe dhe të bëjnë propagandë. Ai thotë: “Pse nuk e damkosën njeriun i cili publikisht deklaroi se është mëkëmbës i All-llahut në tokë dhe instrument i vullnetit të Tij, madje tha se i zbaton ligjet e All-llahut në përpikmëri dhe se kupton dhe e praktikon drejt të drejtën islame, edhe pse nuk kishte haber se ç`është drejtësia. Deklaratat e këtilla janë shumë të dëmshme dhe shembull i fjalimit plot mëkte. Dijetarët e fesë, pse nuk e penguan këtë akt të ndytë, tiranët, që me paturpësi deklaruan kështu, kanë bërë tradhti dhe kanë nxjerrë bidate të çoroditura; pse dijetarët islamë nuk ua zënë rrugën që të mos bëjnë gjynahe?” 147)

Nëse dikush i interpreton dispozitat e All-llahut ashtu siç nuk lejohet fetarisht, nëse nxjerr bidate në Islam, dhe vënë jetë ligje antiislame, duke deklaruar se janë konform me kërkesat e drejtësisë islame, dijetarët e fesë janë të detyruar të kundërshtojnë repetisht. Nëse nuk e bëjnë këtë, All-llahu do t`i mallkojë, siç kuptohet nga ajeti për të cilin flasim: “Kur paraqiten bidate ateiste, dijetari e ka për detyrë të nxjerrë në dritë diturinë e tij (duke i denoncuar) përndryshe do të bjerrë mbi të malkimi i All-llahut.

Në rastet e këtilla, rezistanca kundër novotarisë është e dobishme sepse në këtë mënyrë masat e popullit binden për zvetnimin e shoqërisë dhe për poshtërsitë e tradhtarëve, mëkatnorëve dhe të sundimtarëve ateiste. Në këtë mënyrë populli rebelohet dhe shkëput çdo bashkëpunim me tiranët dhe kundërshtohen t`u nënshtrohen forcave të korruptuara në pushtet. Dalja në suprinë e opozitës së dijetarëve të fesë është formë e “ndalimit të së keqës” nga ana e udhëheqësisë fetare, e cila në verbullin e saj krijoi valë të gjera të opozitës dhe “ndalon të keqën” e besimtarëve dhe të njerëzve të ndershëm. Nëse sundimtarët e korruptuar nuk përulen para kerkësave të një lëvizje të tillë opozitare, nëse nuk kthehen në rrugë të drejtë dhe t`iu nënshtrohen parimeve Hyjnore, por përpiqn t`i nënshtrojnë nëpërmjet grykes së pushkës dhe ndërmarrin sulme agresive kundër muslimanëve, fitojnë statusin e një grupi kryengritës (fia bagija). Për shkak të kësaj, detyrë e çdo muslimani është të fillojë xhihad të armatosur kundër atij grupi sundues dhe t`i detyrojnë satrapët aktuale t`i koordonojnë normat e pushtetit me dispozitat e Islamit.

Shikuar realisht, ju tash nuk keni forca të pengoni praksën risimtare të sundimtarëve e as të ndaloni poshtërsitë e tyre. Por, bile mos heshtni. Nëse ata ju bien kokës, protestoni! Mos i nënshtrohuni shtypjes, sepse një nënshttrim i tillë është më i zi se shtypja. Që të mund të pengoni aparatën e tyre gazetaresk propagandistik, duhet të krijoni aparat propagandistic tuajin që të mund të përgjëneshtroni çdo lajm të rrejshëm të tyre dhe të

proklamoni se jurisprudence islame nuk është ajo që e prezentojnë ata, por përkundrazi se ka program unik komplet për rregullimin e çështjeve familjare dhe të mbarë shoqërisë muslimane. Të gjitha këto duhet të sqarohen që njerëzit të njihen me të vërtetën; gjeneratat e ardhshme mos e marrin heshtjen si argument se sjelja dhe politika shtypëse janë në përputhje me sheriatin dhe se Feja Islame lejuaka “të shpenzojnë atë që është e ndaluar” ose, me fjalë tjera, të plaçkisin pasurinë e popullit.

Këto virtyte janë detyra parësore për të realizuar qëllime të larta. Megjthatë, ne i kemi ërgjuar në kategorinë e veprave prej të cilave e pëson vetëm një individ. Në kategorikisht i përmbahemi qëndrimit tonë se instancat e së keqës, kundër së cilës ne jemi të thirrur të luftojmë (munkarat), janë ato gjëra që ne u hashim në jetën e përditshme. Për shembull nëse dikush ekzekuton ndonjë pjesë muzikore derisa udhetojmë me autobus 149), nëse pronari i kafenesë bën diç të pahijshme nëse dikush gjatë Ramazanit han diç në mes të pazarit 150) këto se jellje ne i konsedërojmë instance të së keqes të cilat duhet t'i detyrojmë të heqin dorë nga krimet.

Sikur të organizohet një protest kolektive kundër shtypjes ose me rastin e ndonjë akti vandal konkret, sikur të dërgoheshin prej të gjitha vendeve islamike disa mijeëra telegrame në të cilat do të kërkohet që të hiqin dorë nga këto krime, me siguri do ta zbatonin vullnetin e popullit. Në mbarë vendin, në çdo qytet dhe katund po ët kishte njerëz të caktuar për të ndërmarrë ndonjë hap kundër interesave të Islamit, ata do të ishin detyruar të tërhiqen. A do të mund të bënin diçka tjetër? Asnjëherë! Unë i njoh: e di se çfarë soji janë. Janë tepër tutkunë dhe shpejt do të tërhiqeshin. Por, kur shohin se ne jemi më lakmitarë se ata, prapë krekosën dhe bëjnë çka duan.

Kur me një rast u patën tubuar ulematë e Komit, të cilët patën përkrahjen e krahinave të vendit me dërgimin e delegacioneve dhe me mbajtje fjalimesh solidariteti, regjimi u detyrua të anulohet masat kundër të cilave protestuam 151). Më vonë arritën ta ftohën entuziazmin tonë dhe na dobësuan. Na ndanë dhe secilit na caktuan “detyra fetare” të veçanta. Rezultati i mospajtimeve ndërmjet nesh shihet në faktin se u mundësuan atyre të sillen ndaj muslimanëve dhe ndaj vendit tonë islamik si t'iu teket. Kalorësi it ë të Munduarve (paqja qoftë mbi të) flet për thirrjen (da`ven) në Islam si dhe për përmbysjen dhe ballafaqimin me shypësit mizorë.

Mu për shkak të këtyre qëllimeve të larta na u bë borxh të porosisim për vepra të mira dhe të pengojmë nga të këqiat. Nëse ndonjë tregtar i imtë bën diçka jo korrekte, ai nuk e dëmton Islamit por vetëm vetvetën. Në realizimin e këtyre qëllimeve, kujdesin më të madh duhet t'ua kushtojmë atyre që e dëmtojnë Islamit dhe me pretekste të ndryshme plaçkisin njerëzit.

Kemi pasur rast të lexojmë nëpër gazeta-herë me kontacion komik, herë me kontacion serioz-se kryetarët tanë kanë vjedhur prej gjërave të mbledhura për viktimat e vërshimeve dhe të tërmeteve.

Një alim nga Malajera më ka treguar se kanë dabsur të dërgojnë një kamion përplot me arkivole për viktimat e një fatkeqësie, por i ka penguar policia dhe i ka konfiksuar. “Të urdhërosh në të mirë dhe të pengosh nga e keqja”, në raste të këtilla është më se e domosdoshme.

Tash më lejoni t'ju pyes: çështjet që i përmend Kalorësi i të Munduarëve në fjalimin e tij, a thua se u drejttoheshin vetëm shokëve që ishin tubuar rreth tij? Vallë, a thua se fjalja “O nerëz! kujdesohuni” nuk na dedikohet edhe neve? A thua se nuk duhet të marrim mësim nga kjo ligjetarë e Kalorësit të të Munduarëve?

Siç theksova edhe në fillimin e këtij diskutimi, temat që i mbante Kalorësi i të Munduarëve nuk iu kushtoheshin vetëm një grupi apo një shtrese njerëzish. Paraqitja e tij ishte një letër qarkore drejtuar të gjithë prijësve, ministrave, kryetarëve, fukahve – shkurtimisht, tërë botës, sidomos atyre që janë të vetëdishme dhe me bindje të thellë. Në letër-qarkoren e tij ai iu referua ajetetit me të cilin porositen dijetarët hebrenj dhe rabinët, por përmbajtja e tij ka karakter universal. All-llahu ua zuri për të madhe dijetarëve jehudinj dhe rabinëve të cilët nuk ngritën zërin kundër mizorëve. Nëse ulematë tanë veprojnë në këtë mënyrë, po ashtu do të jenë të dënuar.

Kalorësi i të të Munduarëve, mes tjerash, iu drejtua edhe një grupi të veçantë, ulemave, dhe u tha: “Ju gëzoni prestigj në shoqëri: populli musliman ju nderon dhe krenohet me ju. Prej jush kërkohet të rebeloheni kundër pushtetit mizor, të mbronni drejtësinë dhe ta detyroni pushtetin aktual t’iu garantojë të drejtat legjitime të shtypurve. Njerëzit i mbështesin shpresat te ju që të pengoni shkeljen e të drejtave të tyre.”

“Ju keni arritur të siguronit pozita të larta. Por, ju nuk i keni kryer obligimet që ua imponon pozita. Nëse i ndodh diçka babës së ndonjërit prej jush, ose mos dhëntë Zotit, dikush ta ofendojë do të revoltoheshi dhe do të protestonit. Por, kur para syve tuaj thyhen ligjet e Zotit, për çka turpërohet Islami, ju heshtni dhe aspak nuk shqetësoheni. Sikur të shqetësoheni, do të dilnit të protestoni. Qirat, nemat dhe bujqite ngratë mirren nëpër këmbë, por askush nuk çanë kokën për ta; askush nuk ndien dhimbje për kërbëzbathurit e mjerë”.

A mendoni se e gjithë kjo propagandë bombastike që jepet nëpërmjet radios është e vërtetë? Shkoni vetë dhe shihni se si jeton populli ynë. Në njëmijë fshatra as një klinikë nuk e gjenë. Askush nuk kujdeset për varfëjakët, kurse ata nuk mundësojnë aplikimin e masave për furnizimin e varfënjakëve. Islami e ka zgjidhur problemin e të varfërve dhe e ka vënë në krye të detyrave programore. “Sadakja u takon të varfërve” 152). Imami është i vetëdijshëm se më së pari duhet t’i përmisojë kushtet jetësore të të varfërve, të shtypurve. Po rata (pushtetmbajtësit-shen. i perkth.) nuk lejojnë të jetësohet programi islamik.

Populli ynë i mjerë jeton në kushte të vështira, ndërsa klasa sunduese i shpenzon të hollat e arkës shtetërore vend e pavend. Ata blejnë fantom-xhetët dhe me ta voziten pilotët izraelitë dhe agjentët e tyre si në vendin e tyre.¹⁵³ I tillë është ndikimi izraelit në vendin tonë, por dihet se Izraeli është në gjendje luftë me muslimanët; edhe ata që e përmbajnë politikën izraelite janë në gjendje, lufte me muslimanët. Madje ushtarët izraelitë bëjnë stërvitje ushtarake në vendin tonë. Vendi ynë u bë bazë e tyre ushtarake. Tregtia e vendit tonë gjendet në duart e tyre. Nëse vazdohet kështu, dhe muslimanët qëndrojnë edhe më tej në apati, do të humbin primatin e tyre në jetën tragjare të vendit. T’i kthehemi fjalimit të Kalorësit të të Mundimtarëve (paqja qoftë mbi të). “Ju nuk e keni shfrytëzuar pozitën tuaj si duhet.

Jo vetëm që s’keni bërë gjë, por e keni penguar personin që ka dashur të kryejë obligimin e vet. Kënaqësia më e madhe për ju është të gëzoni respektin e shtypësve dhe t’ju drejtohen me :I nderuar shejh”. Pse populli vuan nën kthetrat e pushtetit, juve as që u bëhet vonë. Fatkeqësia që u ka pllakosur juve është më e madhe se e tjerëve, sepse e keni humbur shkallën e vërtetë të ulemave. Me qeverimin e punqve shtetërore u desht të mirren ata që kanë njohuri të gjithanshme për Zotin dhe që i zbatojnë urdhërat e Zotit. Por, ai mandate ju është marrë.”

Imami (paqja qoftë mbi të) në lidhje me këtë mund të thoshte: “E drejta ime më është uzurpuar, kurse ju nuk erdhët të më ndihmoni” ose “E drejta e Imamit është uzurpuar, kurse ju keni heshtur.” Në vend të kësaj ai ka folur për ata që “kan njohuri të

gjithanshme për Zotin” (el-ulemau billah) duke aluduar në dijetarët e fesë (rabbaniijunë) dhe liderët. Këtu nuk apostrofohen filozofët dhe mistikët, sepse njeriu që njeh All-llahun është njeri i udhëzuar në dispozitat e All-llahut. Njeriu i tillë konsiderohet dijetari i fesë (ruhani ose rabbani), por me kusht që të ai vërehet qartë spiritualiteti (përshpirtshmëria-ruhanijati) dhe përdhja drejt All-llhut të Gjithfuqishëm.

Imami vazhdon më tej: “Ju është uzurpuar pozita juaj, jo për diçka tjetër por për shkak se e lëshuat strumbullarin e së vërtetës dhe u pajtuat në mendime për çështjen e natyrës së Sunnetit, edhe pse ekzistojnë argumente të qarta. Po të ishit treguar të fortë para vuajtjeve për hirë të All-llahut, do të fitonit rolin udhëheqës: të urdhëruarit dhe pushteti do të ishin tuajat.”

Po të kryenit detyrën tuaj me nder, punët do të kryheshin si më së miri. Po të themelohet një rend shoqëror mbi bazën e parimeve islame, asnjë pushtet nuk do të mund t`i rrinte karshi: të gjithë do të kapitulonin. Por, mjerisht, ne nuk kemi arritur të themeljmë një pushtet të atillë. Madje edhe në fazën e parë të përhapjes së Islamit, kundërshtarët e tij pengonin që pushteti të mos bjerë në duar të atyre që i ka zgjedhur All-llahu dhe Pejgamberi i Tij.

“Ju keni lejuar që funksionet tuaja t`ua marrin shtypësit”. Me heqjen dorë nga pozitat tuaja ju u keni mundësuar mizorëve të marrin ato pozita që me Sheriat ju takojnë juve. Keni lejuar që amanetet e All-llahut të bien në duar të atyre që udhëhiqen nga premiset e autokracisë. Këtë ua mundësoi ikja juaj panike që mos vriteni, dhe dashuria ndaj jetës së kësaj bote. I keni lënë të ngartët të bien në ktherat e satrapëve të futen në zgjedhë si robër e shumë të tjerë janë privuar nga jeta. “E gjithë kjo ngjet në kohën kur po jetojmë. Në të vërtetë, edhe më ashpër sesa në kohën e vetë Imamit (paqja qoftë mbi të)”. Sundimtarët janë të zënë me kënaqësitë e oborrit të tyre dhe me këtë tregojnë paturpësi ndaj All-llahut. Në çdo qytet, hyp në minberi oratori dhe flet gënjeshtër. Gjatë asaj kohë oratorët nga minberi kanë glorifikuar shtypësit. Kurse sot, nëpërmjet radio-stacioneve, mbulojnë eterin me gjothfarë propagandash, duke i shtrembëruar dispozitat islame.

“Vendi është i pazoti para tyre.” Edhe sot ata mund ta eksplozojnë vendin lirisht, pa kurfarë pengese. Nuk ka kush t`ua zë rrugën. “Ata grabisin lirisht çka u do zemra, populli është i pazoti që të mbrohet. Ka prej tyre që njihen për absoltizimin e pashoq dhe se nuk e njohin All-llahun për fillues dhe mbarues të gjithçkahit. S`është për t`u habitur, madje është e vërtetë si loti se bota gjendet nën kthetrat e tiranëve të rafinuar të tagrambledhësve dhe mëkëmbësve që nuk kanë aspak mëshirë ndaj besimtarëve të nënshtuar?”

All-llahu është Ai që do të gjykojë për sjelljet tona dhe do të japë dënimin e merituar.

“O Zot! Ti e di se kurgjë nuk bëjmë për të arritur pushtet politik, as të zëmë botën me dorë. Me atë që bëjmë duam të demonstrojmë shenjat e Fesë Sate, për konsolidimin e jetës mbi tokë, për mbrojtjen e të shkelurve dhe për të udhëzuar në përputhje me normat dhe dispozitat Tua.”

“O dijetarë të fesë! Na ndihmoni të realizojmë përcaktimet dhe të drejtat tona. Tiranët do të mundohen të shuajnë dritën që e ka ndezur Pejgamberi a.s Por, na mjafton ndihma e All-llahut; Atij i drejtohem dhe drejt Tij çojnë rrugët tona”.

Ky fjalim, që nag fillimi deri në fund, drejtuar ulemave nuk ka indikacione të prezentojë rolin dhe pozitën e imamëve, por bën fjalë për dijetarët e fesë, rabbaniijunë. Rabbani konsiderohen dijetarët islamë, të cilët i besojnë All-llahut, i kryejnë detyrimet festare: porosin për të mirë dhe ndalojnë nga veprimet e këqia.

Kurt ha Imami (paqja qoftë mbi të) se qverisja u takon ulemave nuk pati ndërmend të kufuzojë këtë funksionë një periudhë kohore prej dhjetë deri njëzet vjeç ose vetëm në

qytetin dhe njerëzit Medines. Prej tërë fjalimit kuptohet se domethënia e tij është universale, dhe se ai pretendonte një bashkësi e cila do të angazhoje të ngadhnjë drejtësinë.

Ulematë po t'i zbatojnë dispozitat e All-llahut, po t'i zbatojnë masat sanksionuese sipas Sheriatit dhe në përgjithësi pot ë angazhohen për mirëqenien e muslimanëve, populli asnjëherë nuk do të ishin zhvleftësuar kurrë.

Tradita që ngrehet në këtë fjalim është edhe një argument që përkon me tezën tonë, me pushtetin e fakihut. Po që se zhinxhiri i transmetuesve nuk është i dobët, mund ta citojnë si argument të drejtpërdrejt. Se është valid dëshmon edhe fakti se e ka shqiptuar një ma`sun. 154)

E përfunduar diskutimin tonë mbi pushtetin e fakuhut s`kemi kurgjë të shtojmë për këtë temë, sepse mënyrën se si duhet mbledhur zekatin, se si duhet jetësuar dispozitat ligjore etj., u sqaruan mjaft. I prezentuam parimet kryesore mbi këtë temë dhe konfirmuam se pushtetin që e themeloi Pejgamberi a.s dhe imamët është e drejtë legjitime edhe e fukahave. Për këtë nuk ka dyshim. Nëse në raste specifike ekzistojnë dëshmi se fukahtë nuk i kanë të drejtat e barabarta, rastet e tilla konsiderohen si përjashtime.

E kam theksuar edhe më herët: tema e pushtetit të fakihut nuk është diçka e re që kam zbuluar unë. Kjo temë, që nga fillimi, është përmendur vazhdimisht.

Vendimi që e ka eksplikuuar i ndjeri Mirza Hasan Pirazi 155), që ndalonte konsumimin e duhanit, në të vërtetë ishte vendim i qeverisë. Edhe fukahatë e tjerë iu përmbajtën këtij vendimi, madje ulematë e shquar iraninë e pranuan, me përjashtim të disave.

Ky nuk që vendim gjyqi i aprovuar pas ndonjë debati, por një vendim i sundimtarit në të mirë të Islamit dhe të muslimanëve si dhe të zgjidhjes së kujdesit sekundar (unavni sanavi) 156). Për derisa dominonte ky kujdes sekundar edhe vendimi e kishte peshën e vet, por kur filloi të venitet rëndësia e tij pushoi edhe aplikimi i atij vendimi.

Kur Mirza Muhammed Shirazi 157) dha urdhër për xhihad-ose për "mbrojtje", si e quanin ata të gjithë ulematë iu përulën, sepse urdhëri i tij ishte vendim i sundimtarit të vendit. Transmetohet se i ndjeri Qashif el-Gita 158) e kishte zakon të komentojë shumëçka nga këto që it hash unë. Mes dijetarëve tjerë bashkëkohorë i ndjeri Miraki ishte i mendimit se fukahatë janë të autorizuar t'i kryejnë të gjitha funksionet e Pejgamberit të Nderuar (paqja qoftë mbi të). Naimiu i ndjerë besonte gjithashtu se doktrina e pushtetit të fakihut mund të nxirret nga makbuli i Omar ibën Hanzala-s 159).

Kjo temë gjithësi nuk është e re. Unë vetëm se e kam studiuar një çikë më tepër, duke iu qasur nga disa aspekte, vetëm e vetëm që t'ua sqarojë dëgjuesve të mi.

Konform urdhërave të All-llahut të Gjithëfuqishëm që janë proklamuar në Librin e Tij nëpërmjet gjuhës së Pejgamberit të Ndritur (paqja dhe mëshira qofshin mbi të dhe familjen e tij), unë jam munduar të qëmtojë edhe disa çështje të rëndësishme si për kohën e sotshme.

I potencuam parimet kryesore të kësaj lënde. Gjeneratave të tashme dhe të ardhshme u mbetet të përsiasin dhe të analizojmë, të gjejnë mënyra dhe t'i bëjnë realitet, duke iu ikur formave të shpirtngushtësisë, makutërisë dhe dëshpërimit. Dhëntë Zoti (Insaallah!), përmes këshilimeve të ndërsjella dhe me ndrim mendimesh ata do të përkryejnë metodën e themelimit të pushtetit islam në të gjitha sferat. Punët e pushtetit ata do t'ua besojnë njerëzve të ndershëm, inteligjentë, besimtarë dhe vigjilent. Ata do t'i shprohin tradhtarët nga vendkontrolli i shtetit, i atdheut dhe i arkës së muslimanëve. Lëshoni të vërtetohen se All-llahu i Gjithëfuqishëm është me ta.

PROGRAMI I KONSTITUIMIT TË PUSHTETIT ISLAM

Konstituimi i pushtetit islam është detyrë permanente e të gjithëneve. Para së gjithash, duhet të propagandojmë përcaktimet tona; ashtu duhet vepruar sa për fillim.

Ashtu është vepruar në mbarë botën. Tubohen një grup njerëzish, përsiasin, bien vendime, pastaj fillojnë propagandimin e qëllimeve të tyre. Gradualisht shtohet numri i bashkëvendimtarëve, dhe në fund bëhen fuqi që mund të kenë influence në pushtet, madje janë në gjendje t'i kundërvihen pushtetit dhe ta përmbysin, siç qe rasti me rënien e Muhamed Ali Mirzës dhe ndërrimin e pushtetit të tij monarchist 160). Lëvizjet e këtilla fillojnë me aktivitete të nduarnduarshme edhe pa ndonjë ushtri të armatosur. Ata është dalsur të fillojnë veprimtarinë e tyre duke i propaganduar qëllimet e lëvizjes së tyre. Duhet denoncuar plaçkitjen dhe tiraninë, kurse popullin duhet bindur se këto sjellje janë jot ë njerëzishme. Dalëngadale perimetri i aktiviteteve zgjerohet derisa t'i përfshijë të gjitha shtresat e popullit që do të luftojnë për t'i arritur qëllimet e veta.

Ju tash nuk keni as vend as uhstri, por keni mundësi të propagandoni, sepse armiku nuk ka arritur t'u privojë nga kjo mundësi. Ju patjetër duhet t'i mësoni njerëzit se duhet, para së gjithashtu, të kenë respect të thellë ndaj All-llahut, por duhet të dinë se edhe aspekti politik, ekonomik dhe juridik i Islamit është shumë me rëndësi. Ato janë dhe do të jenë në thjerrzën e interesimeve tona. Detyrë jona është të fillojmë konstituimin e pushtetit të vërtet islam. Duhet t'i propagandojmë përcaktimet tona, të njoftojmë popullin me to dhe t'i bindim me vlerat e pamohushme. Duhet të shkaktojmë valë të zgjimit intelektual, duhet të bëhemi rrynë shoqërore që do të merrte karakteristikat e një lëvizjeje të organizuar islame, e udhëhequr prej njerëzish me besim të plotë që do të konstituonin pushtetin islam.

Propaganda dhe udhëzimi janë dy aktivitete tona dhemelore dhe më të rëndësishmet. Fakihu e ka për detyrë që të përhapë fenë dhe t'i udhëzojë njerëzit në besim, t'i njoftojë me dispozitat dhe institucionet e Islamit, që t'u hapë rrugën për jetësimin e Ligjit Islam dhe për themelimin e institucioneve islame. Në njerin nga hadithet e cituara keni mundur të vëreni se trashëgimtarët e Pejgamberit a.s janë përshkruar si "njerëz që i mësojnë të tjerët", d.m.th që i udhëzojnë në fe.

Kjo detyrë është me rëndësi sidomos në kushtet e sotshme, sepse imperialistët mundohen të zvetnojnë të vërtetën islame dhe t'i largojnë muslimanët nga rruga e drejtë. Obligimet tonë në propagandimin e të vërtetës dhe në udhëzimin e njerëzve në fe janë më të mëdha sesa më parë. Shohim se si hebrenjtë (i mallkoftë All-llhu) e kanë ngatërruar tekstin e Kur'anit dhe kanë bërë disa ndryshime në ekzemplarët e shtypur në terrioret e okupuara. 161) E kemi për detyrë të pengojmë shpërndarjen tinzake të tekstit kur'anor të këtillë. Duhet të protestojmë dhe t'i vëmë në dije popullit se hebrenjtë dhe mbrojtësit e tyre të jashtëm janë kundërshtarët e bazave të vërteta të Islamit dhe dëshirojnë të venë dominimin e tyre në mbarë botën. Meqenë se janë grupe dinakësh të zhdërvjelltë, druaj se, mos e dhëntë Zoti, një ditë do t'ia arrinë qëllimit, por kësaj i ndihmon shumë apatite që ndihet në rrethet tona. Mos dhashtë All-llahu që ta mbrijmë atë ditë.

Po ashtu edhe shumë orientalistë janë vënë në shërbim të institucioneve imperialiste, të cilat institucione janë shumë aktive në shtrembërizmin e të vërtetave islame. Agjentët e imperializmit janë të zënë me punë në të gjitha skutat e botës islame dhe me propagandën e tyre të flliqur joshin rininë tonë. Ata nuk i konvertojnë por i bëjnë ateistë dhe indiferentë, që mjafton për të arritur qëllimet e tyre.

Edhe në qytetin tonë ekzistojnë qendra propagandash çoroditëse, të ndertuara në kuadër të tempujeve cionistë dhe behaistë, me qëllim që t'i largojnë njerëzit nga rruga e drejtë, gjegjësisht nga dispozitat e mësimëve islame.

Vallë, a nuk është detyrë jona që t'i rrënojmë këto qendra që e dëmtojnë Islamin? A do të kënaqemi vetëm me atë që kemi në Nexhef? 162) A mos u deshka të rrimë në Kom të vajtojmë dhe të mos ndërmmarim asnjë aksion?!

Ju, pjestarët të gjeneratës së re, duhet të kthjelloheni dhe të mbani në jetë mirësinë e Allahut. Zhvilloni dhe përsosni idetë tuaja, leni anësh cikërrimat, sepse përqëndrimi në gjëra të imta ju pengon të mos kryeni obligimet tuaja të rëndësishme. Ndihamoni Islamin! Shpëtoni Islamin! Ata e shkatërrojnë Islamin duke u thirrur në ligjet islame në emër të Pejgamberit a.s... Agjentët e jashtëm dhe të mbrendshmit janë të shpërndarë nëpër qytet, nëpër të gjitha krahinat e Iranit që t'i mashtrojnë fëmijët dhe të rinjtë, të cilët një ditë do të vihen në shërbim të Islamit. Ndihamoni që të rinjtë tanë t'i shpetojnë këtij rreziku.

E keni detyrë të shpërndani në popull dije e fituar. Dijetari dhe fakihu janë të lavdëruar, sepse ua mësojnë njerëzve dispozitat, institucionet islame etj. ; ua mësojnë sunnetin e Pejgamberit a.s. Tërë energjinë tuaj duhet ta harxhoni për të propaganduar të vërtetën, që Islamin ta prezentoni denjësisht.

E kemi për detyrë të flakim dyshimet që janë krijuar mbi Islamin. Përderisa nuk e shkulim dyshimin prej shpirtërave të njerëzve, nuk do të arrijmë kurrëgjë. Duhet të na mbushtet mendja neve por edhe gjentareve që vijnë se flakja e këtyre dyshimeve për Islamin që janë ngulitur në zemrat e shumë njerëzve, madje edhe ndër njerëzit tanë të arsimuar, është rezultat i propagandës së çoroditur. Ju duhet t'i njoftoni njerëzit me botëkuptimin fetar islam, me institucionet shoqërore dhe formën e pushtetit islam.

Sot, shkollat në Kom, në Mashad dhe në vendet e tjera e kanë për detyrë permanente të propagandojnë Islamin, të përhapin fenë tonë. Përveç Islamit, ju duhet t'i njoftoni edhe me format autentike të pushtetit islam dhe të udhëheqjesë. Sidomos duhet t'iu drejtoheni njerëzve universitarë, klasës së arsimuar. Studentët janë mjaft syçelë.

Ju garantoj, nëse nëpër universitete bëni prezentimin e Islamit dhe të pushtetit islam drejt, studentët do ta pranojnë me zemërgjegjësi. Studentët i kundërvihen tiranisë: ata janë kundër vjedhjes dhe plaçkitjes së pasurisë së popullit. Ata janë kundër harxhimit të asaj që është e ndaluar dhe kundër propagandës së rrejshme. Studentët kurrë nuk do të jenë kundër Islamit, format e pushtetit të të cilit janë të dobishme për shoqëronë. Studentët shikojnë drejt Nexhefit, çojnë thirje për ndihmë. Si mund të tij më duarkryq e ata të na përkujtojnë detyrat tona? 163) Rinia jonë që studion nëpër Evropë na këshillon për të mirë: "Ne kemi organizuar shoqata islame, prandaj na ndihmoni!" 164)

E kemi për detyrë t'ia tërheqim vërtetjen popullit për të gjitha këto çështje. Ne duhet të sqarojmë se cilat janë format e pushtetit në Islam, dhe si funksiononte pushteti në ditët e para të historisë islame. Populli duhet ta dijë se qendra e komandimit dhe banka e të akuzuarve ishin të vendosura në një pjesë të xhamisë edhe në kohën kur Shteti Islam shtrihej deri në viset më të largëta të Iranit, të Egjpetit, të Hixhazit dhe të Jemenit. Mjerisht, kur pushteti kaloi në duart e gjeneratës që pasoi, u krijua monarkia, e edhe më zi se monarkia.

Popullin duhet informuar për të gjitha këto dhe duhet ndihmuar që të formohet intelektualisht dhe politikisht. Popullit duhet t'ia sqarojmë se çfarë lloj pushteti dëshirojmë, kujt do t'i besohen punët e pushtetit që do t'i propozojmë, dhe nga cili program nga cila politikë do të udhëhiqin. Udhëheqës në shtetin islam mund të jetë ai që vepron ndaj vëllaut të vet siç u veprua ndaj Akilit 165) (që mos bëhet diskriminimi

ndërmjet muslimanëve) ose personi që bijës së vet në lidhje me ndihmën e garantuar nga arkashitetërore, ia tërheq vërtetjen: “Nëse nuk e kthen këtë hua, do të jesh e para grua prej Benu Hashimeve 166) të cilës do t’i pritet dora.”

Kryetarë dhe liderë të këtyllë dëshirojmë ne, liderit që në praksë do të aplikojnë Sheriatin, dhe jo t’iu nënshtrohen interesave dhe pasioneve të tyre. Udhëheqësit e këtyllë do të kujdesen njësoj për të gjithë anëtarët e bashkësisë. në çdo aspekt, madje dhe familjet e tyre do të kenë të njejtat kushte, si të gjithë të tjerët; edhe fëmijëve të tyre do t’iu pritset dora po që se vjedhin, dhe vëllezërit dhe motrat e tyre do të dënohen me vdekje po që se shehin heroin (e jot ë vriten njerëzit për shkak të dhjetë gramëve heroin, kurse të afërmit e tyre udhëheqin bandat që në vend fusin heroin me bollëk. 167)

Shumë dispozita islame që kanë të bëjnë me adhurimin (ibadetin) në të njetën kohë janë të lidhura ngushtë edhe me funksionet politico-shoqërore. Format e adhurimit janë të lidhura me format e zhvillimit shoqëror. Për shembull, namazi me xhematë, tubimi në Haxh, namazi i xhumasë, përveç anës shpirtërore, kanë edhe ndikim doktrinar politik dhe moral. Islami i ka paraparë tubimet e këtylla për qëllime fetare: që të forcohet ndjenja e bashkëpunimit vëllazëror, që të stohet pjekuria intelektuale, që të gjenden zgjidhje për probleme të ndryshme politike e shoqërore dhe për konfirmimin e xhihadit si luftë kolektive me përfundim të natyrshëm. Sado që në vendet islame dhe në ato joislame (në të cilat sundojmë jomuslimanë) harxhohen shumë milionëshe prej arkës së shtetit për tubime të këtylla, prapëseparapë nuk mund të arrinë rezultatet. Tubimeve të tyre u mungon spontaniteti, janë të dështuar totalisht. Sipas Islamit kush dëshiron të kryej haxhin, e merr atë rrugë me vëtedëshirë. Edhe lutjet e përbashkëta i bëjnë me dëshirë. Ne duhet t’i shfrytëzojmë këto tubime për të udhëzuar në fed he për intensifikimet e lëvizjes ideo-politike.

Disa njerëz janë të pavetëdëshirë për këtë. Ata përqëndrohen vetëm në shqiptimin drejt të “veled-dalinë” 168). Kur shkojnë në haxh, në vende që të këmbëjnë mendime me vëllezërit e tyre muslimanë, në vend që të propagandojnë besimin islam dhe të përpiqen të gjejnë zgjidhje të problemeve aktuale (p.sh. për çlirimin e Palestinës, e cila është pjesë e atdheut islam), ata edhe më keq i acarojnë marrëdbënit ndërmjet muslimanëve. Në anën tjetër, u pat bërë adet që gjatë kryerjes së haxhit të kryenin edhe punët e tjera më me interes për ta. Hutbeja jepej në mënyrë koncize me ajete të Kur’anit, kurse pas namazit pasonin dhe disa këshilla aktuale. Njëpërmjet hutbes i mobilizonin masat dhe ushti të tëra niseshin prej xhamie drejt në fushë të betejës; armata e atij që i frikësohet All-llahut dhe jo varfërisë e vuajtjes do të jetë fituese padyshim po që se i vështroi hutbet e asaj kohe dhe hutbet e Komandantit të Besimtarëve (paqja qoftë mbi të) do të vëreni se qëllimi i tyre ka qenë që t’i nxitin njerëzit të luftojnë dhe të sakrifikojnë për Islamin, t’ua heqin vuajtjen e njerëzve në këtë botë.

Po të ishin tubuar muslimanët për çdo të premtë dhe t’i kishin zgjidhur problemet e përbashkëta, ne sot nuk do të ishim në këto pozita që jemi. Këto tubime duhet organizuar me seriozitetin më të madhë, dhe duhet shfrytëzuar për propagandë dhe udhëzime. Në këtë mënyrë do të zhvillohet lëvizja ideologjike dhe do të përparojë drejt zenitit të vet.

Mësonjau njerëzve Islamin, bëni sikurse me rastin e Ashurasë 169). Siç e kemi ruajtur të patundshëm bindjen mbi Ashuranë (paqja qoftë mbi themeluesin e saj) dhe nuk kemi lejuar të zhduket dhe se njerëzit edhe sot tubohen gjatë muajit muharrem dhe rakin gjoks për obligimet e veta. Po ashtu edhe ne duhet të ndërmarrim masa dhe të krijojmë valë të tubohen kurse oratorët dhe rauhvanitë 170) le ta fiksojnë mirë temën e pushtetit në mendjen e tyre.

Po qe se popullit ia prezentojmë drejt Islamit, e njoftojmë me botëkuptimin islamik, me parimet dhe dispozitat islame, me sistemin shoqëror ata me entuziazëm do të përvetsojnë (All-llahu a`lem). Vetë jam bindur në këtë. Ndonjëherë mjafton vetëm një fjalë që të ngjallë entuziazmin ndërmjet njerëzve sepse kështu siç janë nuk mund të jenë të kënaqur. Ata jetojnë nën vrinëllimën e bajonetave, represioni i ka ngulfatur që mos thonë kurgjë. Ata presin që dikush haptas t`i paraqesë këto padrejtësi. Pra, bij trima të islamit, ngrihuni!

Drejtohuni popullit trimërisht. Tregoniu masave, me fjalë të buta, gjenden reale. Ktheni entuziazmin në zemrat e tyre: njerëzit që i takoni në rrugë në Pazar, puntorët e katundrët, studentët zellshëm-bëni muxhahidë 171). I gjithë populli do të bëhen muxhahidë. Të gjitha shtresat shoqërore janë të gatshëm të luftojnë për lin, pavarësi dhe mirëqenien e tyre. Edhe luftës së tyre i duhet besimi. Ofroni njerëzve Islamit, sepse Islami është shkollë e xihadit, fe e ngadhnjimit. Lejoni besimtarët që të përsërisin karakterin dhe besimin e tyre në përputhje me Fenë Islame, lejoni që t`i transformojnë ato në forcë mobilizuese që të mund të përmbysin regjimin tiranik që na e ka imponuar imperializmi.

Fukaha të vërtetë janë ata të cilët i udhëzojnë njerëzit në besim dhe i njoftojnë me institucionet islame; ata më të thirrurit që e mbrojnë “kështjellën e Islamit” 172). Ata duhet t`i nxisin njerëzit në vepra të mira të mbajnë fjalime emocionante dhe t`ua përkujojnë atyre detyrat dhe përgjegjësitë që u takojnë. Vetëm kështu, pa le të jetojnë edhe 120 vjet, njerëzit do ta kuptojnë se me humbjen e tyre do të bëhet keq për Islamit dhe se ka ardhur koha e shprastisë në bashkësinë islame, siç na mëson edhe tradita: “Do të paraqiten plasaritje në kështjellën e Islamit”.

A thua se do të jetë humbje e pakompenzueshme në bashkësinë islame po qe se ndëron jetë ndonjë prej nesh, pasi kemi kaluar jetën duke lexuar libra? çfarë humbje do të paraqitte vdekja jonë? Por, kur bota islame e humbi Imam Husejinin (paqja qoftë mbi të), qe me të vërtetë humbje e pakompenzueshme. Humbja paraqitet në vdekjen e njerëzve që kanë ruajtur ligjet dhe institucionet islame, siç janë Haxhi Nasirudin Tusi 173) dhe Alame Hil-li 174). Duke pasur prasysh këtë që jepni ju dhe unë për Islamit, po të vdesin edhe njëmijë si ne, a u thua se do t`iu kujtohet njerëzve se me vdekjen tonë kurgjë nuk do të ndrohej. I vetmi koment për këtë do të ishte se a kemi qenë fukaha dhe a kemi qenë besimtarë të sinqertë.

Asnjë njeri i mençur nuk mund të prët që aktiviteti ynë propagandues dhe udhëzimi në fe aq shpejt të ndihmojë në formimin e pushtetit islam. Që të mund të themelojmë pushtetin islam, duhet të zhvillojmë disa aktivitete të përhershme. Për të arritur qëllimin tonë na duhet kohë. Nëpër vende të ndryshme botës, njerëz të ngritur intelektualisht venë gurthemet e vendeve të tyre, me shpresë se do të vijë dikush pas tyre që t`ia vëjë kulmin, që të arrihet qëllimi përfundimtar. Një herë një halif i pati thënë një plakun që mbillte një dru arë: Or plak, pse e mbjell këtë dru arë, frytet e së silës do të bëhen mbas dhjetë vjetësh, e ti atëherë do të jesh i vdekur? Plaku i është përgjigjur: “Mbollën të tjerët, hëngrëm ne. Mbjellim ne, të hanë të tjerët”.

Duhet të vazhdojmë përpjekjet tona më me ngulm, edhe në mos i arritë rezultatet e duhura gjenerata pas nesh. Sepse, ne i kemi përkushtuar Islamit dhe mirëqenies së njerëzve. Po të kishtë qenë për interesa personale, do të mund të thonim: “Pse po shqetësoheni? Përpjekjet tona nuk do t`i shfrytëzojmë ne por ata që do të vijnë pas nesh”.

Kalorësi i të Munduarëve, i cili i rrezikoi të gjitha interesat personale, po të kishtë menduar vetëm për vete, ai do të bënte kompromisim me Jezidin 175) që në fillim dhe

do të ishte punë e kryer. Sunduesit emëtime deshtën që ai të japë betimin dhe t'i njohë për sundues. Çka do të kishin kërkuar ata më tepër se nipi i Pejgamberit, Imam i kohërave, t'i njihje për komandues të besimtarëve dhe të pranonte pushtetin e tyre? Por, preokupimi i tij ishte ardhmëria e Islamit dhe e muslimanëve. Ai iu kundërvu emevitëve, luftoi kundër tyre dhe sakrifikoi, vetëm e vetëm që Islami të përhapej dhe të vihej rend shoqëror sipas parimeve islame.

Studioni me vëmendje traditën që e citova pak më parë. Do të vëreni se Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të) e pat përjetuar shtypjen e sunduesve tiranikë dhe për këtë arsye zgjodhi rrugën e takisë. Ai nuk pati pushtet ekzekutiv dhe shumicën e kohës që i përndjekur. Prapëseparapë ai vazhdoi t'i njoftojë muslimanët me detyrat e tyre dhe iu caktonte gjykatës. Ç'ishte arsyeja dhe ç'dobi kishte nga emërimi i gjykatësve?

Njerëzit e mëdhenj, me horizont të gjerë njohurish, asnjëherë nuk dëshpërohen e as u kushtojnë vëmendjen kushteve në të cilat veprojnë, as që çajnë kokën për burgjet dhe robërimin që mund të zgjatë pa karar. Përkundër këtyre ata vazhdojnë misionin e tyre. Nëse nuk ja arrinë qëllimit vetë, atëherë mbetet ta vazhdojnë ithtarët e tyre pa le të zgjasë dyqind apo treqind vjet. Shumë lëvizje të këtilla në botë kanë filluar në këtë mënyrë. Ish-kryetari indonezian, Sukarno, në burg i hartoi dhe i përpunoi planet e tija, më vonë i realizoi në praktikë.

Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të) jo vetëm që të hartoj planet, por ai kishte paraparë emërimin e një grupi të konsiderueshëm personalitetësh në pozita të caktuara. Po të ishte bërë emërimi qysh në atë kohë, do të ishte absurditet, por ai këtë e pat menduar për të ardhmen. Nuk kishte sin e që mendojmë vetëm për vetë, por ai ishte i brengosur për fatin e ummetit, për tërë qenien njerëzore; ai mendohej për jetësimin e ligjeve të drejta. Qysh para më se njëmijë vjet e formësoi modelin e pushtetit ashtu që një ditë kur të ngrihet vetëdija e muslimanëve, mos ketë konfuzion: forma e pushtetit dhe udhëheqësia e tij të jenë të ditura.

Marrë përgjithësisht, të gjitha shkollat kanë përparuar dhe janë zhvilluar në këtë mënyrë. Janë bazuar vetëm në një plan, pastaj puna me përkushtim e liderëve ka sjellur rezultatet e pritura. Musai a.s ka qenë bari dhe shumë vjet thirri në fe. Kur u urdhërua të luftojë kundër faraonit, nuk kishte as mbrojtës, as ndihmës. Por rezultat i vendosshmërisë dhe papërkulshmërisë së tij që mundja faraonin me anë të shkopit. Mendonit atë shkop në duart tuaja, po edhe në të miat: a do të mund të arrinin rezultate të njejtë? Nevoitet vendosshmëria, serioziteti dhe zotësia e Musait a.s (Mojsiut) që me shkop të përmbysët pushteti i faraonit. Gjithkush nuk mund të bëjë vepër të këtillë.

Kur Pejgamberi a.s filloi misionin e tij, një djalosh tetëvjeçar (Komandant i Besimtarëve, paqja qoftë mbi të) dhe një grua katërdhjetëvjeçare (Hatixheja-gruaja e Pejgamberit) ishin të parët që i besuan Atij. Nuk pati asnjë tjetër.

Secili e di sa e munduan Pejgamberin, çfar pengesash i nxirrnin në rrugë. Mirëpo, asnjëherë nuk u dëshpërua as që tha: "Unë jame vetëm". Vazhdohi misionin e vet paërkulshëm dhe e plotësoi atë, ashtu që sot shtatqind milionë njerëz janë të tubuar rreth flamurit islam.

Edhe shkolla e drejtimit shiit filloi prej zeros. Ditën kur Pejgamberi a.s i vente themelet e besimit, u prit me qesendi. I thirte njerëzit në shtëpi dhe u thonte: "Njeriu që ka këto e këto cilësi duhet të jetë ndihmës imi " duke menduar në Komandantin e Besimtarëve (paqja qoftë mbi të). Atëbotë ishte shpirt njeriu. Por, askush nuk u ngrit t'i shpreh ndjenja respekti, madje dikush iu kthye Ebu Talibit (176) duke i thënë me ironi: "Ti tash marshon nën flamurin e të birit tënd!

Atë ditë që Pejgamberi a.s ua shpalli njerëzve se Komandanti i Besimtarëve duhet ta trashëgojë, disa treguan kënaqësi të rrejshëm, dhe në të njejtën ditë u aktivizua opozita kundër tij dhe veprimi deri në fund. Po ta kishte caktuar vetëm si autoritet që duhej konsultuar për çështje drejtësisë, nuk do të kishte opozitë kundër tij. Por, mbasi ia dha rangun e trashëgimitarit dhe it ha se do të jetë udhëheqës i muslimanëve dhe se atij duhet t'i besohet fati i popullit, u paraqitën lloj-lloj pakënaqësish dhe-opozita. Nëse edhe ju rri në shtëpitë tuaja dhe nuk ju interesojnë problemet e vendit, askush nuk do t'ju pengojë. Ata do t'ju shqetësojnë vetëm atëherë kur do të përpiqeni të përziheni në fatin e popullit. Komandanti i Besimtarëve dhe ithtarët e tij u munduan dhe u ndoqën mu për atë pse ndërhyjnë në çështjet e pushtetit. Mirëpo ata nuk hoqën dorë nga përcaktimet e veta dhe në saje të përpjekjeve të tyre, sot ka afër dyqind milionë shiitë.

Që të prezantohet drejt Islami, duhet të reformohen shkollat fetare. Patjetër të revidohen planet mësimore dhe metodat e propagandimit dhe të thirrjes. Aptia, neglizhenca, dëshpirimi dhe mungesa e vetëbesimit duhet të zëvendësohen me punën, me zellin, me shpresën dhe vetëbesimin. Efektet që i ka lënë propaganda e rrejshme në shpirtërat e disa njerëzve duhet të fshihet.

Duhet të ndërrohet qëndrimi ndaj pseudoshejtorëve, të cilët, përveç pozitave që mbajnë në kuadër të shkollave fetare, pengojnë njerëzit që ta njohin drejt Islamit dhe të kuptojnë nevojën e domosdoshme të reformave shoqërore. Ahundët 177) oborrtarë, të cilët e kanë shitur fenë e vet për të mirat e kësaj botë, duhet shpërrur prej të gjitha enteve fetare.

Agjentët e imperializmit, së bashku me aparatit politik propagandues të pushteteve marionte antipopullore, me shekuj derdhin helm për të helmuar shpirtin e popullit dhe për të prishur moralin e tyre. Ata që gjetën strehim nëpër entet fetare, sollën me vete edhe vese çoroditëse. Për këtë arsye duhet të mundohemi që ata njerëz të ngrihen moralisht dhe intelektualisht dhe të flakin edhe gjurmët e fundit që u ka mbetur në zemrat e tyre nga propaganda e pushtetit të korruptuar.

Efektet, për të cilat flasim, duken qartë. Për shembull kur i shohim njerëzit që rrinë nëpër qendrat fetare dhe i thonë njëri-tjetrit: “Këto janë probleme që s'na përkasin neve. Ç'lidhje kanë me ne? Çka lypet prej nesh, ne i zbatojmë: falemi e lutemi dhe japim mendimin tonë për çështjet që kanë të bëjnë me Ligjin e Fesë. Idetë e këtilla kanë ardhur si rezultat i propagandës së poshtër imperialiste shumë shekullore, që ka depërtuar thellë në zemër të Nexhefit, të Komit të Meshhedit dhe të qendrave tjera fetare. Propaganda e tyre ka shkaktuar apati, depression, ngathësi etj. që paraqsin pengesë serioze për kthjellimin e mendjeve të tyre, dhe gjithnjë mundohen të arsyetojnë vetën, duke thënë: Këto janë probleme që s'na përkasin neve”.

Këto janë ide të gabuara. Çfarë kualifikimesh kanë ata që sot janë pushtetmbajtës në vendet islamike. A është e mundur ata të kenë aftësi për të mbajtur pushtetin kurse neve të na mungojnë? Cili prej tyre është më i zoti se njeriu mesatar? Shumica prej tyre as që kanë studiuar diçka. Sunduesi i Hixhazit, a ka studiuar ndonjëherë? Sa i përket Riza Kanit, ai ka qenë analfabet, një ushtar analfabet hiç më tepër. Ashtu ka qenë gjithnjë gjatë historisë. Shumë sundues tiranë autokratë nuk kanë pasur kurrfarë aftësie të qeverisin me popullin, nuk e kanë përfillur dijen aspak.

Harun er-Rashidi 178) ose cilido sundues tjetër që pati shtirë sundimin si Harun er-Rashidi, a kishte studiuar ndonjë herë? Të studiuarit dhe përvoja profesionale në shkenca të ndryshme janë parakushte për jetësimin e planeve shtetërore dhe për zbatimin e funksioneve administrative. Ne do t'i shfrytëzojmë njerëzit me kualifikime përkatës. Por, për sa i përket mbikqyres totalë he komandës supreme mbi shtetin,

ndarjes së drejtësisë dhe vënies së barazisë ndërmjet njerëzve, këto janë çështje që i ka studiuar fakihu. Krejt çka duhet për ruajtjen mvetësisë kombëtare dhe lirisë ngërthen në atë që ofron fakihu. Fakihu nuk është njeri që nuk u nënshtrohet të tjerëve ose të bjerë nën ndikimin e dikujt, ai është njeri që mbron lirinë dhe të drejtat e popullit, pavarësinë dhe tërësinë territoriale të atdheut islamik, duke sakrifikuar edhe jetën. Fakihu është njeri që nuk lakonas në të majtë as në të djathtë.

Flakni apatinë dhe depresionin. Përsosni metodat tuaja të punës dhe programet e propagandës, hakatni të prezentoni drejt islamit dhe vendosni të themeloni pushtet islam. Merrni udhëheqjen dhe lidhuni dorë për dorë me ata që luftojnë dhe që duan lirinë. Kini besim në vetvete. Ju keni guxim, trimëri dhe ndjenjë të lartë të atdhedashurisë, ju që keni ngritur popullin në këmbë dhe i keni detyruar të dridhen imperialistët tiranët. Dita ditës, ju përfitoni përvojë të lakmueshme për të marrë frerët e pushtetit. Një ditë, kur do të arrini të përmyni regjimin tiranik do të jeni të aftësuar të qeverisni shtetin dhe t'i udhëheqni masat e gjëra.

Para jush qëndron i shpaluar i tërë sistemi shtetërorë dhe administrative, me të gjitha lidhjet e nevojshme. Nëse administrata e shtetit parasheh sistemin tatimor, Islami në mënyrë decide ka paraparë rregulla përkatëse për këtë qëllim. Nëse duhen ligje, Islami i ka vënë me kohë. Pas vënies së pushtetit, nuk është e nevojshme të sillni ligje, as t'i merrni të gatshme prej të huajve, siç veprojnë disa kryetarë që i lënë mendt për ligjet e Perëndimit të çmendur. Krejt është gati dhe pret. Ju mbetet të hartoni programe që mund të realizohen me ndihmën dhe konsulltimin e këshillëtarëve, të cilët janë ekspertë të fushave të ndryshme, të tubuar në asamblenë consultative.

Fatmirësisht, muslimanët janë të gatshëm të vijnë mbas jush, ata janë aleatët tuaj. Na mungojnë vetëm vendosshmëria dhe forca ushtarake. Insaallah edhe ato do t'i kemi. Na duhet shkop si hazreti Musës dhe vendosshmëria. Na duhen njerëz që do të dinë të përdorin shkopin e h. Musës (Mojsiut) dhe shpatën e Komandantit të Besimtarëve (paqja qoftë mbi të).

Por gllabëruesit që rrinë nëpër entet fetare janë të paftë që të konstitojnë dhe t'i dalin zot pushtetit, sepse gllabëruesit e tillë nuk janë në gjendje të kullandrisin as penën, e çka mbet tjetër. Të huajtë dhe agjentët e tyre na patën krypur mendt dhe dish filluam t'u besojmë se s'jemi të zotët për kurgjë: "Shihni punën tuaj! Shihni shkollat, klasat, studimet tuaja! Ç'ju duhet të merreni me këto gjëra? Këto janë mbi aftësitë tuaja!" Unë nuk jamë në gjendje t'i zhbini njerëzit nga këto ide dhe t'u mbushet mendja se ata duhet të bëhen liderë të njerëzimit, ose se janë të barabartë me të tjerët dhe se mund të qeverisin vendin. Çfarë aftësish kanë ata që u mungojnë të huajt? Është e vërtetë se disa prej tyre patën shkuar në vende të huaja që të bëjnë qejf, mbase kanë mësuar diçka. (Ne nuk jemi kundër mësimit dhe studimeve. Le të shkojnë edhe në hënë le të zbulojnë diç të re; ne s'do t'i pengojmë kurrë. Por, ne kemi obligimet tona).

Përhapni Islamit në çdo skaj, shpallni para gjithë botës programin e pushtetit Islam: mbretërit dhe kryetarët e vendeve islamike ndoshta do të kuptojnë vërtetësinë e kësaj që proklamojmë ne. Ne nuk duam të marrim kurgjë prej tyre. Të gjithë ata që i shërbejnë Islamit besnikërishtë do të mbeten në vendet e tyre.

Sot në botë ka mbi 700.000 milionë muslimanë (shënim i v.1970-vër. e. përkth.), 170 milionë ose më tepër janë shiitë. Ata janë të gatshëm të vijnë rrugës sonë për na mungon guximi t'i udhëheqim. Ne do të krijojmë pushtet që do t'ua kthejë besimin njerëzve. Na duhen udhëheqës të denjë që do të dijnë të ruajnë atë që ua ka besuar populli dhe mbi baza ligjore të mund të jetojnë të qetë dhe të kryejnë punët e veta.

Këto janë probleme për të cilat duhet të mendoni. Mos u dëshpëroni dhe mos mendoni se kjo detyrë është e paralizueshme. All-llahu xh.sh. e di se aftësia dhe trimëria juaj nuk janë më të pakta sa të tjerëve, por nëse shtypja dhe terrorizmi konsiderohen aftësi dhe trimëri, atë trimëri ne me siguri nuk e kemi.

Derisa isha në burg 179) me Aga Kummin (All-llahu e mbrojtë), i cili tash përsëri është i burgosur, erdhi të më vizitojë një njeri. Na pat thënë: “çdo plotikë është e flliqur e rrëjshme, e çoroditur. Pse nuk na leni neve?”

Atë që e tha ai, në një aspekt, ishte e vërtetë. Nëse është politika ashtu siç e përshkroi ai, ajo ekskluzivisht duhet t’u takojë atyre. Por politika islame, e muslimanëve, udhëheqja e imamëve, tërësisht dallohet nga politika për të cilën foli ai.

Dikur për gazetë deklaroi: “Është arritur marrëveshja që liderët fetarë të mos përzihen në politikë”. Unë së shpejti u lirova nga burgu dhe nga mamberin e demantova deklaratën e tij. Thash: “Ai rren. Homeini ose dikush tjetër po të japë një premtim të tillë do të ishte përzënë nga institucionet fetare”. 181)

Që në fillim, ata në ndërdijen tuaj mbjellin sugjestionin se politika është rrenë dhe të ngjashme, që të humbni interesimin për çështjet kombëtare, që ata të mund veprojnë pa asnjëpengesë. Gjatë kësaj kohe, ju duhet të rrii këtu dhe të luteni për të mirën e tyre.

“All-llahu e zgjattë sundimin e tyre”. Ata, kuptohet, nuk janë në gjendje të hartojnë plane valide (El-hamdu lil-lah). Mësuesit dhe ekspertët e tyre i këshillojnë se si t’i hartojnë planet e tyre. Imperialistët britanik depërtuan në vendet e Lindjes para treqind vjetësh. Meqenëse u joftuan me të gjitha aspektet e jetës së këtyre vendeve, ata hartuan plane se sit ë sigurojnë pushtetin për të sunduar më lehtë. Pastaj erdhën imperialistët e rinj, amerikanët dhe të tjerë. Bënë aleancë me Britaninë dhe morën pjesë në realizimin e planeve të saj.

Kur isha njëherë në Hamadan, më erdhi në vizitë një ish-student i teologjisë, njeri që e kishte lëshuar shërbimin fetar por që e kishte ruajtur etikën e tij islame. Më tregoi në hartë disa vende që i kishte nënvizuar me të kuqe. Më tha se të gjitha shenjat e kuqe shenjojnë resurset minerale që gjenden në Iran, dhe se në to gjenden ekspertë të huaj. Ekspertët e huaj e kanë hulumtuar vendin tonë dhe i kanë zbuluar të gjitha rezervat minerale-arin, bakrin, gazin etj. madje kanë bërë matjen e inteligjencisë së popullit tonë dhe se kanë konstatuar se e vetmja barierë që e bllokoi rrugën e tyre është Islami dhe paria fetare.

Ata vetë e kanë hetuar forcën e Islamit, i cili dikur sundoi një pjesë të Evropës dhe e kanë të qartë se Islami u kundërvihet veprimeve të tyre. E kuptuan se dijetarët e vërtetë të fesë nuk i nënshtrohen ndikimit dhe as mendimit të dikujt. Ata, që në fillim, u munduan ta flakin këtë pengesë duke përçmuar Islamin dhe duke i njollosur liderët fetarë. Ata gjetën mbështetje në propagandën më të ligë që të na mbushin mendjen se Islami përbëhet prej një grushti të vogël rregulash ligjore. Madje u përpoqën të rrënojnë reputacionin e fukahave dhe të ulemave të cilët qëndronin në ballë të shoqërisë islame. Për shembull, një agent i pacipë i imperializmit në një libër të tij shkroi 182): “Gjashtëqind ulema nga Nexhefi dhe Irani kanë qenë në listat e rrogave të britanezëve”. Shejh Murtezaja 183) mori të holla dy vjet rresht, dëri në momentin kur kuptoi se prej nga vinin ato të holla. Argumentet për këtë mund t’i gjeni në dokumentacionet që ruhen në arkivat e Hindisë. Imperializmi e ka urdhëruar këtë njeri që t’i turpërojë ulematë sepse shkonte në favor të tyre. Imperializmi me ëndje don të tregojë kinse ulematë gjenden në listat e tyre të rrogave, që t’i njollosin në sy të popullit. Me anë të propagandës dhe insinuatave, u përpoqën ta paraqesin Islamin si diçka të pavlerë, kurse funksionet e fukahave dhe të ulemave t’i proklamojnë sit ë parëndësishme.

Vazhdimisht hakatnin të na bindin se detyrë e vetme e fukahave është të japin mendimin e tyre për çështje juridike. Disa njerëz që nuk ishin udhëzuar sa duhet, u mashtruan dhe devijuan rrugën e drejtë. Ata nuk qenë në gjendje të kuptojnë se i gjithë aktiviteti i tyre ishte pjesë e planit rrënues kundër pavërisë sonë dhe përpjekje për të vënë kontroll mbi të gjitha aspektet e jetës në vendet islamike. Edhe pa dëshirën e tyre, ata u kanë ndihmuar organeve propaganduese imperialiste për jetësimin e politikës së tyre dhe për realizimin e qëllimeve të tyre. Institucionet propaganduese imperialiste u munduan të na bindin se feja duhet patjetër të ndahet prej politikës, se liderët fetarë nuk guxojnë të përzihen në politikë dhe se fukahatë nuk janë të detyruar të interesohen për fatin e popujve muslimanë. Për fat të keq, disa njerëz u besuan. Ranë nën ndikimin e tyre dhe si rezultat i sjelljes së tyre mbetëm aty ku jemi. Këtë gjendje imperialistët gjithnjë na e kanë dëshiruar, na e dëshirojnë dhe do të na e dëshirojnë gjithmonë. Shikoni qendrën për studime fetare dhe do të vëreni efektet e fushatës së egër imperialiste. Do të shihni se si njerëz negligjentë, të ngeshëm dhe apatikë të cilët nuk kanë punë tjera pos të “Shesin” drejtësi, janë të paafte për të kryer diçka tjetër. Do të hasni ide dhe zakone që janë pjellë e propagandës imperialiste-për shembull, se ideja e të shprehurit bukur nuk përkuaka me dinjitetin e ahundëve. Ahundët dhe muxhtehidët nuk janë të gojës por, nëse janë, nuk dinë të thonë gjë tjetër pos “La ilahe il-lall-llah”, ndoshta edhe ndonjë fjalë më tepër. Por kjo është në kundërshti me sunnetin e Pejgamberit të All-llahut (paqja dhe mëshira qoftë mbi të). All-llahu e ka lëvdruar të shprehurit bukur, shkrimin dhe përdorimin e penës. All-llahu xh.sh. në suren “Er-Rahmanu” thotë: “Ia mësoi atij të folurit (të shprehurit, të shqiptuarit) (55:4), nga i cilia jet nënkuptohet të shprehurit rrjedshëm si dhunti që All-llahu ia fail njeriut-mëshirë dhe burim i fisnikërisë. Fjala dhe të shprehurit në përgjithësi janë të domosdoshme për të predikuar parimet e All-llahut për të udhëzuar në Islam”. Nëpërmjet fjalës dhe të shprehurit ua mësojnë fenë njerëzve, dhe kështu zbatojmë obligimin që na udhëzon ajeti: “Ata ua mësojnë njerëzve” 184). Pejgamberi .a.s. dhe Komandanti i Besimtarëve kanë mbajtur fjalime dhe predikime; ata kanë qenq gojëtarë të shkëlqyeshëm.

Shum ëide të gabuara që ende janë të parishme në vetëdijen e disa individëve u ndihmojnë imperialistëve dhe pushteteve shtypëse që të mbajnë vendet islamike në këtë gjendje siç janë dhe të bllokojnë përparimin e lëvizjes islamike. Idetë e tilla dalin prej atyre që e mbajnë veten për të shenjtë, a në të vërtetë janë të rrejshëm, pseudoshenjtorë. Ne duhet t`ua ndërtojmë mënyrën e të menduarit atyre dhe t`ua sqarojmë qëndrimet tona ndaj tyre, nga se ata e bllokojnë lëvizjen tonë dhe reformat që mendojmë t`i aplikojmë: Ata na mbajnë duarlidhur.

I ndjeri Buruxhirdi 185) i ndjeri Huxhxhiat 186), i ndjeri Sadër 187) dhe i mbrami Hvansariu 188) (radijall-llahu anhum) një ditë u tubuan në shtëpinë tonë që të diskutojmë për një temë politike. U thash: “Parasëgjatash, ju duhet të vendosni se çka do të bëni me pseudoshenjtorët. Përderisa ata janë atje, situatë e jonë është e njëjtë me pozitën e dikujt që e ka sulmuar armiku dhe qëndron me duart lidhur mbas shpine. Këta njerëz krejtësisht janë të pavetëdëshëm për gjendjen në të cilën gjendet shoqëria. Nëse doni të bëni diçka, merrni pushtetin në duart tuaja, sigurone pushtetin në Mexhlis, pengoni përhapjen e korrupsionit që të mund të rrënojnë pozitën tuaj në shoqëri. Pra, duhet të vendosni se çka do të bëni me ta”

Gjendja e muslimanëve sot paraqitet nëpërmjet shenjtëve të rrejshëm, të cilët pengojnë të vërtetën mbi Islamit në mënyrë të denjë. Duke vepruar në emër të Islamit, ata i sjellin dëme të mëdha Islamit. Rrënjët e këtij grupi duhet kërkuar nëpër qendrat e institucioneve fetare. Në qendrat fetare të Nexhefit, Komit, Meshhdetit etj., gjenden individë që kanë mentalitet pseudoshenjtorësh dhe në kuadër të bazës së vet infektjnë një pjesë të shoqërisë me idetë dhe qëndrimet e tyre të mbrapshta. Ata i kundërvihen gjithkujt që i drejtohet popullit me këto fjalë: “Hajde, zgjohuni! Mos jetoni nën flamurin e të huajve! Mos ju nënshtroheni gënjeshtrove të Britanisë dhe të Amerikës! Mos lejoni Izraelin t’i paralizojë muslimanët!”.

Më së pari duhet t’i këshillojmë pseudoshenjtorët dhe të përiqemi t’i zgjojmë nga letargjia. Duhet t’iu themi: “A nuk e hetoni rrezikun? A nuk shihni se izraelitët na sulmojnë , na vrasin e na shkatërrojnë , ndërsa britanikët dhe amerikanët iu ndihmojnë! Ju rrini atje dhe po shikoni , po duhet të ngriheni; patjetër duhet të gjeni ilaç për sëmundjet e popullit.

Vetëm diskutimi nuk mjafton. Vetëm të meditosh për çështjet e drejtësisë nuk bën fajde. Mos heshtni në kohën kur Islami po shkatërrohet , kështu Islami po shlyhet; mos heshtni sit ë krishterët kur diskutonin për Shpirtin e Shenjtë dhe Trininë , derisa nuk u shfarosën 189). Ngrihuni! Ktheni realitet dhe problemeve të ditës. Mos rrini të shkujdesur! Mos po pritni të vijnë melektë dhe t’u bajnë në krahët e tyre! Detyrë e melekëve mos është të mrizojnë? Melektë i kanë shtrirë krahët para këmbëve të Komandantit të Besimtarëve (paqja qoftë mbi të) sepse ai i ka ndihmuar Islamit. E ka zgjeruar Islamit dhe i ka hapur shtigje të reja për t’u përhapur kudo nëpër botë. Në komandën e tij u krijua një shoqëri vitale , e lirë , e ndershme dhe me famë. Gjithkush i përullej me respekt , madje edhe armiqtë. Por , përse t’u nënshtrohet dikush juve , që të vetmin aktivitet e keni dhënien e mendimit mbi të Drejtën!

Po qe se pseudoshenjtorët tanë nuk i përmbushin obligimet e tyre pas disa këshillimeve dhe vërejtjeve , do ta kemi t’q qartë se shkak i dështimit të tyre nuk është mosdija , por diçka tjetër. Për shkak të të gjitha këtyre duhet të kemi qëndrim krejt tjetër ndaj tyre.

Qendrat e institucioneve fetare janë të themeluara për të mësuar në to , për të propaganduar dhe për të marrë instruksione. Ato u përkasin fukahave të drejtë , shkencëtarëve , mësuesve dhe studentëve. Ato u përkasin atyre që janë realizatorë të porosive të pejgamberëve. Ata përfaqësojnë depon , dhe është e qartë se depoja Hyjnore nuk mund të lihet në duar të gjithkujt. Kush don që të marrë një përgjegjësi aq të rëndë , të mbrojë interesat e muslimanëve dhe të veprojë si zëvendës i Komandantit të Besimtarëve (paqja qoftë mbi të) , të zgjidhë probleme që i përkasin ruajtjes së nderit ,

pasurisë dhe jetës së njerëzve , presë së luftës dhe kodit penal , ai tërësisht duhet të jetë i privuar nga kënaqësitë e kësaj bote.

Ai që jipet për tepër në gjërat e kësaj bote , edhe në ato që janë të lejuara , nuk mund të jetë zbatues i urdhërave të All-llahut dhe nuk mund të gëzojë besimin tonë. Secili fakih që lidhet për aparatit shtetëror të korruptuar , nuk mund të jetë zbatues i porosive të All-llahut dhe nuk çanë kokën për depon e All-llahut , All-llahu din se çka përjetoi Islami në duart e ulemave të tillë , që nga fillimi! Ebu Hurejreja 190) ishte Fakih por All-llahu e din se çfarë aktygjykimesh flasifikoi ai për shkak të Muaviut dhe të ngjashëmve si ai. Kur njeriu i zakonshëm vihet në shërbim të pushtetit të korruptuar , nuk mund të konsiderohet gjuhahqar , sepse nuk mund të shkaktojë ndonjë dëm serioz. Por , kur fakihu siç është Ebu Hurejreja ose gjykatësi siç është Shurejhu të lidhen për një pushtet të tillë , ata e përmirësojnë gjendjen e atij pushteti por e rrënojnë reputacionin e Islamit. Kur një fakih vihet në shërbim të pushtetit shtypës , atëherë më nuk është çështje individuale. Për këtë shkak Imami (paqja qoftë mbi të) rreptësisht ua ndaloi ithtarëve të vet të kryejnë shërbime shtetërore dhe u tha se situatë në të cilën u gjetën është pasojë e sjelljes së pahishme të disave.

Obligimi që i është dhënë fakihut nuk u përket të tjerëve. Fakihu duhet të jetë i kujdesshëm , duhet t'iu shmangët edhe gjërave të lejuara. Ajo që është e ër takijët , nuk do të thotë se është e lejuar edhe për fukahatë. Qëllimi i takisë është të mbrojtë Islamit dhe shkollën Shiite. Po të mos kishim qenë të kujdesshëm , shkolla jonë do të shuhej. Takija është degë (furuë) e fesë – si p.sh. pastrami ritual në mënyrë të ndryshme. Por kur janë në rrezik parimet kryesore të Islamit dhe mirëqenia e tij , takija dhe heshtja nuk vijnë në konsiderim aspak. Nëse ata mundohen ta detyrojnë fakihun të hypë në minber që të flaës kundër urdhërave të All-llahut , a guxon të zbatojë urdhërat e tyre , e në vetë të thotë: “Takija është feja ime dhe e stërgjyshërve të mi!” 191) Këtu madje as që përmendet takija.

Nëse takija e ka të qartë se me inkuadrimitin e tij në shërbimin e një shteti të korruptuar do të përbaltet reputacioni i Islamit , ai nuk guxon të vihet në një shërbim të tillë , madje duhet ta paguajë edhe me kokë. Nuk mund të gjejë asnjë arsytim parimor. Të ralla janë rastet kur mund të gjendet ndonjë bazë racionale , siç ishte rasti me Ali ibën Jaktinin, 192) motive i shërbimit të tij në aparatit shtetëror është i njohur mirë , edhe aksioni i Havaxh Nasir Tusit i cili u kurorëzua me sukses është i njohur.

Fakihu i drejtë në këtë aspekt është i papërlyer. Që në ditët e para të Islamit e deri më sot shembëlltyra e tyre shkëlqen para nesh si nur. Ahundët të cilët në të kaluarën kanë qenë punëtorë administrativë nuk i kanë takuar shkollës sonë. Fukahatë tanë , jo vetëm që iu kundërvunë sundimtarëve , por për bindjet e tyre të thella u bërëgosun dhe u malltretuan. 194) Mos lejoni që dikush të mendojë se ulematë janë vënë ndonjëherë në

shërbim të shtetit , e as që janë sot në atë shërbim. Sipas nevojës , ata kanë hyrë në shërbim të shtetit me qëllim që të venë kontroll mbi të dhe ta transformojnë. Edhe sot po qe se ndihet nevoja për diçka të tillë . jemi të detyruar ta bëjmë atë. Por , kjo nuk është tema për të cilën flasim. Ne na interesojnë disa njerëz që në koka mbajnë turbane , që kanë lexuar disa libra , ose që s'i kanë lexuar , që është evidente , dhe që kryejnë shërbime të caktuara , për të mbushur stomakun e vet dhe për të fituar autoritet. Çka duhet bërë me ta?

Ata njerëz nuk janë fukaha muslimanë. Ata janë njerëz të cilëve SAVAK – u u ka dhënë turbaned he u ka thënë që t'i luten All-llahut. Nëse SAVAK – u nuk mund t'i obligojë imamët të marrin pjesë nëpër shfaqjet dhe ceremonitë e tjera (sponzorues i të cilave është qeveria) , atëherë do të gjejë njerëzit e vet që do të thonë: “Fama e tij qe më e madhe” , (paradokohësh ata zunë të thuan kështu duke aluduar në Shahun). Këta njerëz nuk janë fukaha. Njerëzit i kanë pranuar sit ë tillë. Tradita na këshillon të kemi kujdes ndaj këtyre njerëzve që mos na rrënojnë fenë. Ata duhet t'i demaskojmë dhe në sy të popullit të mos gëzojnë kurrfarë autoriteti. Nëse nuk iu rrënohet prestigji i tyre ata do ta marrin nëpër këmbë aytoritetin e Imamit të Kohërave dhe të vetë Islamit.

Rinia jonë duhet t'ua hjekë turbanët. Patjetër t'ua heqim turbanët këtyre ahundëve të cilët shkaktojnë korrupsionin në mesin e muslimanëve duke brohoritur se janë fukaha dhe ulema. Nuk e di: a thua të rinjtë tanë në Iran paskan vedkur; ku janë ata? Pse nuk ua hedhin turbanat këtyre njerëzve. Populli ynë në Iran , sidomos të rinjtë e flaktë , e kanë për detyrë t'i pengonjë këta ahundë , po ashtu edhe recituesit e vargut “E lartësuar qoftë fama yte”. Nuk ka nevojë që t'i rrihni , mjafton vetëm t'ua merrni turbanët dhe mos i lejoni të paraqiten para opinionit. Turbanët janë pjesë e veshjes fisnike. Gjithkush nuk është i denjë për të bartur atë.

Siç thashë , ulematë e drejtë islamë janë të pastër në çdo aspect. Ata asnjëherë nuk janë vënë në shërbim të pushtetit. Ata që kanë rënë në këtë grackë dhe që ntrashen në kurriz të fesë dhe mbajnë vetën për ulema , s'kanë kurgjë të përbashkët as me fenë as me ulematë.

Para nesh qëndrojnë detyra të rënda. Duhet të përsosim jetën tonë shpirtërore si dhe mënyrën e jetës. Duhet të jemi të gatshëm që ta ruajmë gjënë më të shtrenjtë që na ka falur All-llahu. Bëhuni animatorë të denjë të porosive më humane. Natyrisht , nuk është e thënë të bëheni si Komandanti i Besimtarëve (paqja qoftë mbi të) i cili ka thënë se kjo jetë pët të nuk është hiç më tepër se teshja e dhisë , por hiqni merakun e pasurisë , pastrojnie shpirtin tuaj , kthehuni All-llahut të Gjithëfuqishëm , bëhuni të devotshëm. Nëse e keni qëllimin të studioni për të siguruar mjete për jetë më të mirë , asnjëherë nuk do ta arrini të bëheni fukaha dhe zbatues të porosive islamike. Përgatituni të bëheni të dobishëm për Islamin. Silluni si ushtria e Imamit të Kohërave , që të mund të shërbeni në zgjerimin e pushtetit të drejtësisë. Vetëm prej njerëzve të drejtë mund të ketë dobi shoqëria. Me sa kamë hetuar , njeriu pastrohet në çdo aspect duke ndejur dhe duke u shoqëruar me njerëz të drejtë.

Vepronin në atë mënyrë që ounët tuaja , sjellja juaj , karakteri dhe flakja e dëshirave të kësaj bote të ndikojnë te të tjetër në ngritjen e gjithanshme të tyre. Ata do t'ju imitojnë juve , për ta do të jeni yrnek dhe ushtarë të All-llahut për jetë.

Nuk them që të hiqni dorë nga studimet. Përkundrazi , ju duhet të studioni patjetër , të bëheni fakihë , t'i përkushtoheni fik'hut të gremiset nëpër institucionet fetare. Nëse nuk jeni fukaha , nuk do të jeni të aftë t'i shërbeni Islamit. Por , derisa studioni , bëni ç'mos që t'ia prezentoni Islamit popullit sa më drejtë. Islami është bërë i huaj , askush s'e njeh si duhet. Ju duhet t'ia komentoni popullit Islamit dhe parimet e tij , që populli të kuptojë njëherë e përgjithmonë se ç'është Islami , pushteti Islam , ç'është misioni diplomatik , ç'është Imamit , dhe jeni të obliguar t'ua sqaroni njerëzve shkaqet e shpalljes së Imamit dhe cilat janë qëllimet e tij. Në këtë mënyrë Islami do të bëhet i nohur gradualisht dhe , insaall-llah , do të vijë dita e konstituimit të Pushtetit Islam.

TA PËRMBYSIM PUSHTETIN TIRANIK

- 1) Duke ndërprerë të gjitha lidhjet me institucionet e pushtetit
- 2) Duke refuzuar bashkëpunimin me ta
- 3) Duke hequr dorë nga çdo aksion që mund të jetë në favour të tyre
- 4) Dhe duke themeluar institucione të reja juridike , finansiare , ekonomike , kulturore dhe politike.

E kemi për detyrë të plandosim tagutin; kjo do të thotë përmbysjen e pushtetit politik jolegjitim i cili mbizotëron sot në të gjitha vendet islamike. Aparati tiranik shtetëror i regjimeve antipopullore patjetër duhet zëvendësuar me institucione që do të shërbejnë për të mirën e përgjithshme të udhëhequr nga parimet që janë konformë. Ligjit Islam (Sheriatit). Kështu dalëngadalë do të linde pushteti islam. All-llahu xh.sh. ua ka ndaluar njerëzve t'i përulën tagutit , regjimeve antipopullore , por i ka kurajuar që të ngrihen kundër mbretërve , ashtu siç e pat urdhëruar edhe Musain a.s. (Mojsiun). Ekzistojnë shumë sunnete që i nxisin njerëzit të luftojnë kundër agresorëve dhe kundër atyre që mundohen të zvetnojnë fenë. Imamët (paqja qoftë mbi ta) së bashku me ihtarët e vet , shiitët , gjithmonë kanë luftuar kundër pushteteve tiranike dhe regjimeve jolegjitime , gjë që mund të hetohet lehtë po qe se shfletojmë jetëshkrimet e tyre. Pjesën më të madhe të jetës e kanë kaluar nën trysinë e sundimtarëve mizorë , dhe qenë të detyruar të aplikojnë takinë për shkak të frikës së madhe , natyrisht jot ë frikës për vetveten por për fatin e fesë së tyre , siç shihet nga sunnetët që shkoqisin këtë çështje.

Sundimtarët mizorë ishin të tmerruar prej imamëve. Ishin të vetëdëshëm se kur t'iu ipet rasti imamëve , do të ngrihen kundër tyre dhe do t'i privojnë nga jeta e shfrenuar.

Kjo ishte arsyeja sepse Haruni i burgosi Musa ibën Xhaferin 195) (paqja qoftë mbi të) disa vjet , kurse pas tij Me'muni 196) e barti Imam ridanë (paqja qoftë mbi të) në Merv 197) dhe e mbajti të mbyllur atje disa vjet dhe më në fund e helmoi. Haruni dhe Më'muni shtireshin sikur s'kishin bërë asgjë , sepse imamët e mbanin veten për sejjidë , d.m.th. pasardhës të pejgamberit , ndërsa kryetarët janë në gjendje t'iu kundërvihen edhe pejgamberëve; më të vërtetë Haruni dhe Me'muni ishin shiitë. Ata ishin të motivuar nga aspiratat për pushtet. E kanë ditur se nipat e Aliut kishin të drejtë të krijonin halifatin dhe se dëshira e tyre e sinqertë ka qenë konstituimi i pushtetit islamik , duke e konsideruar si detyrë legjitime. Një ditë i është propozuar imam musasë të skicojë kufijt e Fadakes 199) që t'ia rikthejnë. Sipas një tradite , ai e bëri skicën e gjithë perandorisë islame dhe u tha: “Krejt çka shihni brenda këtyre kufijve është e drejta jonë legjitime. Ne duhet t'i qeverisim këto vende , kurse ju jeni uzurpatorë”. Atëherë tiranët e panë se Imam Musa pot ë jetë në liri , do t'ua rrezikonte jetën dhe do të përmbyste pushtetin e tyre. Për këtë arsye nuk dhanë kurrfarë mundësie! S'ka dyshim , pot ë kishte pak mundësi , ai do të rebelohej dhe do t'i përmbyste këta uzurpatorë.

Ngjashën e ruante edhe Me'muni Imam ridanë , duke iu drejtuar me dinakëri e dyftyrësi me “kushëri” dhe “pasardhës i Pëjgamberit të All-llahut” , nga frika se një ditë mund të rebelohej dhe t'i rrëronte themelet e pushtetit të tij. Meqë ishte pasardhës dhe trashëgimtarë i Pejgamberit (paqja dhe mëshira qofshin mbi të) nuk iu mundësua lirshëm të shkonte në Medine. Krerët mizorë ishin të flaktë për pushtet dhe ishin në gjendje të sakrifikojnë gjithçka për të. Personalisht ata nuk ishin në armiqësi me askend. Sikur ta kishte vizituar Imami , mos e dhashtë Zoti , oborrin e tyre , do t'i bëhej nderim i veçantë. Ata edhe do t'ia puthnin dorën. Sipas traditës , kur Imam Ridaja duhej të shkonte në audiencë te Haruni , ky ishte urdhëruar që t'i shkonte hypur në kalë deri të fronit dhe e ka pritur me nderime të mëdha.

Por kur erdhi koha të ndahej prej arkës shtetërore , dhe kur erdhi rendi Benu Hashimive të marrin hisen e tyre , ai u caktoi një sasi minimale. i biri i tij Me'muni , i cili ishte i pranishëm , u befasua nga kontrasti ndërmjet respektit dhe rastit të ndarjes në të cilat që dëshmitar. Haruni ia pati sqaruar : “Ti nuk i kupton do gjëra: Benu Hashimitët duhet të mbesin në gjendjen që janë. Ata patjetër duhet të jenë të varfër , të burgosur , të syrgjynosur , të munduar madje edhe të helmuar , se përndryshe do të rebelohen kundër nesh dhe do të na privojnë nga jeta”.

Imamët (paqja goftë mbi ta) nuk luftuan vetëm kundër pushtetëmbajtësve tiranikë , kundër pushteteve shtypëse dhe kundër këtyre armiqëve. Ka më shumë se pesëdhjetë sunnete në Vesail esh-Shia 200) , në Mustedrak 2001) dhe në librat e tjera që i thërrasin muslimanët të heqin dorë nga sunduesit mizorë dhe t'ua zënë gojën atyre që shkruajnë panagjerike. Shkurt , Imamët kanë sygjëruar t'i shkëpusim të gjitha lidhjet me sunsuesit e tillë dhe askush të mos bashkëpunojë me ta , në asnjë mënyrë. Përkundër këtyre , ekzistojnë edhe sunnete tjera në të cilat lavdërohen dijetarët dhe fukahatë e drejtë , duke theksuar superioritetin e tyre mbi të tjerët. Marrë se bashku , të dy grupet e sunneteve formojnë programin real për themelimin e pushtetit islam. Në rradhë të parë njerëzit thirren që të përmbysin pushtetin tiranik dhe t'ua rrënojnë shtëpinë e tyre të shtypjes. Pastaj shtëpitë e fukahave le t'i kenë dyert e hapura për popullin: shtëpitë e atyre fukahave që luftojnë në rrugën e All-llahut për jetësimin e dispozitave islame dhe për konstituimin e një sistemi shoqëror islam.

Muslimanët do të jetojnë në paqe e rahatit dhe do të mund ta ruajnë fenë e tyre vetëm nëse gëzojnë mbrojtjen e shtetit të themeluar mbi bazat e të Drejtës Islame , si sistemi juridik po ashtu edhe ai administrative. Detyra jonë është të përligjim dhe të krijojmë program shtetëror islamik. Shpresoj se ne , me prezantim të denjë të sistemit politik dhe të parimeve islame shtresave të gjëra të popullit , do të krijojmë opinione të reja dhe një lëvizje të fortë gjithëpopullore , me të vetmin qëllim: themelimin e pushtetit islam.

O Zot! prejaju duart mizorëve që i kanë shtrirë drejt tokave të muslimanëve dhe shfarosi të gjithë tradhëtarët e Islamit dhe të mbarë vendeve islamike! Zgjoji burrëshetasit e shteteve muslimane nga letargjia dhe vetë të mundohen për të mbrojtur interesat e popullit të vet dhe t'i flakin ndasitë dhe interesin personal! Gjeneratës së re që studion nëpër kolegje fetare dhe nëpër universitete mundësojau të luftojnë për realizimin e qëllimeve të shenjta të Islamit dhe , të bashkuar me masat e popullit , më së pari t'i

çlirojnë vendet islamike nga kthetrat e imperializmit dhe të agjentëve të tyre shpirtkazëm , e pastja t'i mbrojnë ato! O Zot! Bën që fukahatë dhe dijetarët të angazhohen t'i udhëzojnë njerëzit dhe t'i ndriçojnë shpirtërat e tyre , sidomos të gjeneratës së re dhe të luftojnë për vënien e Pushtetit Islam! Te All-llahu është sukseesi ynë , dhe nuk kemi mbështetje tjetër përpos në forcën e All-llahut të Madhërueshëm dhe Fisnik.

SHËNIMET

(Në këto shënime i udhëzojmë të paudhëzuarit, si dhe atë lexues që eventualisht do të tregojë interesim më të madh për të njohur më gjerësisht tabanin fetar, politik dhe historic të këtij teksti, port ë njoftohet edhe me referencat aktuale të ngjareve historike. Këto shënime janë rezultat i redaktimeve të mëvonshme të bëra nga bashkëpunëtorët dhe përkthyesi e Imamit, dhe nuk janë ojesë integrale e këtij libri).

- 1) fakih: njeri i udhëzuar në parimet dhe dispozitat e Sheriatit, dhe përgjithësisht i udhëzuar në të gjitha aspekte e fesë.
- 2) Me këtë aludohet në fjalët e Pejgamberit a.s: Islami përsëri do të jetë i huaj për njerëzit, siç ishte në fillim, por, do të jetë e bekuar gjendja e këtij të huaji”.
- 3) Hadith: tradita e të cila na njofton për fjalët dhe sjelljet e Pejgamberit a.s edhe në praksën siite, njerit prej Dymbëdhjetë Imamëve.
- 4) Muxhtehid: aitoritet në Ligjin Hyjnor i cili jetëson ixhtihadin, d.m.th. “kërkon kendim të drejtë... duke deduktuar rregullat specifike të Ligjit nga parimet dhe dispozitat e tij” (Muhammed Sanglexhi, Kazadar Isam, Teheran 1333/1959, f.14
- 5) Ahund: fjalë me etimologji të panjohur e cila në fillim shenjonte dijetarët me arsimim të jashtëzakonshëm, por më vonë me këtë emër njiheshin dijetarët e rangut më të ulët dhe kështu mori kontacion pejorative, sidomos në përdorimin profane.
- 6) Ulema: (sh.) dijetërët islamë.
- 7) Në lidhje me ndikimin e ligjit kushtetues belg në komitetin e të gjashtëve i cili solli Aneks Ligjin Kushtetues më 1907, shih: A.K.S Lambton, “Dustur, iv Iran, Encyclopedia of Islam, në ed. , II, 653-654 dhe Mustafa Rahimi Kanuni Asasi yu Iran” (Teheran, 1347/1968, f.94

- 8) Nenet prej 35 deri 57 të Aneksit të Ligjit Kushtetues parovuar më 7 tetor 1906 i referohen “të drejtës së trashëgimit të fronit”. Shih: E.G Broën, The Persian Revolution of 1905-1909, (Cambridge,1911) fq. 337-379.
- 9) Në vitin e shtaë të erës islame, Pehgamberi Muhammed nuk iu dërgoi letra vetëm Herakulit dhe sundimtarit të Iranit (me siguri Pervizit), por edhe sundimtarëve të Egjiptit, të Abesinisë, duke iu bërë thirrje të pranojnë Islamin dhe të heqin dorë nga pushteti jo i drejtë. Shih: Muhammed Hamidullah, Le prophete de l`Islam (Paris, 1959), I 196-197, 212, 230, 241.
- 10) Kalorësi i të munduarëve: Imam Husejni, nipi i Pejgamberit a.s.
- 11) Në vitin 60/680 Imam Husejni, nuk pranoi t`i japë besimin Jezidit, të birit të Muaviut dhe hali i dytë Dinastisë Emevite, sepse Jezdi nuk kishte autoritetin legjitim dhe e trashëgoi halifatin në bazë të trashëgimisë familjare. Vdekjen e Imamit të luftën e Qerbelasë shitët gjithmonë e komentojnë si shembull eklatant të tirlnisë. Kjo ngjarje u ka shërbyer si referencë e rëndësishme ideologjike dhe emotive gjatë Revolucionit Islamik në Iran.
- 12) Ëehstë bërë një studim i përgjithshëm mbi rollin e Britanisë në periudhën e hershme të lëvizjes kushtetuese. Megjithatë, disa prej dokumenteve relevante duhet

kërkuar në General Report of Persia për vitin 1906 (file F.O 416/30. Public Records Office, London).

13) Sheri`a (Sheriati): ligji gjithpërfshirës islam i nxjerrë prej Kur`anit, prej praksës dhe deklaratave autoritative të Pejgamberit dhe prej një varg burimesh të tjera.

14) Ligji i proklamuar në korrik të v. 1969 parashihte dënimin me vdekje për individin të cilin gjendej më tepër se dy kilogramë opium, ose dhjetë gramë heroinë, morfiun ose kokainë. Dhjetë dënimet e para me vdekje janë ekzekutuar në dhjetor të v. 1969, kurse prej v. 1974 janë vrarë 236 vetë në bazë të këtij ligji. Shih: Ulrieh Gehrke, Iran: Natur Bevolkerung, Geschihte, Kultur, Staat, Eïrschaft, (Tubingen dhe Basel, 1976), f.281. Me siguri se ky ligj është shfrytëzuar si mbulesë për ekzekutimin e dënimit me vdekje ndaj të burgosërve politikë të cilët nuk kanë pasur lidhje me narkotikët.

- 15) Nuk mund të thuhet se këtu aludohet në ndonjë shkollë të veçantë që e kanë themeluar të huajt. Para Revolucionit Islamik në Iran kanë ekzistuar shumë shkolla që i kanë themeluar të huajt, profane dhe misionerike, të cilat shkolla i largonin studentët nga shoqëria dhe kultura islame.
- 16) Tekija: Të fshehuritë e besimit të vërtetë në kushtet e rrezikut akut ka mbështetje në Kur`an, 3:28. Për të pasur një pasqyrë më të plotë mbi tekijnë shih: Almanahu i Tabatabait, Shi`ite Islam (Alabny, N,Y.1975), fq. 223-225.
- 17) Kjo është referencë e marrur nga seria e fjalimeve të mëhershme të cilat i ka mbajtur Imam Homeini në këtë temë pushteti islam. Ambasada e Iranit në Bagdad u mundua të pengojë shpërndarjen e tekstve të këtyre ligjëratave.
- 18) Komandanri i Besimtarëve: Ali ibën Ebi Talibi, kushëri dhe dhëndër i Pejgamberit, i pari i Dymbëdhjetë Imamive sipas sektes Shiite. Sundoi prej v. 35/656 derisa u martirizua më v. 40/661.
- 19) Imam Hasani: i biri i Imam Aliut, Imam i Dytë. Ndërroi jetë më v. 20) 50/670, pasi kaloi jetë vetmitari në Medine. Imam Bekir: Imami i Pestë. I lindur më v. 57/675 dhe pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Medine, ku edhe ndërroi jetë më 114/732.
- 21) “Cilësia e drejtësisë”, të cilën duhet ta ketë secili dijetar, nuk do të thotë se duhet të predikojë barabarësi në të gjitha raportet shoqërore por nënkupton edhe apstinencën nga mëkatet e mëdha.
- 22) “O Pejgamber! Transmetoje atë që të është shpallur nga Zoti yt, sepse nëse nuk e përcjell, nuk do ta plotësosh misionin që të është besuar” (5:70).
- 23) Ksenomaniakët: ata që janë mashtruar me modelet e kulturës së huaj, sidomos të asaj të Perëndimit. Ky është përkthim i termit garbzadaha (persisht) të cilin e popullarizoi Xhelal el-Ahmed (vd. më 1969) në librin e tij Gazbzadagi (ksenomania). Ishte shkrimtarë me

- ndikim të madh, me vepër e të cilit ishte i njoftuar edhe Imam Homeini, Shihni shtojcën komemorativë mbi Xhelal el-Ahmedin në gazetën e përditshme të Teheranit Xhumhurrij Islami, Sharivar 20, 1359/12 tetor 1980, f.10
- 24) Ezani: thirrja për namaz.
 - 25) Veulil emër: “Njeriu që gëzon autoritet”, term që buron nga Kur`ani, 4:59. “O ju që besuat, bindjuni All-llahut, respektoni të dërguarin dhe përgjegjësit nga ju (ulil emir)”.
 - 26) Sunneti: praksa e Pejgamberit të cilin muslimanët e kanë pranuar si normë dhe ideal në sjelljen e përditshme.
 - 27) Fshehtësia e Vogël: gajbetu sugra, periudha nga 70 vjeçare (260/872-329/939) kur, sipas drejtimit shiit, Muhammed el-Mehdiu, Imami i Dymbëdhjetë u zhduk nga plani fizik por mbajti kontaktet me ithtarët e tij dhe pas ndërrimit të katër përfaqësuesve të emëruar. Pas vdekjes së përfaqësuesit të katërt nuk është emëruar asnjë trashëgimtar dhe kështu ka filluar Fshehtësia e Madhe (gajbetu kubra, e cila vazhdon edhe sot.
 - 28) Me siguri aludohet në Behaitë, të cilët pohojnë se kanë pranuar një varg “shpalljesh potskur`anore”.
 - 29) Xhizja: tatim të cilin e mbledh pushteti islam prej jomuslimanëve si kompenzim në vend të zekatit që e japin muslimanët. Keraj: tatim që mbledhet për disa kategori të tokave. Hums-i: tatim që paraqet 1/5 e fitimit nga bujqësia ose nga tregtia. Zekat-i: tatim që mbledhet për kategori të ndryshme pasurish, që shpenzohen për qëllimet e parapara me Kur`an, 9:60.
 - 30) El-Kafi: njëra prej përmbledhjeve më të rëndësishme të haditheve Shiite që i ka përmbledhur Shejh Xhafer el-Kulajni (v. më 329/941). Dy vëllime të kësaj vepre para ca kohësh u botuan anglisht në përkthim të Sejjit Muhammed Hasan Rizva-së, e botuar në Teheran.
 - 31) Kur`ani, 16:89.
 - 32) Referenca ka të bëjë me siguri për Imam Xhafer es-Sadikun, fjalët e të cilit në këtë temë i ka cituar Al-lame Tabatabai në El-Mizan fi tefsirul Kur`an (Bejrut, 1390/1979), XII, 327-328.
 - 33) Sejjid-ët: pasardhësit e Pejgamberit, prej bijës së tij Fatime dhe dhëndrit Ali, i pari prej Dymbëdhjetë Imamive.
 - 34) Zekat-i: nuk ka mundësi të paraqes shumë të jashtëzakonshme për atë se merret një përqindje e caktuar nga teprica e pasurisë, që është akumulim jo i zakonshëm në sistemin ekonomik islamik.
 - 35) Ehludh-dhime: shtetas jomuslimanë në një shtet islam, të drejtar dhe obligimet e të cilëve janë rregulluar me marëveshje.
 - 36) Ummet-i: tërë bashkësia islamike, pa dallime territoriale e etnike.
 - 37) Mesxhidul-Aksa: vende në Jerusalem prej nga Pejgamberi a.s u ngjiti në qjell në vitin e njëmbëdhjetë të misionit të tij (Kur`ani, 17:1): po ashtu është kompleks i xhamisë dhe ndërtesave të ngritura aty. Xhamia u dëmtua shumë me rastin e vënes së zjarrit më qëllim më 1969, dy vjet pas okupimit cionist të Jerusalemit.
 - 38) Omajadët: (emevitët): anëtarët e dinastisë e cila sundoi në Damask prej v. 132/750 dhe e shndërroi hilafetin në institucionin trashëgimor.

- Muaviu, i përmendur aq shpesh në këto episode, ishte i pari kësaj linje.
- 39) Abasidët: dinastia që i zëvendësoi emevitët dhe themeloi kryeqendër të re të halifatit-Bagdadin. Me rebelimin e sunduesve (mëkëmbësve) lokalë, forca e abasidëve zuri të bjerë prej shek. të katërt/të dhjetë dhe përfundoi me pushtimin mongol më 656/1258.
 - 40) Kufr-i: mohimi i udhëzimit Hyjnor, aniteza e Islamit.
 - 41) Tagut-i: ai që i tje kalon të gjithë kufijt në despotizmin e tij, dhe i jep vetes prerogative hyjnore, qofshin eksplicite ose implicite.
 - 42) Shirk-u: t`i bësh shok Zotit, duke besuar në shumë zotëra ose duke i përshkruar attribute hyjnore dhe prerogative dikujt tjetër përveç All-llahut.
 - 43) “Zvetnimi në tokë”: ka kuptim të gjerë, nuk përfshin vetëm prishjen (degjenerimin) moral por edhe rrënimin e të mirave materiale, vjedhjen dhe uzurpimin e pasurisë shoqërore, nënkupton edhe konspiracionin me armiqtë e Bashkësisë Islamike, të cilët mundohen ta rrënojnë sistemin islam. Shih komentin e Kur`anit, 5:33, të Tabatabai, El- Mizan, V, 330-332.
 - 44) Ndoshta është e udhës të citojmë pjesë nga një raport i fshehtë që e paraqiti në janar të v. 1916 T.E. Laërence, organizator britanik i të ashtuquajturës kryengritje që e udhëhoqi Sherif Husejni prej Mekkeje: “Si duket aktiviteti i Husejnit është në favor tonin, sepse ai shkon krahas qëlimeve tona: thyerjen e bllokut islam dhe shkatërrimin e Perandorisë Osmane... Arabët janë më labilë se turqit. Po qe se sillemi si duhet, ata do të mbesin në situatë të një mozaiku politik: nëpër mbretëri të vogla me rivalitet të theksuar dhe të paaftë për një kohezion politik”. Shih: Philip Knightley and Colin Simpson, The Secret Lives of Laërence of Arabia (Neë York, 1971) f.55
 - 45) D.m.th. Hasani dhe Hysejni.
 - 46) Nexhhul-Belaga, bot. Subhi es-Slih (Bejrut, 1397/1967).
 - 47) Imam Rida: i teti prej Dymbëdhjetë Imamive, i lindur më 148/766, kurse ka ndërruar jetë më 203/817/ në Tus (Meshhed). Sipas besimit shiit e ka helmuar halifi abasid Me`muni, i cili më së pari e emëroi për trashëgimtarë të vetin, pastaj u frikua nga ithtarët e shumtë të cilëve u predikonte. Varri i tij në Meshhed është vendi më i vizituar, qendër kryesore fetare e arësimore në Iran.
 - 49) Teksti i kësaj tradite mund të gjendet në veprën e Shejh Saddukit, Ilal esh-Sharai (Kom, 1378/1958) I,183.
 - 50) D.m.th. , në mungesë të Imamit ose të një zëvendësi që e ka emëruar ai (siç ishte rasti gjatë kohës së Fshehjes së Vogël), detyra u përket fukahave si klasë.
 - 51) Këtu më tepër aludohet në të ashtuquajturin Ligj për mbrojtjen e Familjes i v.1967, të cilin ligj Imami e shpalli sit ë kundërt me parimet islame.

- 52) Shiitët besojnë se Pejgamberi e caktoi Imam Aliun për trashëgimtar të vetin në afërsi të Liqenit të Vogël Kumm kur po ktheheshin nga Mekkeja për Medine, pas haxhit të fundit.
- 53) T'i përshkruhen mëkatet Ebu Bekrit dhe Umerit dhe devijimi i Uthmanit janë pjesë e besimit shiit, dhe plotësisht është i pranueshëm në këtë kontekst. Megjithatë, më bindës është vërejtja se Ebu bekri dhe Umeri e ndoqën shembullin e Pejgamberit në jetën e tyre.
- 54) Hixhaz-i: regjion në Arabinë Perëndimore që lidh Mekken me Medinen.
- 55) Pas Revolucionit doli në dritë evidence se sa abuzime janë bërë në përvetësimin e pasurive në mënyrë të paligjshme, sidomos hajrate. Tokai u pat dhënë këngëtarëve të kabareve dhe anëtarëve të familjes mbretërore. Këtë pasuri e kontrollonte shteti. Lidhur me këtë shih artikullin që bën fjalë për këtë temë në gazetën teherenase Kajhan, 27 Isfand 1357/18 mars 1979. Për përpjekjet e regjimit që të mbarojë kinema në Kom, shih.S.H.R, Barrasi ve Tahlili en-Nihzati Imam Homeini (Nexhef, 1356 Sh./1977), f. 103-104.
- 56) Për kuptimin e drejtë të fjalës “drejtësi” shih shënimin 21.
- 57) Këtu bëhet fjalë për disa mëngësi që shitët tradicionalisht i patën vërejtur gjatë sundimit të Ebu Bekrit.
- 59) Fukaha: është shumësi i fakih (shih shën. I)
- 60) Fjalët janë të All-llahut sepse janë kur`anore, por ë kontekstin në të cilin jepen, folës është Ibrahim i a.s (Abrahami). Pasi e luti All-llahun që ta gëzojë familjen e tij me dërgimin e pejgamberëve por i përjashton nga ky mission ata pasardhës që mund të jenë mëkatarë.
- 61) Fshehtësia: shih shënimin 27.
- 62) Pushteti (velajati) është diçka e jashtme në qenien e individit (i`tibari); fa kihu kryen këtë mission në bazë të arritjeve të attributeve të fakihut të vërtetë.
- 63) “Pushteti (velajati) i Imamatit është diçka e brendshme në individualitetin e tij, me çka edhe dallohet fakihu, madje rrethi i veprimt të tij nuk është i kufizuar. Sipas kësaj, ata kryejnë “pushtet kosmik” (Velajati takvini), duke bërë edhe çudira. Velajati është i njëjtë me imamët dhe të dërguarit më të shquar, të cilët kryenin funksione të pushtetit dhe gjatë kohës kur pranonin shpalljet. Deklarata se “askush nuk mund të mbrijë statusin shpirtëror të Imamatit, madje as kerubini e pejgamberët” na vë në dije se Imamët janë superior ndaj atyre të dërguarëve misionit të të cilëve u mungon dimensionin udhëheqës i prijësit. Për tipat e ndryshëm të vilatëve shih te Murteza Mutahhari, Veliha dhe Vilajat`ha, Kom, 1355/1975.
- 64) Për të gjitha atributet e Imamatit shih: Henri Corbin, Histoire de la philosophie islamique (Paris, 1964) f. 74.
- 65) Meleku Xhibril (Gabriel) e përcolli (e shoqëroi) Pejgamberin a.s. gjatë rrugës për Miraxh, por, mbasi që ka rang më të ulët se Pejgamberi nuk i ka dhuruar Zoti prej bukurisë së Tij.

- 66) Është mjaftë e njohur tradita që i referohet Miraxhit.
- 67) Fatimeja , e bija e Pejgamberit , hy në rangun e lartë të pejgamberëve dhe të Dymbëdhjetë Imamive dhe ka cilësinë e Ismatit (Që kanë dhuntinë të jenë të pastra nga gabimet dhe mëkatet. Si bijë e Pejgamberit dhe si grua e Imamit të Parë shërbeu edhe si ndërlidhje ndërmjet Pejgamberit dhe trashëgimtarëve të tij
- .68) Nahxhul Belaga, f. 76.
- 69) Vepra e cituar, f.50.
- 70) Po aty, fq.188-189.
- 71) Si më lart.
- 72) Malik Ashtar: mëkëmbës të cilin Imam Aliu e emëroi në Egjipt. Sa i përket tekstit të udhëzimeve të Imamit drejtuar atij, shih Naxhul-Belaga, fq.426-445.
- 73) Shejh Sadduk: i njohur edhe si Ibën Babujah , është njëri ndër dijetarët më të shquar të mësimëve të hershme Shiite , ndërroi jetë më 381-991
- 74) Xhamial-Ahbar: përmlidhje e traditave Shiite. Ujun Ahbar ar- Rida; përmbledhje traditash që i referohen Imam Rida-së , që i tuboi Shejh Sadduki për Sahib ibën Abbadin, ministër i përmendur në dinastinë Buvejhite dhe mbikqyrës i El- Mexhalis-it, i njohur edhe si El- Meali.
- 75) Musned: hadith zinxhiri i transmetuesve të të cilit arrin oandërprerë deri te Pejgamberi.
- 76) Mursel: hadith zinxhiri i transmetuesve të të cilit arrin deri te “pasuesit” anëtarë të gjeneratës së dytë të besimtarëve) dhe nuk përmendet emir i shokut të Pejgamberit prej të cilit është dëgjuar hadithi.
- 77) D.m.th. ekziston dallim funksional ndërmjet studiuesve të hadithit dhe atyre të fakihut , mbase i njëjti person mund t’i njohë që të dyja.
- 78) Kulejni: shih shënimin 30.
- 79) Shejh Sadduk: shih shën. 73.
- 80) Shejh Mufidi: llogarit i Muhammed el-Harithit , dijetarët shiit, i cili ka vdekur më 413/1022.
- 81) Fikh: diciplinë shkencore që studion parimet dhe dispozitat e ligjit Islam (Sheriatit).
- 82) Teki-a: Shih shën. 16.
- 83) Ixhtihad: shih shën. 4.
- 84) Tradita e njohur që solli përpilimin e përmbledhjes së katërdhjetë haditheve , për t’ua përkujtuar atyre që kanë aspiratë që të sigurojnë dhuratat e premtuara.
- 85) Samura ibën Xhandeb: emir i plotë: Abu Said Samura ibën Xhandeb al- Kazari , Shok i Pejgamberit që mori pjesë në shumë beteja. Më vonë u shpërngul në basra ku përkohësisht shërbeu si mëkëmbës në kohën e sundimit të Muaviut , halifit të parë emevit.
- 86) Këtu me siguri i referohet njërit prej dy haditheve daifë: “sultani është hija e All-llahut në tokë: kush e respekton atë e ka respektuar All-llahun , kush i kundërvihet atij i është

kundërvënë All-llahut”, për sa i përket kritikave ndaj kësaj gjoja tradite , shih: Nasiruddin

el-Albani , Silsilatul-ehadith ed- daife vel meudua (Damask , 1384/1964) , I, f. 98.

87) Për shembull , ekziston një traditë ku thuhet: “Fjala e vërtetë ë thënë në praninë e sundimtarit jot ë drejtë është e barabartë me Ixhtihadin”, kurse dy tradita tjera përfundojnë

me fjalinë: “...nuk duhet t’u nënshtroheni atyre që nuk i nënshtrohen All-llahut”.

Për këtë

dhe tradita të ngjashme shih: Abdullah Fahd en-Nafisi , Indema Jahkumul Islam?

(London , pa datë botimi) , fq.142-146.

88) Imam ebul Hasan Musa , i biri I Xhaferit; i shtati prej Dymbëdhjetë Imamive por më i njohur

është si Musa el-Kadhim. i lindur në Medin më 128/744, kurse vdiq në burg në Bagdad, më

183/799.

89) Shih: Shejh Ebu Xhafer el-Kulajni, el-Kafi.

90) Shah Sultan Huseini ka qenë monarku i fundit i dinastisë safavide , e cila sundoi Iranin prej

fillimit të shek. XVI deri në dhjetëvjetëshin e dytë të shek. XVIII. Njëri prej sunduesve

safamidë më të paaftë. Tërë energjinë ja kushtoi zdërhalljes dhe nuk arriti të organizojë

mbrijtjen e fronit të vet (në Isfahan) prej sulmeve afganë , të cilët e morën në duart e tyre

pas gjashtë muaj rrethimi më 1772. Shih: L. Lockhart , The Fall of Safavi Dynasty , Cambridge , 1958.

91) Shih shënimin 2.

92) Pjesa e hadithit të dytë që flet për ëndrrën në të cilën Pejgamberit i ishte dëftuar mizoria

E Emevive.

93) Shprehja e përkthyer këtu si udhëheqje i referohet imamit i`tibarit: shih shënimin 62.

94) Homejn: qyteti i lindjës së Imam Homeinit.

95) Imami i Kohërave, d.m.th. i Dymbëdhjeti Imam, i cili od të dale nga fshehtësia në kohën kur botën do ta mbulojë padretjësia, dhe se ndërrmrja e çfarëdo aksioni për elminimin e padretjësisë duhet të prolongohet deri në ardhejn e imin e padretjësiseduhet të prolongohet deri në ardhjen e tij.

96) Shih: Kulajni, El-Kafi, I,f.118-119.

97) Mufti: dijetar i cili jep mendime authoritative (fetva) për çështje Sheriati.

98) Usame; d.m.th. Usame ibën Jezid, mik i afërt i Pejgamberit i cili u emërua të udhëheqë ekspedita luftarake kur i kishte tetëmbëdhjetë. Vdiq mëv.59/679.

- 99) Shih shën 21.
- 100) Shahi: Njësi më e vogël monetare, tash e vjetëruar, 1/12 e rialit.
- 101) Muaviu, halifi i parë emevit dhe kundështarë i Imam Aliut. Sundoi prej v. 41/661 deri në v. 60/680.
- 102) Shih shën 30.
- 103) Ja-Sin: sureja e tridhjetë e gjashtë e Kur'anit. Recitimi i kësaj sureje sidomos netëve të xhumasë, është e dalluar prej të gjitha ditëve tjera.
- 104) Shurejh-u: emir i plotë-Shurejh ibën el-Harith el-Kindi, gjykatës në Kufe të cilin e emëroi Umeri r.a. Këtëpozitë e mbajti edhe gjatë sundimit të Uthmanit, Aliut dhe të Emevive. Vdiq si një qindvjeçar më v. 87/706.
- 105) Nga Vasail esh-Shia, përmbledhje e traditave Shiite prej Muhammed Hasen el-Amulia (vdiq më 1104/1693).
- 106) Fetva: shih më lartë.
- 107) Naraki: Haxhaxh Mulla Ahmed Naraki, dijetar i shquar i shek. XIX nëntëmbëdhjetë. Ndërroi jetë më 1244/1829. Jo vetëm që ishte autorë i sukseshëm, por ai shpeshherë konfrontohej me monarkun e asaj kohe, Fat'h Ali Shahun. Shih: Hamid Algar, Religion and State in Iran, 1785-1906, Berkley 1969, fq. 57,89.
- 108) Na`ini: Mirza Muhammed Husejn Na`ini, dijetar i shek. XII, 1227/1860-1354/1936. Për teorinë politike të shiitëve flet në librin "Tenibul-Ummeti ve Tenzihul-Mil-leti", shih: Abdul Hadi Hairi, Shi`ism and Constituationalism in Iran (Leiden, Netherlands, 1977) fq. 165-220.
- 109) Imam Xhafer es-Sadiku: i gjashti i Dymbëshjetë Imamive (83/702-140/757). I njohur si Imam Sadik. Ka luajtur rol të rëndësishëm për zhvillimin e shkencave fetare.
- 110) Kuptimi i fjalës Imam ngërthen të arriturat që i kanë Dymbëdhjetë Imamitë, të cilët nuk kanë qenëvetëm trashëgimtarë të Pejgamberit por kanë pasur edhe dhunti sublime shpirtërore.
- 111) Ikmalud-din en-Ni`me: Vepër e Shejh Saddukit mbi fshehjen e imait.
- 112) Imami i Kohërave: i Dymbëdhjeti Imam. Shih shën. 95.
- 113) Muhammed ibën Uthman el-Umari: zëvendësi i dytë i Imamit gjatë kohës së Fshehjes së Vogël. Shih shën. 27.
- 114) Emërimi Huxhxad (argument) që iu është dhënë imamëve ka dy kuptime. I pari, nëpërmjet cilësive që i disponojnë, ata janë dëshmi e ekzistencës së Zotit dhe e vërtetësisë së fesë që Ai e shpalli. i dyti, ata paraqesin argumente të cilat do të prezentohen në Ditën e Gjykimit kundër atyre që deklarojnë se nuk kemi qenë të Informuar për Ligjin e All-llahut. Shih: Abdulaziz Abdulhusein Saxhedin, Islamic Messianism (Albany, 1980), fq. 66-67.
- 115) Dhurara: em. i plotë: Dhurara ibën A`jan, autoritet në traditat e Imamit të katërt, të pestë dhe të gjashtë. Vdiq në v. 150/767.
- 116) Sadaka-ja dhënie vullnetare që i tubon shteti islam dhe i shpenzon për qëllime mirëbërëse.

- 117) Shahu organizoi kremtimin e dymileniumit e gjysëm të sundimit monarchist që ishte më vulgari, më kriminel dhe më ekstravaganti kremtim në këto anë. U mbajt në vitin 1971, afro dy vjet mbas mbajtjes së këtyre ligjëratave në Nexhef. Megjithatë, përgatitjet për këtë manifestim patën filluar aty nga fundi i v. 1960.
- 118) Shahu më 1967 e kurorëzoi veten dhe gruan e tij për mbret, gjegjësisht për mbretëreshë.
- 119) Makbuli: hadith nga i cili mund të nxirren referenca të pranueshme.
- 120) Shih: Ismaili Hakki el-Bursavi, Ruhul Bejan, Istambull 1390/1970 II, fq. 227-228.
- 121) Shih: Tabatabai El-Mizan, IV, 385.
- 122) Dhimmii: dikush prej ehlu dhimmive shih shën. 35.
- 123) Benu Kurejdha ishin fise hebrenjsh që banonin në Medine. Gjatë kohës së Luftës së Hendekut në vitin e pestë Hixhrij, baskëpunuan me forcat mekase që erdhën të sulmojnë qytetin. Banorët e këtij fisi u vranë për shkak të tradhtisë.
- 124) Usame: Shih shën. 98.
- 125) Referenca për Urf-in nuk ka për qëllim të sanksionojë por vetëm të sqarojë praksën juridike ekzistuese.
- 126) Kjo traditë gjendet El-Amuliu, Vasail e Shia, XVII, 98.
- 127) Haram: Vepër e ndaluar rreptësisht me Sheriat.
- 128) Shih: Kur`ani, 2:256.
- 129) Shih: El-Amuliu, Vasi`a-Shi`a, XVIII, 100.
- 130) Këtu pabesimi implikon papërkulshmërinë.
- 131) Kjo traditë është cituar te El-Kafi, I, fq. 85-86.
- 132) Kulajniu, El-Kafi I, fq. 78-79.
- 133) Ekzistojnë një numër i konsiderueshëm veprash me këtë emër. Kjo mund të jetë referencë e komentit të Kur`anit, të shkruar nga Zijaud-din Jusuf Kazvini, qysh në shek. e njëmbëdhjetë /shtatëmbëdhjetë. Shih: Aga Buzrg Tihrani, Edhdharia ila Tesanigash-Shia (Teheran, 1390/1970, XX, 23.)
- 134) Pasi ndërroi jetë Pejgamberi e bija e tij Fatimeja kërkoi që t`i ndahet një pjesë tokë e punueshme në afërsi të Fadakut (vend i vogël jo larg Medines) si trashëgim nga babai, sepse gjatë jetës së tij Pejgamberi e shrytëzonte atë vend për t`i ushqyer gratë e veta. Ebu Bekri e refuzoi, duke i cituar fjalët e Pejgamberit: “Ne Pejgamberët nuk lëmë kurrfarë trashëgimie: Atë që e lëmë pas vetes është sadakaja”. Shih: El-Baladhuri, El-Futuh bot. De Goeje (Lejden, Netherlands, 1886) fq. 29-33. Sipas traditës Shiite, Fadaku u bë symbol i pengimit të padrejtësisë.
- 135) Nes`h: tekst i qartë dhe autoritativ, me kuptim të thuktë.
- 136) Naraki: (shën. 107) ka shkruar vepra voluminoze mbi parimet e fikhut me titull Avidul-Ajjam min Kavaidul fukahail-A`lam.
- 137) Fikhi Rizavi: supozohet se kjo vepër përmban zgjidhje të drejta të Imam Riza-së, autenciteti i të cilave kontestohet. Shih: Tehrani, Edh-Dhari`a, XVI, 292-293.
- 139) Mustedrek: Ky është Mustedrekul Vesail, shtojcë e Vesailush-Shia (shih shën. 105) që e ka hartuar Mirza Husejn Nuri (vd.më

- 1320/1902)
- 140) Me siguri fjala është për veprën Guararul-Faraid ve Duararul-Kalaid, vepër e Muhsin ibën Hassan Al-A`raji mbi parimet e Fik`hut. El- A`raji vd.në v. 1227/1812. Shih: Tehrani, Edh-Dharija, XVI, 41-42
- 141) Tuaful Ukul përmbledhje tregimesh dhe aforizmash të Imamit që e përpiloi Shejh Ebu Muhammed el-Halabi, bashkëkohik i Shejh Saddukit dhe mësues i Shejh Mufidit.
- 142) Mina: qytet i vogël jo larg Mekkes.
- 143) Imam Homeini citon tekstin arabisht para se të japë përkthimin e tij në persisht, i cili në disa raste është më i përgjithshëm se sa origjinali arabisht.
- 144) Minber: vendpredikimi në xhami. Aty këndohet hutbeja.
- 145) Shih ajetet: 2:168, 7:150, 10:57, dhe shumë të tjerë.
- 146) Fjala Evlija si fjalë e ngjashme me Vilajat ka kuptime të shumta. Këtu është përdorur me kuptim të përgjithshëm siç del nga Kur`ani, 10:62-63. “Me të vërtetë janë evlija ata që besojnë dhe ruhen prej mëkateve, ata nuk do të shohin frikën e as mjerimin.
- 147) Novotaria e gabueshme: bid`at, besim ose praksë që s`përputhet me Kur`anin dhe Sunnetin.
- 148) Mesxhidul-Aksa: shih shëm. 37.
- 149) Ndërmjet shkollave të shumta të Ligjit Islam, shkolla Shiite tregon mostolerancë më së shumti ndaj muzikës. Muzika në vende publike është për çdo kritikë sepse i imponohet dëgjuesit pa dëshirën e tij.
- 150) Ekzistojnë disa lehtësime gjatë Ramazanit, si mosagjërimi për shkak të sëmurjes, si shenjë respekti ndaj këtij muaji.
- 151) Referanca për agjitacion kundër ligjeve të reja zgjedhore që i solli regjimi i Shahut më 6 tetor 1962. Këto ligje nuk i specifikuan kandidatët, nuk ishte kusht që të jenë muslimanë dhe kjo shërbeu si shteg për behaitët për të marrë pjesë aktive në jetën publike, mbase edhe abrogimin eventual të Kushtetutës së v. 1906. Pas fushtatës së gjatë kundër ligjit në fjalë, në çka Imam Homeini ndikoi shumë, qeveria u desht t`i shpallë të pavleshme zgjedhjet e 28 nëntorit të v. 1962. Shih: S.H.R. Berrasi ve Tahili, fq. 142-148.
- 152) Kur`an, 9:60.
- 153) Një indikacion i lidhjeve të ngushta me Izraelin ishin kontaktet e rregullta që u realizuan ndërmjet gjeneralëve iranianë dhe anëtarëve të forcave të armatosura izraelite të rangut të lartë. Për shembull, gjenerali Palizban u takua në Palestinën e okopuar me Mosha Dajanin dhe Ariel Sharonin, me siguri më 1974. Fotografitë nga ky takim, të cilat tregojnë të gjithë pjesëmarrësit që shkrihen së qeshuri, u zbuluan pas revolucionit dhe janë publikuar në gazetën Xhumhurijetu Islamije, 26 Sharivar 1359/17 shtator 1980.
- 154) Ma`suminë: ata që kanë cilësinë e quajtur ismat (shih shen. 67): d.m.th. Pejgamberi, Fatimeja dhe Dymbëdhjetë Imamitë.
- 155) Mirza Hasan Shirazi: muxhtehid, vdiq më 1412/1894. Pasi prodhimi dhe shitja e duhanit në Iran u bë monopol i një kompanie britanike, ai nxori në dritë në dhjetor të v.1891 se “Konsumimi i duhanit është i njëjtë me

- luftën kundër Imamit të Kohërave”. Duke e respektuar deklaratën e tij, i gjithë populli në Iran e bojkotoi konsumimin e duhanit, duke shkaktuar heqjen e koncesioneve në fillim të v. 1892. Shih Algar, Region and State, fq. 205-215.
- 156) “Përfillja sekundare”: unvani sanavi, një varg rrethnash me rëndësi ligjore.
- 157) Mirza Muhammed Taki Shirazi: nxënës i Mirza Hasanit dhe dijetar shiit me nam. Vdiq më 1228/1921. Ishte shtyllë e fortë e ulemave shiitë cilët iu kundërvunë imponimit të pushtetit britanik në Irak në fund të Luftës së Parë Botërore. Shih: Muhammed Hirzud-Din, Me`arifur-Rijal, (Nexhef, 1384/1964), II, 215-218.
- 158) Kashif el-Gita: Muhammed Husejn Kashif el-Gita, dijetar shiit në Irak, 1295/1876-1373/1954. Ishte activist politik dhe akademik gjatë tërë jetës. Shih hyrjen biografike në veprën e tij Aslu esh-Shia Usuluha, vëll, 7 (Bejrut, 1377/1957).
- 159) Si më lart.
- 160) Më 23 qershor 1908 Muhammed Ali, me ndihmën e rusëve, bëri grushtet ushtarak kundër Mexhlisit të parë Iranian. Ai u përmbys dhe përsëri u krijua pushteti kosntitutiv më 16 qershor 1909, si rezultat i rezistencës popullore me të cilën udhëheqën dijetarët më të shquar në atë kohë në Nexhef. Shih: Broëne, The Persian Revolution of 1905-1909.
- 161) Së shpejti pas një lufte gjashtë ditëshe jepet informatë për territoret që i zaptuan cionistët. Nëpër vende të ndryshme afrikane qarkullonin kopie të Kur`anit prej të cilëve janë nxjerrë ajetet të cilët u bënë qasje kritike marrëdhënieve me Hebrenjtë.
- 162) Nexhefi është qendra kryesore e shkollës Shiite botërore. Lamenti për këtë vend thotë: “Ne nuk e kemi as Nexhefin” këto fjalë iu referohen restriksioneve dhe trusnive që i ushtronte regjimi baasist në Bagdad ndaj dijetarëve shiit në Nexhef. Shqetësimi baasist i Nexhefit kulmoi në maj të vitit 1969, dhjetë muaj para se të mbaheshin këto ligjerata, në kohën kur shumë ulema ishin të burgosur dhe të maltretuar kurse donacionet fetare ishin konfiksuar. Shih: Hajati Hakim, në angl. (Karachi, 1973) fq. 73-84.
- 163) Pasi që “të urdhërosh në të mirë” është detyrë e veçantë e ulemave, do të ishte turp për ata sikur studentët t`ua përkujtonin një gjë të tillë.
- 164) Gjatë kohës së aratisë në Nexhef, Imam Humeini i kushtoi kujdes të veçantë shoqatave të studentëve iranianë nëpër Evropë dhe SH.B.A. , duke i udhëzuar dhe duke iu dhënë kurajo.
- 165) Akil ibën Ebi Talib: vëlla i Imam Aliut. Pasi Imam Aliu e mori halifatin konfirmohet se Akili kërkoi prej tij katërdhjetë mijë dirhemë prej arkës shtetërore që të mund të paguante borxhet kur kërkesa e tij iu refuzua, akili u largua nga i vëllai dhe iu bashkangjiti ithtarëve të Muaviut në Damask.
- 166) Benu Hashimitë: familje mekase të cilës i përkiste edhe Pejgamberi a.s. dhe pasardhësit e tij.

- 167) Aludohet në aktivitetin e motrave binjake të shahut për të cilat më 1960 është dhënë lajmi se janë mbajtur nga policia zvicrane, pasi që te ato janë gjetur sasi të mëdha heroine. Shih: Bahman Nirumand, Persien Modell eines Ennvick lungslandes (Hamburg, 1967) fq. 133-134.
- 168) Ve led-dal-linë: “As të atyre që janë të humbur”, kjo fjali gjendet në ajetin e shtatë të kaptinës fillestare të Kur`anit. Shkronja d te fjala d`dal-linë është tingull që persishtja nuk e ka dhe persianët e shqyptojnë si z. Në Iran dhe gjetiu, me rastin e recitimit të këtij ajeti në lutje, i kushtojnë kujdes të veçantë shqiptimit të këtij tingulli që t`i japin vlerën që e ka në arabisht.
- 169) Ashura: e dhjeta ditë e muajit Muharrem, dita e toturimit të Imam Husejnit në Qerbela. Shih: shën. 11.
- 170) Rauzakvani: ata që specializojnë për të recituar bukur, në vargje, ngjarjen e toturimit të Imamit. Pjesa e parë e shenjës Rauza është marrë nga titulli i një tregimi me këtë përmbajtje, Rauzatush-Shudada, prej Husejn Vaiz Kashifit (v. më 910/1504).
- 171) “Kështjella e Islamit”: Shih shënimin e lartëshënuar.
- 172) Kvaia Nasirud-Din Tusi: Njëri prej dijetarëve më të shquar shiitë, 597/1201-672/1274. Ka shkruar shumë vepra jo vetëm nga lëmitë fetare, por edhe nga filozofia, matematika dhe astronomia. Iu bashkangjiti ushtrisë së pushtuesi mongol Hulag kur kaloi nëpër Iran në rrugën e tij për Bagdad, fakt ky për të cilin u akuzua si pjesëmarrës në këtë ekspeditë. Për lidhjet e tij me mongolët, shih: A.H Hairi Nasiruddin Tusi: His Allegede Role in the Fall of Baghdad, Actes du V-e Congres international d`arabisant et d`islamisans (Bruxelles, 1971) fq. 255-266.
- 174) Al-lama Hilli: emri i plotë është Al-lama ibën el-Mutahhar el-Hilli, i dyti dijetar prej më të shquarëve nga shiitët që jetoj në kohën e pushtimit mongol të Iranit, 648/1250-616/1325. Për aktivitetin e tij politik shih te Michel Mazzaoui, The Rise of the Safavids (Viesbaden, 1972) fq. 27-34.
- 175) Jezid-i: halifi i dytë emevit, kundërshtarë i Imam Husejnit. Sundoi prej v. 60/680-64/683.
- 176) Ebu Talibi: i ati i Imam Aliut. Sipas besimit shiit besohet se e ka pranuar Islamin, kurse sipas sunnitëve-jo.
- 177) Ahund: Shih shënimin 5.
- 178) Harun Er-Rashid: halif abasit cili sundoi prej v. 180/886-193/908, ishte bashkëkohës i Imamit të shtatë dhe të tetë, Musa El-Kadhimit dhe Riza- së.
- 179) “Ai njeri” ishte Hasan Pakravani, shef i SAVAK-ut ndërmjet viteve 1961-1965, në kohën kur Imam Homeini ishte në S.H.R., Berrasi ve Tahlili, f. 575.
- 180) Akai Kummi: ky është Ajatullah Hasan Tabatabai Kummi, lider fetar i Meshhedit, i cili bashkëpunoi aktivisht me Imam Homeinin në lëvizjen e 15 Hurdadit.

- 181) Në tekstin e këtij fjalimi mbajtur, në Mesxhidul Azam në Kom më 6 mars 1964. Shih: Biygraf-yi pishva, II, fq. 109-138.
- 182) Ndoshta i referohet një fragmenti të Mahmud Mahmudit, Tariki Ravabidi Sijasi-yi Iran ve Inglis, (Tehran, 1332/1953), VI,1743. Sultan Gazi Ed-Din Haydar prej Udhasë themeloi një donacion prej qindra rupishë për ndihmtë të varfërve në Nexhef dhe Qerbela. Mbasi që mbretëria e tij ranë duar të Hindisë britanike, ky donacion kaloi në duart e britanikëve. Për këtë trashëgim dhe pronarët e saj Shih, Algar, Religion and State, fq. 237-238.
- 183) Shejh Murteza: ky është Shejh Murteza Ansari, i pari Muxhtehid i cili u bë i vetmi prijës i botës Shiite (Marjai taglit). Ka jetuar prej v. 1216/1801-1281/1865. Ishte autor i El-Mekasab-it, vepër e rëndësishme e shkencës juridike Shiite. Shih: Algar, vep. e cit. fq. 162-164.
- 184) Shih shën. 60.
- 185) Buruxhirdi” Ajatullah Husein Buruxhirdi, shih shënimin 7.
- 186) Huxhxhat: Ajatullah Muhamed Huxhxhati, mësues shumëvjeçar dhe shok i Ajatollah Hajriut (1310/1862-1372/1953). Qe i angazhuar për ngritjen e Medresesë Huxhxhatijje. Shih: Muhamed Sherif Razi, ganxhina-ya Danishmandan, (Tehran, 1352/1973) I, 305-335.
- 187) Hansariu: Ajatullah Muhamed Taki Hansari, dijetar fetar i cili ka kombinuar trimërinë dhe diturinë (1305/1888-1371/1952). Luftoi kundër okupatorëve britanikë në Irak nën udhëheqjen e Mirza Muhamed Taki Shirazait (shih, shënimin 157) para se t`i bashkangjitej qarkut të Hajriut në Kum. Shih, Razi vep. e cit. I, 322-326.
- 189) Me siguri ju referohet polemikave kristologjike të Bizantit.
- 190) Ebu Hurejreja: shok i Pejgamberit vdiq në v. 59/679. Konfirmohet se ai ka transmetuar 5.374 hadithe të Pejgamberit, më shumë se kushdo tjetër prej shokëve të Pejgamberit. Umeri e emëroi mëkëmbës të Bahrejnit, Uthmani gjykatës në Medine, kurse Muaviu mëkëmbës në Medine. Dijetarët shiitë e konsiderojnë të pabuesueshëm dhe të pandershëm.
- 191) Është fjalim i njohur i Imam Xhafer es-Sadikut.
- 192) Ali ibën Jaktin: tradicionalist i hershëm shiit, 124/742-182/798. Shoqërohej me Mensurin, halifi i parë abasit dhe, thuhet se i ka ndihmuar në planifikimin e Bagdadit.
- 193) Shih shënimin 173.
- 194) Edhe pse historinë Islame mund të hasen shembuj se ka pasë raste aleancash ndërmjet fukahave sunnit dhe sundimtarëve, duhet theksuar se ka pasur edhe shumë përjashtime, p.sh. Ebu Hanifja (80/669-152/769) themelues i shkollës më të përhapur të Sheriatit, të cilin e burgosi halifi abasit Mensuri.
- 195) Shih shënimin 88.

- 196) Me`muni halif abasit (198/813-218/833) terrorizues i Imam Rizasë (shih shënimin 48).
- 197) Merv: qytet në Transoksani.
- 198) Me`muni dhe babai i tij ishin shiit dhe në mënyrë impicite pranuan autoritetin e Imam Rizasë.
- 199) Fedak: shih shënimin 134.
- 200) Vesajlush-Shia shih shënimin 105.
- 201) Mustedrek shih shënimin 139.